

| | |
|--|----|
| Fjala jonë | 2 |
| Çeçeni-Çka pas Kadyrovit? | 3 |
| Burgu Ebu Garib-erë e keqe..... | 4 |
| Arabia Saudite: Shoqatat bamirëse | 5 |
| Zëvendësimi i zezakëve..... | 7 |
| Çka i ofrohet botës? | 9 |
| Islami në Kinë | 11 |
| Koha pasuria më e çmueshme | 13 |
| Sulejmani-paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të | 14 |
| Aborti është vrasje | 20 |
| Sjellja e mirë ndaj injorantit | 21 |
| Si t'i shërbej fesë në jetën e përditshme?..... | 23 |
| Vlerat e dijetarëve | 25 |
| Koha e provimeve..... | 29 |
| Ruajtja e sherijatit..... | 32 |
| Mendjelehtët | 37 |
| Bazat e sunnetit | 39 |
| Rregullat e vetë-zhvillimit në Islam | 43 |
| Dërgimi i ushtrisë së Usames-rrëfimi dhe mësimet..... | 48 |
| Obligimet e muslimanit ndaj jomuslimanit | 58 |
| Mirësevjen lule trendafili | 60 |
| Për ndjekjen e epsheve | 62 |
| Ajo që shpreson shpërblimin prej Zotit | 62 |
| Kujtimet e gruas së Halifes..... | 63 |
| Roli i gruas në arkitekturë | 64 |
| Et-Tebrizi | 66 |
| Imam es San'ani | 67 |
| El-Kadi el-Fadil..... | 68 |
| Imam Ebu Jusufi..... | 69 |
| Imam En-Nevevi..... | 71 |
| Tema: Gruaja imam?..... | 73 |
| Vendimi i fesë për puthjen gjatë takimit, përçafimin, dhe puthjen e dorës së dijetarit | 74 |
| 11. Të dëshirosh për vëllain tënd atë që dëshiron për vete | 76 |

edicion i botuar / viti i parë / nr: 11

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Çeçeni-Çka pas Kadyrovit?

Krahasimi i Çeçenisë me Irakun nuk është aq i thjesht. Këndvështrimi evropian sugjeron një situatë më të vështirë në Kaukaz.

“Kremlini është në një luftë që as mund ta fitojë e as ta humbë, dhe një dekadë në të [luftë] nuk ka ndonjë shenjë të lehtësimit”, shkroi editoriali i gazetës “Baltimore Sun”.

Dy ditë pas ngjarjes, shumë editoriale dhe komente evropiane panë më shumë se sa vetëm një krahasim ndërmjet Çeçenisë dhe Irakut. Opinioni evropian sugjeron se rrethanat në Çeçeni janë shumë më të këqija se në Irak.

Njëjtë siç është e vështirë situata në Irak për kryetarin amerikan George Bush, Vladimir Putin ballafaqohet me një problem edhe më të vështirë në Çeçeni.

Një numër i editorialeve (të gazetave) evropiane të përkthya nga “Deutsche Welle” humluan zgjerimin e vakumit politik në Çeçeni pas vdekjes së Kadyrovit, duke theksuar mundësitë e kufizuara që i ka në dispozicion Putini.

Gazeta italiane “Corriere della Sera” u pajtua se operacionet e Putinit në Çeçeni dhe ato të Bushit në Irak janë të ngjashme në atë se të dyja ballafaqohen me një “përzjerje shpërthyesë të nacionalizmit politik dhe fundamentalizmit fetar”.

Ata poashtu duket se ndajnë të njëjtin fat – me një përjashtim. ... Pas përdorimit të të gjitha zgjidhjeve të mundshme në Irak, Sh.B.A.-të në çdo kohë mund të tërhiqen një hap mbrapa, madje edhe nëse O.K.B. do të merrte një rol më të madh. Rusët, ... shpinën e tyre e kanë të mbështetur për muri.

Gazeta spanjolle “El Pais” në editorialin e saj shkroi se “Përpjekjet e Putinit për të qetësuar kryengritësit në Kaukaz kanë dështuar”.

Politikisht, ai nuk është pranuar nga popullata, ndërsa ushtarakisht, ai nuk është në ndonjë pozitë për ta ndaluar terrorizmin. Mundësitë e vetme tani për Putinin janë negociatat politike, që ai deri tani i ka refuzuar.

Gazeta “Der Standard” nga Viena, vdekjen e Kadyrovit e konsideroi si “Një poshtërim i drejtpërdrejt për kryetarin rus, i cili sapo e filloi mandatin e tij të dytë me pompozitet dhe ceremoni të madhe”.

Koncepti politik i Putinit për Çeçeninë më në fund dështoi. [dhe] Çfarëdo hakmarrje që mund të ketë në mend kryetari rus nuk do ta ndryshojë këtë fakt.

“Darmstadter Echo” nga Gjermania sulmin kundër Akhmad Kadyrovit e konsideroi si: “Një goditje e rëndë për përpjekjet hap-pas-hapi të Putinit për të qetësuar konfliktin në Kaukaz. Rezultati duket se është dhunë më e madhe dhe numër më i madh i viktimave... Njëjtë Putini nuk mund të lejojë që Çeçenia ta lëshojë Federatën ruse... Putini duhet të druajë rreth destabilizimit të rajonit jashtëzakonisht të ndjeshëm – një zhvillim rreth të cilit edhe Perëndimi nuk ka interes.

Dilema me të cilën konfrontohet Putini është se, pa një aleat burrështeti për ta mbajtur Çeçeninë brenda Federatës ruse, ai duhet disi të kthejë stabilitetin në atë rajon, që historikisht ka njohur paqen vetëm nën kontroll të një burrështeti, shkroi gazeta ruse “Moscow Times”.

Vrasja e Akhmad Kadyrovit ka krijuar një vakum pushteti në Çeçeni, të cilën Moskë mund ta ketë vështirë ta plotësojë, duke pasur parasysh se ai i ka lënë anash të gjithë rivalët politikë duke i bashkuar rradhët e tij me njerëz të zgjedhur për nga besnikëria e jo për nga aftësitë profesionale ose përvoja politike.

Analisti i mbrojtjes Pavel Felgenhauer ka thënë për "Moscow Times", se politika e Kremilit për kontroll të Kaukazit nëpërmjet njerëzve të zgjedhur ishte në "dështim e sipër".

Duket se ushtria dhe shërbimet e fshehta ruse, të pareformuara dhe të korruptuara thellë, nuk mund t'i mbrojnë aleatët tanë. Nëse Putini nuk fillon të ndryshojë kahje, do të pasojnë edhe shumë katastrofa të tilla dhe ndikimi rus në Kaukaz do të vazhdojë të dobësohet.

Hapi i parë zyrtar i Putinit pas vrasjes së Kadyrovit ishte emërimi i djalit të Kadyrovit për zëvendësin e parë të kryeministrit të Çeçenisë.

Nën udhëheqjen e babait të tij, djali kryesonte "forcën e sigurisë që shumë çeçenë

dhe grupe të të drejtave të njeriut supozojnë se është përgjegjëse për kidnapim dhe keqpërdorim të civilëve", shkruan "Irish Examiner".

Emërimi sugjeron se, së paku, Putini është duke e mbajtur të hapur mundësin për një burrështeti alternativ.

Komiteti Zgjedhor i Çeçenisë duhet të merr vendim rreth zgjedhjeve për kryetar të republikës jo më vonë se 14 ditë pas ndërprerjes së pushtetit të kryetarit të Çeçenisë Akhmad Kadyrov, që është, deri më 23 maj 2003, raporton "RBC News Online".

Parlamenti çeçen duhet të merr vendim për zgjedhjet për kryetar, mirëpo ende nuk është formuar. Nuk duhet të kalojnë më shumë se 120 ditë pas ndërprerjes së pushtetit të kryetarit të republikës dhe jo më pak se 80 ditë pas caktimit të datës së zgjedhjeve, ka theksuar Veshnyakov. Zgjedhjet e parakohshme për kryetar të Çeçenisë duhet të mbahen para 5 shtatorit 2004.

Jim Bencivenga – csmonitor
21.5.2004

Burgu Ebu Garib-erë e keqe

Kush është ai që nuk pati mllëfi për shkak të pamjeve në burgun "Ebu Garib" dhe kush është ai që nuk i ka pëlçitur zemra nga frika për muslimanët që gjinden në burgjet e lirisë amerikane?!

Njeriu mund të pyet pse këto rreshta sot? Ku ishin para dy javëve, kur doli në shesh kjo aferë?

Përgjigja është: e vonuam shkrimin duke pritur drejtësinë amerikane, sepse ministria e punëve të jashtme të amerikës për çdo vit na kanë mësuar të nxjerrin raport vjetor për

të drejtat e njeriut në botë në këtë kohë. Të shohim sasinë e drejtësisë dhe lirive me të cilën ngjyroset Amerika. Raporti doli me datë 17/5/2004, kurse zëvendësministri i punëve të jashtme u mjaftua për rastin Ebu Garib me fjalët: "kryetari u gërdit nga ky veprim" e me këtë ua dha edhe një dënim të paparë më parë të burgosurve, kur ata shohin edhe këtë nënçmim nga ana amerikane.

Ky rast nxori në pah disa mësimë dhe dobi, të cilat mund ti përmbledhim në këto pika:

1- "As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty derisa ta pasosh fenë e tyre". (El- Bekare: 120).

2- Mos kërko mëshirë nga armiku yt, pasi që lufta në Irak është edhe luftë fetare dhe materiale, janë përmbledhur që të dyja.

3- vetëm muslimanët akuzohen për shkeljen e të drejtave të njeriut, kurse të tjerëve u arsyetohet, mere si shembull atë që ndodh në Gazë dhe Rafa, atë që e bëjnë buldozerët izraelite atje, gjë për të cilën avokati i Pentagonit thotë: "mbrojtje e vetes"!!

5- Administrata amerikane sot është duke përhapur terrorizmin dhe është duke e ndezur atë, duke e kërkuar luftën e tretë botërore...

6- Mburrja e administratës amerikane ka arritur në kulm, kurse kjo shkakton thyerjen e fuqisë së saj...

7- Ndodhitë e fundit shpalosën faktin se ka njerëz që janë më amerikan se amerikanët. Këto ditë doli një gazetar që shkruante në gazetën arabe duke e mbrotur rastin e "Ebu Garib" më shumë se sa u mbrojt Ramsfeldi.

8- Nifaku i nxori dhëmbët në shesh me këtë ndodhi, shfaqti lojalitetin ndaj Amerikës dhe distancimin nga populli i vet, pasi që këtë e pamë në disa intervista televizive...

9- Nuk duhet të mashtrohemi me raportet amerikane pas sodit, sidomos ato që kanë të bëjnë me liritë fetare, ato civile ose të drejtat e njeriut.

Në fund kjo është këshillë për popullin amerikan i cili dëshiron të jetojë në paqë në jetën e kësaj bote, ai duhet të distancohet nga veprimet e qeverisë së tyre, sepse era e veprimeve të tyre na e zuri frymën.

Velid ibën Uthman Reshudi

Përktheu: B.H.

21.5.2004

Arabia Saudite: Shoqatat bamirëse

Kush prej nesh nuk e njih Domino's Pizza? Është vështirë të gesh ndokënd që nuk e njih atë. E njëjta mund të thuhet për çdo global fast food që gjenden kudo rreth botës. Në anën tjetër është në mënyrë të barabartë është e vështirë të gjejmë dikend i cili nuk di që bilioneri amerikan i cili ka themeluar Domino's Pizza, Tom Monaghan, dhuron një pjesë të konsiderueshme të pasurisë së tij shoqatave dhe organizatave dhe institucione të ndryshme katolike. Ai ka themeluar një numër shkollash katolike dhe kolegësh misionare gjithashtu edhe një stacion televiziv me tematikë kristiane. Ai ka kontribuar shumë në aktivitetet e Kishës në

Amerikën Jugore, Afrikë dhe në Azinë juglindore. Për kundër kësaj a e ka akuzuar kush atë për financim terrorizmi?

Unë kam vizituar qendrën e UNESCO-s në Hartum pak vite më parë dhe isha i habitur që pashë të shfaqur mbi një mur një pikturë të Papës duke mbajtur një kryq me një dorë ndërsa duke e vendosur tjetrën mbi kokën e një afrikani të vogël. UNESCO-ja është e supozuar të jetë një agjenci ndërkombëtare humanitare dhe jo një organizatë kristiane. Megjithatë, kush e ka guximin për tu ngritur e kundërshtuar?

Njëherë ndërsa vizitoja kampet somaleze të refugjatëve në Kenia, unë u takova me një

nëpunës të UNHCR-së që e pashë duke shpërndarë kopje të Biblës në Somali në qendra të ndryshme për ushqimin e grave shtatëzëna dhe fëmijëve.

Unë e pyeta bashkëpunëtorin e tij somalez: "Si mundet që kjo të bëhet nën hundën e një agjencie ndërkombëtare?"

Ai u përgjigj në vesh: "Hesht ose ai do të të jap edhe ty një kopje të Biblës në arabisht!"

Unë nuk dua të flas këtu gjatë rreth përpjekjeve të misionarëve kristian rreth globit. Mjafton të thuhet që buxhetet e disa organizatave kristiane —si Global Vision e cila vepron në 90 vende rreth botës- i kalon buxhetet e disa vendeve të botës së tretë. Dyert e shumë vende janë të hapura gjërë misionarëve kristian për të grumbulluar dhe shpërndarë lirisht fondet. Disa nga këto organizata "humanitare" — duke përmendur këtu World Council of Churches janë të njohura për furnizimin e grupeve militante kristiane me armë dhe municione përkrah ushqimit dhe ilaçeve që ata kanë qenë të supozuar të shpërndajnë. Kjo ka ndodhur në vende si Sudani, Uganda dhe Çadi. Megjithatë kush guxon të flasë për këto?

Siç tashmë e kam thënë qëllimi im nuk është të shkruaj një artikull për punën e misionarëve kristian. Çfarë desha të flasë është fushata amerikane kundër shoqatave dhe oragizatave bamirëse muslimane që ka filluar që me 11 shtatorin dhe çdokush që ndjek lajmet është i informuar. Filloj si një thirrje për të ndaluar rrjedhjen e fondeve për terroristët. Pastaj një numër listash u publikuan me emrat e shoqatave bamirëse, bisneseve të muslimanëve dhe madje disa zyrtarë qeveritarë të cilët ishin të akuzuar pa as të voglën provë ose fakt për financim të terrorizmit. Disa llogari të bankave të tyre ishin bllokuar dhe disa nga pasuritë e tyre u shpronësuan. Mediat arabe dhe botërore

bënë një thirrje të hapur kundër kësaj fushate dashakeqëse. Pastaj vendet e botës islame një pas një ishin të urdhëruara të monitoronin aktivitetin financiar të shoqatave me aktivitet të brendshëm. Legjislacioni me shpejtësi u kalua gjë që rezultoi në marginalizim të punës bamirëse dhe së fundi në ç'rrënjosjen e saj të tërë.

Ne duhet të mbajmë në mendje kur ne lexojmë lajmet rreth Saudi National Commission for Relief dhe Charity Work Abroad. Këto do të jenë agjencitë e vetme që do të lejojnë të grumbullojnë dhe të shpërndajnë të gjithë donacionet bamirëse për përdorim nga jashtë. Çfarë do të thotë kjo?

Do të thotë që aktivitetet e jashtme të të gjitha shoqatave bamirëse saudite do të shkrihen dhe do të bëhen një komitet "kombëtar" dhe e gjithë pasuria e këtyre organizatave bamirëse do të merren nga ai. Një komitet i veçantë që do të prezantojë sektore të ndryshme të shoqërisë do të vendoset për të mbikëqyr këto fonde. Ky është informacioni zyrtarë që ka dalë së fundi nga zyra e ekspertëve të Këshillit të ministrave Saudit.

Ne kemi një të drejtë për tu bërë merak rreth këtij vendimi veçanërisht sepse nënkupton zhdukjen e të gjithë punës bamirëse, donacion i bujarisë së vendit tonë dhe një begati për shumë njerëz të varfër kudo nëpër botë.

Le ta zëmë se disa prej atyre që kanë punuar në organizata bamirëse kanë bërë gabime dhe nuk e kanë kryer si duhet punën e tyre. Nuk është e vërtetë që gabimet të jenë bërë nga çdo individ në këto shoqata apo organizata bamirëse aq të mëdha? Ne duhet të shikojmë me një sy të mprehtë në gabimet e tyre dhe të reagojmë. A nuk duhet të sillemi ne në një mënyrë pozitive, të hapur dhe transparente? Pse të mos përdoren politika që do të përmirësojnë punën e shoqatave bamirëse, në mënyrë të rregulltë dhe t'i

Abdullah bin Hamdan el-Selim
Marrë nga: islamtoday.net
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
28.5.2004

Zëvendësimi i zezakëve

Abu Ghraibi dhe gjenerata e re e planta- zheve

Sot, në një ditë të nxehtë në Dallas, Texas, qëndroj në pompën e benzinës me gazetën USA Today të paluar nën sjetull. Duke i fshirë djersët nga balli, shikoj ngadalë çmimin aktual të benzinës. Tani, kur shoh çmimin e ndryshuar prej 1.89 dollarë në 1.92 dollarë për gallon* benzine, më vjen edhe më nxehtë. I habitur lëkund i kokën dhe me hezitim vazhdoj të mbushi veturën me benzinë dhe përgatitem të filloj pjesën e dytë të ditës, që përbëhet nga shkuarja ime në punën e dytë. Përderisa pres të mbushet vetura, shfletoj gazetën dhe tmerrohem nga fotografia trishtuese që gjendet në faqen e parë.

Fotografia tregonte një ushtarë shtat-vogël, me një fanellë ngjyrë kafe të ushtrisë, që mbante një lloj rripi për qen. Nga ana tjetër e rripit gjendeshte një i burgosur luftarak irakian, i shtrirë në dyshemenë e burgut në agoni.

Përnjëherë, fotografia më detyroi të rikujtoj një kohë kur isha 12-vjeçar, kur vizitoja gjyshen time në Bronx (New York). Më kujtohet kur qëndroja në tavolinën e kuzhinës me kushëriun tim Terrince, dhe lexoja një revistë që përmbante një fotografi të tmerrshme të tre burrave të zi të varur për qafe, ndërsa kalimtarët e bardhë qeshnin dhe festonin.

Ajo fotografi tregoi një "fytyrë" të shkeljeve të të drejtave të njeriut për të cilat fliteshte në orët e mësimi në shkollë. Kjo fotografi e re, që tregon ushtaren Lynndie England tregon shkeljet e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur me vite të tëra, por që asnjëherë nuk janë incizuar (fotografuar). Kjo farsë e drejtësisë ka krijuar një përshtypje se qeveria amerikane ka paragjykim të rrezikshme kundër komunitetit musliman që janë të institucionalizuara në ushtri dhe të ngjitura në prodhimin e politikës së saj të jashtme.

Kjo hipokrizi është qartë e evidente, dhe krahasimet me robërinë tregojnë se shumë fraksione të qeverisë vazhdojnë të promovojnë demokraci, ndërsa veprimet e tyre tregojnë të kundërtën.

Si shumica e amerikanëve, prisja që shtatë ushtarët amerikanë që ishin zënë nga ushtarët irakianë të trajtohen me dinjitet. Më 24 mars 2003, kryetari Bush tha: "Presim që (të burgosurit amerikan të luftës) të trajtohen në mënyrë njerëzore". Kur ata u liruan më 14 prill, 2003, u raportua se shtatë ushtarët amerikanë ishin trajtuar në mënyrë të drejtë, dhe se u është dhënë ushqim, çaj, kujdes mjekësor dhe pixhame komfore.

Në një kontrast të ashpër, të burgosurit irakianë janë një popullatë e përzier që përbëhet nga terroristë nga shtetet fqinje, ba-

norë lokalë që janë ngritur kundër okupacionit dhe qytetarë të mesëm (të mbledhur gjatë bastisjeve nëpër hotele, shtëpi, etj) që nuk kanë qëllim të shkaktojnë dëm. Kryqi i Kuq ka theksuar se së paku 70 për qind të individëve të arrestuar janë të pafajshëm, dhe bijnë në kategorinë e fundit nga të tre që i përmenda. Pa nevojë për ta thënë, por ajo nuk e ndali një grup të caktuar të ushtarëve amerikanë të kryejnë veprime të dhunës dhe keqtrajtimit. Ushtarët amerikanë në fotografi shihen duke i keqtrajtuar të burgosurit nëpërmjet teknikave nënçmuese që përfshijnë devijim dhe degradim seksual. Të burgosurit ishin detyruar të xhvishen dhe të paradojnë brenda burgut. Gratë e burgosura muslimane, të njohura për modestinë e tyre tradicionale, ishin keqtrajtuar dhe ishin detyruar t'i tregojnë gjokset e tyre. Qenë sulmues ishin përdorë për të kërcënuar të burgosurit.

Si një afro-amerikan, këto veprime për mua janë të njohura. Përdorimi i qenve sulmues si armë më rikujton shikimin filmave bardhë e zi të *Eyes on the Prize*, që paraqet veprime të hollësishtme shtypëse nga kultura dominante kundër zezakëve gjatë lëvizjes për të drejtat qytetare. Në fjalë, kur zezakët kanë ardhë nga Afrika gjatë viteve të 1600-ta, ata ishin xhveshur nga veshëmbathja, krenaria, dinjiteti dhe feja. Afrikanët që ishin vendosur nëpër enklava në Amerikë kaluan nëpërmjet një procesi torturues të njohur si "sezonim", që është një term që i referohet procesit të thyerjes fizike të afrikanëve, thyerjes emocionale dhe psikologjike, dhe kështu duke i bërë ata të nënshtruar.

Pasi robërit erdhën në Amerikë, pjestarët e kulturës dominante dhunonin gratë vazhdimisht, burrat ishin të poshtëruar publikisht dhe fëmijët ishin ndarë dhe shitur. Ndoshta është e sigurtë të supozojmë se në Abu Ghraib ngjashmëritë më të mëdha i tejkalojnë dallimet.

Nuk ka dyshim në mendjen time se duke u bazuar në historinë ushtarake të keqpërdorimit seksual, se mundësia e dhunimit ndërmjet personelit ushtarak amerikan dhe të burgosurve femra të pambrojtura, është jashtëzakonisht e madhe. Procesi i "sezonimit" gjatë robërisë nuk ndryshon nga ajo që një ushtar në Abu Ghraib e përshkroi si "zbutje" të të burgosurve para marrjes në pyetje. Një nga lidhjet më të mëdha ndërmjet të burgosurve në Abu Ghraib dhe afrikanëve që erdhën në Amerikë është se shumica e të dy grupeve rrënjët e tyre (të prejardhjes) i kanë Islame. Kur afrikanët erdhën në Amerikë, shumica e tyre ishin muslimanë, ndërsa një grup më i vogël praktikonte fe tradicionale fisnore. Kur zezakët u takuan me protestantët në Amerikë, ata ishin të nënçmuar nga blloku i ankandëve, dhe ishin të detyruar në nënshtrim nga pronari i robërve pas ekspozimit në akte të dhunës. Ironikisht, 400 vjet më vonë, taktikat e njëjta janë ende aktuale.

Popullata e vjetër, gjatë asaj periudhe nuk kishte ligje për t'i mbojtur të drejtat qytetare të robërve, megjithatë ekzistojnë rregulla për të burgosurit e luftës për të inkurajuar integritetin dhe për të siguruar se ekziston trajtim i barabartë sipas ligjit.

Konventa e Gjenevës thekson se "asnjë lloj i torturës fizike ose mentale, ose çfarëdo forme tjetër të detyrimit, nuk duhet të shtrohet ndaj të burgosurve të luftës për të siguruar nga ata çfarëdo lloji të informatave" (Neni 17). Në Nenin 27 ajo vazhdon të theksojë "Se ata në çdo kohë duhet të trajtohen në mënyrë njerëzore, dhe të mbrohen kundër dhunës, ofendimeve dhe kërcënimeve. Gratë duhet të mbrohen në mënyrë të posaçme ndaj sulmit, dhunimit, prostituimit dhe sulmit të padenjë". Hipokrizia e qeverisë më ka bërë skeptik për motivet rreth ven-

dimit të tyre për të sulmuar dhe okupuar Irakun. A është e motivuar qeveria nga përfitimi nga lufta (Halliburton), apo është motivi i fshehtë për të shtypur zgjerimin e Islamit, si një pjesë e “Rendit të ri botëror”? “Uaaa!”, bërtita kur pash se benzina kishte filluar të derdhet. Në vend se të mërzitem për der-

dhjen e benzinës së shtrenjtë, reflektohem në agoninë dhe nënçmimin e vëllezërve të mi muslimanë në Abu Ghraib. Këto krahasime trishtuese me përvojën afro-amerikane ilustrjnë se jo vetëm që historia përsëritet, por ajo poashtu shpalos fytyrën ndryshuese të zezakëve në shoqërinë tonë.

Lamont Slater

Autori është gazetar i pavarur nga Dallasi

*1 gallon = 3.785 litra

4.6.2004

Çka i ofrohet botës?

“Pra, si mund ta theksojmë çështjen e emancipimit të femrës në botën muslimane?”, pyet Richard Perle në “An End to Evil”. Dhe përgjigjet, “Duhet ta rikujtojmë femrën muslimane pa ndërprerë: Armiqët tanë janë edhe armiqtë e tyre; fitorja jonë do të jetë edhe e tyre”.

Mirëpo, kauza neo-konservative “e emancipimit të femrës në botën muslimane” ndoshta ishte kthyer mbrapsht nga fotografia e ushtares Lynndie England dhe “Girl’s gone wild-vajzat e azdisura” të burgut Abu Ghraib.

Vërtetë, orgjitë e fotografuara në mes të policisë ushtarake amerikane jashtë qelive të burgjeve irakiane, nënçmimi S&M i burrave muslimanë, dhe keqtrajtimi seksual ndaj grave muslimane çojnë në parashtrimin e një pyetjeje. Saktësisht, cilat janë “vlerat” të cilat Perëndimi duhet t’ia mësojë botës muslimane?

“Kjo luftë... është — thellësisht për — seks”, pohon neo-konservativi Charles Krauthammer. Islami militant “kërcënohet nga Perëndimi për shkak të doktrinës tonë të çift të barazisë dhe lirisë seksuale”.

Por, për cilat “doktrina çift” është duke folur Krauthammer? Liria seksuale që ai e quan “tonë(n)” i takon revolucionit të viteve të ’60-ta që krishterët, hebrenjtë dhe muslimanët e kishin rezistuar me vite të tëra.

Çfarë do të thotë Krauthammer me lirinë seksuale? Të drejtën e “tinejxhereve” për tu veshur dhe sjellur si Britney Spears? Të drejtën e tyre për kondomë, në shkollë? Të drejtën e tyre për abort, pa pëlqimin e prindërve?

Nëse konservativët e refuzojnë “barazinë” e ligjësuar nga Gloria Steinem, Betty Friedan, NARAL dhe National Organization for Women (Organizatën Kombëtare të Gruas), pse atëherë ata kërkojnë ta imponojnë atë në botën muslimane?

Pse mos të qëndrojnë pranë Islamit dhe kundër Hollywoodit dhe Hillaryt?

Në qershor të vitit 2002 në West Point, kryetari amerikan Bush tha, “E vërteta morale është e njëjtë në çdo kulturë, në çdo kohë dhe në çdo vend”.

Madje edhe John Kerry nuk pajtohet me Bushin rreth moralit të bashkësive homosek-

suale dhe huluntimit të qelizave të shumueshme. Në çështje të tilla, amerikanët konservativë kanë më shumë gjëra të përbashkëta me muslimanët se sa me demokratët liberalë.

Kryetari i ndarë nga amerikanët që nuk pajtohen rreth asaj se çka është e vërteta morale. Për dikë që para disa viteve ka thënë se në këtë shtet është duke u zhvilluar një luftë kulturore, luftë fetare. Është një çështje se kush jemi, në çka besojmë dhe çka përkrahim si popull. Atë që dikush nga ne e sheh si degradim moral të një republike të denjë në dekadencë imperiale, neo-konservativët e shohin atë si një rast të mirë për të sunduar me botën. Paradokohe në Georgia, kryetari deklaroi: “Nuk mund t’ju them se sa krenar jam për përcaktimin tonë për vlerat. ...Ai përcaktim për vlerat do të jetë një pjesë integrale e politikës tonë të jashtme gjatë lëvizjes tonë përpara. Këto nuk janë vlera amerikane, këto janë vlera universale. Vlera që flasin të vërteta universale”.

Por, për cilat vlera universale është duke folur ai? Nëse ai ka për qëllim të imponojë vlerat e MTV Amerika në botën muslimane në emër të “revolucionit demokratik botëror” ai do të provokojë dhe nxitë luftë të qytetërimeve ku Amerika nuk mund të fitojë për shkak se amerikanët nuk dëshirojnë të luftojnë. Kjo mund të jetë luftë e neo-konservativëve. Jo e jona.

Kur Bushi flet për lirinë si një dhuratë e Zotit për njerëzimin, a i referohet ai lirisë së First Amendment (Amandamentit të parë) të Larry Flyntit për të prodhuar pornografi dhe

të Salman Rushdie ... libër që konsiderohet blasfemi për fenë Islame?

Nëse bota Islame e refuzon këtë nocion të lirisë, pse ta kemi ne për detyrë ta ndryshojmë mendimin e tyre? Pse janë ata gabim? Kur presidenti flet për lirinë, a i referohet ai ndalesës së Amandamentit të parë kundër fëmijëve tanë të lexojnë Biblën dhe kundër mësimin të Dhjetë Urdhërave në shkollë?

Nëse kryetari dëshiron të luftojë një kryqëzatë morale, ai duhet të dijë se armiku është brenda dyerve. Kërcënimet e mëdha morale dhe kulturore për civilizimin tonë nuk vijnë nga jashtë Amerikës, por nga brenda. I njohim armiqtë, ne jemi ata.

Lufta për shpirtin e Amerikës nuk do të humbet ose fitohet në Falluxha. Për fat të keq, Amerika pagane e vitit 2004 ka shumë më pak t’i ofrojë botës në pasurinë kulturore se sa Amerika krishtere e vitit 1954. Pjesa më e madhe e filmave, librave, revistave, emisioneve televizive, dhe muzikën që ia eksportojmë botës janë po aq helmuese sa narkotikët që Flota mbretërore i imponoi ndaj popullit kinez në Luftërat e Opiumit.

Një shoqëri që pranon vrasjen e një të tretën e foshnjëve të saja, si një “emancipim” i femrës, që konsideron martesën ndërmjet gjinisë së njëjtë si përparim shoqëror, që u shpërndan kontraceptivë vajzave 13-vjeçare nëpër shkolla, si duket është duke dalë si një ekzorçist – në vend se të del në skenë si Elmer Gantry dhe të ligjërojë rreth superioritetit të “vlerave amerikane”.

Patrick J. Buchanan, Creators Syndicate
11.6.2004

Islami në Kinë

Pjesa më e madhe e muslimanëve të Kinës janë turkmenët që jetojnë në rajonin Xinjiang që gjendet në pjesën veri-perëndimore të Kinës. Pjesa tjetër janë kinezët Hiu ose të tjerët që kanë pranuar Islamin, ose madje fëmijët e kinezëve të martuar me emigrantë muslimanë, paraqitja (pamja) e të cilëve është tipike kineze. Ata jetojnë në komunitete të mëdha në pjesën perëndimore dhe qendrore të Kinës, në provincën jugore Yunnan dhe nëpër qytetet industriale dhe limaneve të pjesës lindore.

Kontaktet ndërmjet muslimanëve dhe kinezëve kanë filluar shumë herët. Tregtarët arabë kanë udhëtuar në Kinë edhe para ardhjes së Islamit, dhe tradita ka shkaktuar që feja e re të sillet në kolonitë tregtare nga muslimanët në shekullin 7.

Në vitin 755, një kontingjent prej 4 mijë ushtarëve, shumica turq muslimanë, ishte dërguar nga Halifi Ebu Xhafer El-Mensur për të ndihmuar perandorin kinez Su Tsung, që të qetësojë revoltën nga një komandant i tij ushtarak An LuShan. Pas rimarrjes së kryeqytetit imperial, Ch'angan (Xiani i sotëm), këta ushtarë të vendosur në Kinë, janë martuar me bashkëshorte kineze dhe kanë formuar koloni muslimane të ngjashme me ato të cilat ishin themeluar nga tregtarët.

Islami, përhapjen e parë të vërtetë në pjesën që sot njihet si pjesa perëndimore e Kinës, e bëri nga mesi i shekullit 10, me konvertimin e Sultanit Sutuq Bughrakhan nga Kashgari.

Gjatë Dinastisë Song (960-1279), Kina përjetoi një rritje spektakulare ekonomike. Kjo stimuloi zgjerimin e komuniteteve tregtare muslimane – sidomos në Ch'angan, terminologjia lindore e rrugëve të tregtisë, dhe në qytetet-limane të Quanzhou dhe Guang-

zhou, ku muslimanët me të madhe kanë udhëhequr çështjet e brendshme të lagjeve të tyre, duke ndërtuar xhami dhe duke caktuar kadi për të gjykuar sipas ligjit Islam.

Por, edhe pse disa tregtarë kinezë, të involvuar në tregtinë ndërkombëtare u bënë muslimanë, pjesa tjetër e të konvertuarve ishte e vogël dhe Islami në Kinë në përgjithësi ishte kufizuar tek emigrantët muslimanë dhe pasardhësit e tyre.

Invazioni i mongolëve rrëzoi Dinastinë Song dhe siguroi, siç e konsiderojnë kinezët muslimanë, “epokën e artë” të Islamit në Kinë.

Edhe pse Dinastia Mongole Yuan (1260-1382) e themeluar nga Kublai Khan, ishte i vetmi nga katër kanatet e mëdhenj mongolë, sunduesit e të cilëve asnjëherë nuk e pranuan Islamin, ata megjithatë u dhanë muslimanëve status të posaçëm, zakonisht duke i vendosur besimtarët individual nëpër pozita përgjegjëse, madje edhe të fuqishme të shtetit. Përveç kësaj, kur Yunnani ra në duar pushtuesve mongolë dhe pjesa më e madhe e popullatës iku, duke lënë vendin të zbrazët, Kublai Khan ka dërguar ushtarët e fuqishëm muslimanë nga Azia Qendrore, të cilët e kanë ndimuar atë të pushtojë Kinën, për të ripopulluar jugun – edhe pse kjo me siguri pjesërisht ishte me qëllim që t'i mbajë ata jashtë sundimit të gabueshëm dhe larg kryeqytetit të tyre. Poashtu gjatë periudhës mongole turqit uigur nga pjesa veri-perëndimore e Kinës ishin konvertuar në Islam.

Pas konvertimit të mongolëve changhatai të Azisë Qendrore në shekullin 13, pjesë të mëdha të veri-perëndimit të Xinjiangut u përfituan nga Islami. Në vitin 1513 oazat Hami në lindje të Xinjiangut u vendosën nën sovranitet të Mansur Changhatai, i cili dy vjet

më vonë e bëri atë kryeqytet të tij dhe një bazë prej të cilës do të zgjëronte Islamit edhe më tej në lindje.

Në shekullin 20, muslimanët anembanë Kinës kanë vazhduar të praktikojnë fenë fshehtas, pas paraqitjes së komunizmit, pavarësisht nga principet ateiste të ideologjisë. Por gjatë vrzhhdësive dhe pastrimeve të Revolucionit Kulturor, ndërmjet viteve 1966 dhe 1971, pjesa më e madhe e xhamive u shkatërruan ose u mbyllën. Pastaj, pas vdekjes së Mao Ze Dongut, muslimanëve sërish iu dha një pjesë e kufizuar e lirisë fetare. Xhamitë dhe shkollat fetare u rihapën dhe disa qindra muslimanë u lejuan të bëjnë Haxhxin në Mekke.

Më shumë se 2400 kilometra nga Pekini dhe vetëm një udhëtim të shkurtë nga Hong Kongu, Guangzhou çdoherë ka qenë më i hapur ndaj ndikimit të jashtëm se sa qytetet tjera kineze. Xhamia saj konsiderohet të jetë xhamia më e vjetër në Kinë. E themeluar prej njërit nga muslimanët e parë në Kinë, para rreth 1300 vjetëve, xhamia Huaisheng ka një pëzierje të stileve të arkitekturës: një

minare 36-metërshe në formë koni, e ndërtuar gjatë Dinastisë Tang (618-906), kulla mbi oborrin e mbuluar dhe kulme të gjëra të sallës për falje, e ndërtuar për të zëvendësuar origjinalin që ishte shkatërruar nga zjarri në vitin 1343.

Xhamia poashtu njihet edhe si Kulla sinjalizuese, për shkak se gjatë Dinastive Tang dhe Sung, kur niveli i lumit ishte afër minares – para se të ulet dhe të largohet – një dritë ishte e vendosur majë të minares dhe ajo ka ndriçuar natën për qëllime navigacioni.

Një nga limanet më të mëdha në botë, Quanzhou kulmin e prosperitetit të saj e ka arritur gjatë revolucionit komercial të Dinastisë Sung, ku tregtarët muslimanë kanë luajtur rolin kryesor.

Sot, ato aktivitete të mëdha të tregtisë nuk ekzistojnë më. Ato i kanë lënë qytetit një pasuri të madhe. Nga xhamitë e qytetit, që dikur ishin shtatë, sot vetëm një ka mbetur. Mirëpo muret masive të granitit të xhamisë Mesxhid El-As'hab, e ndërtuar në vitin 1009 në këtë pikë më lindore të Islamit, reflektojnë vitalitetin e vazhdueshëm të fesë...

[Zgjedhur nga: "Aramco World", Nëntor-Dhjetor 1991. Redaktor John Lawton]

Marrë nga: IslamWeb

Përktheu: Xh.A.

Koha pasuria më e çmueshme

Jeta e njeriut është një periudhë kohe e paditur (nga njeriu) e matur në orë, minuta dhe sekonda.

Çdo moment që kalon shkurton këtë periudhë dhe e sjell njeriun më pranë vdekjes. Çdo moment që kalon i afrohem ditës së Gjykimit. Çdo gjë që ka fillim natyrisht duhet të ketë mbarim. Është fund i sigurtë, i pashmangshëm. S'ka kthim! As për një sekondë! S'ka shpëtim (nga vdekja)! As që të mendohet! Allahu i madhëruar urdhëron e thotë në Kur'an: "E kush shpreson takimin e Allahut, s'ka dyshim se afati i Allahut (vdekja) patjetër do vijë..." (29:5)

Në një ajet tjetër i Madhëruari Allah thotë: "Janë të humbur Ata të cilët përgënjeshtroan takimin e Allahut (në ditën e gjykimit), derisa t'u vijë momenti (shenjat e vdekjes) befas e të thonë: "Të mjerët ne për atë që lëshuam (për punët e mira në jetën e dynjasë), e duke i mbartur gabimet e veta në shpinë, dhe vërtet e shëmtuar është ajo që mbar-tin." (Qur'ani, 6:31)

Me siguri, do të përgjigjemi për kohën. Si dhe në çfarë e kaluam? A e shfrytëzuam atë për të realizuar qëllimin kryesor të jetës, apo e humbëm kot, pa ndonjë qëllim? A ishim adhures të Allahut dhe vepërmirë apo adhures të epsheve dhe keqbërës? A mendojmë për fundin (vdekjen) që na pret dhe që të gjithë, pa përjashtim, do ta shijojmë apo jemi në një gjumë të thellë dhe nuk duam të përkujtohem?

Allahu Fuqiptotë urdhëron e thotë: "Ç'do shpirt (krijesë) do të shijojë vdekjen, e shpërblimet tuaja u jepen ditën e kijametit, e kush shmanget nga zjarri e futet në xhenet, ai ka arritur sukses (shpëtim), e jeta e kësaj bote nuk është tjetër vetëm se një përjetim mashtrues." (Kur'ani, 3:185)

Meqenëse është fund i pashmangshëm atëherë s'është shumë e rëndësishme se sa kohë jetojmë. Disa e arrijmë këtë fund herët, të tjerët më vonë, por me siguri të gjithë do ta arrijmë. Megjithatë, kjo periudhë kohe që na është dhënë është e një rëndësie kolosale për sa i përket të ardhmes sonë të përjetshme në botën e amshueshme. E ardhmja dhe fati jonë përcaktohet nga kjo jetë. Ç'të mbjellim do të korrim. Çdo gjë që bëjmë, e mirë apo e keqe, qoftë edhe sa grimca, do e gjejmë. Mos të harrojmë momentin e vdekjes, aq më tepër kur e dimë se mund të vijë befas pa paralajmërim.

Allahu, Fuqiptotë, na urdhëron që të kryejmë vepra të mira para se të vijë ajo ditë kur s'bën dobi pasuria as pasardhësit. Atë ditë kur çdo gjë e kësaj bote është e pavlerë, përveç besimit të sinqertë dhe veprave të mira. Atë ditë kur s'ka ndihmues a ndërmjetës përveç Allahut. Atë ditë kur dënimi i Allahut është i paimagjinueshëm i tmerrshëm. Është ajo ditë kur krijesat mblidhen për hesap në prani të Krijuesit, kur çdonjëri merr shpërblimin që meriton, dhe përfundimisht të vendoset në venbanimin e përjetshëm për të mos vdekur më.

Allahu betohet në kohën për të na bërë të qartë rëndësinë e saj në këtë jetë: "Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrit t'i përmbahen të vërtetës (këshillojnë njëri-tjetrit të kryejnë vepra të mira që Allahu ka urdhëruar dhe t'u largohen veprave të liga që Allahu ka ndaluar) dhe që këshilluan njëri-tjetrit të jenë të durueshëm (për vuajtjet dhe vështirësitë që mund të ndeshin në rrugën e Allahut)."

Allahu I Madhëruar, për të mirën tonë, na paralajmëron për atë ditë dhe të keqen e asaj: "Sikur ta dinin ata që nuk besuan se atëherë nuk do të mund të largojnë zjarrin nga fytyrat e tyre dhe as nga shpinat, e as që nuk do të ndihmohen (nuk do të ishin jobesimtarë)." (Kur'ani, 21:39)

Përsëri, në një ajet tjetër në Kur'an, urdhërohem për vepra të mira para se të vijë vdekja dhe në të njëjtën kohë (po në këtë ajet) paralajmërohem për mos kryerjen e veprave të mira. Ai, Fuqiploti, thotë: "Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë, para se ndonjërit prej jush t'i vijë vdekja, e atëherë të thotë: 'Zoti im, përse nuk më zgjate edhe pak afatin (e vdekjes) që të jepsha lëmoshë

e të bëhesha prej të mirëve! Por Allahu kur sesi askë nuk e shtyn për më vonë, kur atij t'i vijë afati. E Allahu është I Gjith-Dijshëm për atë që ju punoni." (Kur'an, 63: 10,11)

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) ka thënë: "Shfrytëzoni pesë gjëra para pesë tjerash: 'Rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para zënies (me punë) dhe jetën para vdekjes." (Transmetuar nga Al-Hakim)

Gjërat e përmendura në hadith janë me rëndësi jetike. Rëndësinë e tyre vetëm ai që i ka humbur e din. Lufta në rrugën e Allahut në këtë jetë që të kapërcesh vështirësitë dhe mos të pendohesh për jetën në ditën e gjykimit. Allahu thotë: "Dhe përmbahuni asaj më të mirës që u është shpallur nga Zoti juaj, para se t'ju vijë dënimi befas e ju të mos dini. Dhe të mos thotë ndokush: 'O I mjeri unë që kam lënë mangut respektimin ndaj Allahut dhe që kam qenë prej atyre që talleshin!" (Kur'ani, 39: 55-56)

Së fundi, mos të harrojmë qëllimin e krijimit për të adhuruar Allahun, Zot të Vetëm, dhe kohën t'ia kushtojmë këtij qëllimi fisnik. Allahu thotë në Kur'an: "Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë." (51:56)

Medi Zeqiri
14 Mars, 2004
21.5.2004

Sulejmani-paqja dhe shpëtimi qofshin mbi të

Sulejmani, alejhis-selam, trashëgoi nga Davudi, alejhis-selam, peygamberllëkun dhe sundimin. Allahu në Kur'anin famëlartë tregon: "Ne Davudit i falëm Sulejmanin, rob shumë i mirë dhe shumë i kthyer nga Zoti". (Kur'an, Sad 30).

-Ky nuk ishte trashëgim material, sepse peygamberët nuk lënë trashëgim pronën dhe pasurinë e tyre. Por nese lënë pasuri ajo ju ipet të varfërve dhe të nevojtarëve, e jo të afërmve (trashigëmtarëve).

-Muhamedi, alejhis-selam, ka thënë: "Pasuria e Pejgamberëve nuk do të trashëgohet, dhe çfarëdo që lëmë trashigim duhet të ipet lëmoshë". (Sahih Buhari).

-Ne i patëm dhënë Davudit dhe Sulejmanit dituri, e ata të dy thanë: "I falënderohemi vetëm All-llahut që na dalloi (me të mira) mbi shumë robër të Tij besimtarë". E Sulejmani e trashëgoi Davudin dhe tha: "O njerëz, ne kuptojmë gjuhën e shpendëve e na është dhuruar nga gjithçka, e, vërtet ky është shpërblim i qartë". E Sulejmanit i ishte tubuar ushtria e vet që përbëhej nga exhinët, nga njerëzit dhe nga shpendët dhe ata mbanin rendin. (Kur'an, Neml 15-17).

-Pas vdekjes së babit të tij Davudit, alejhis-selam, Sulejmani, alejhis-selam, u bë mbret. Ai luste Allahun për mbretëri që askush pas tij nuk do ta ketë, dhe Allahu ia pranoi lutjen e tij. Përveq kësaj mençurisë, dhe urtësisë Allahu e bekoj Sulejmanin, alejhis-selam, edhe me shumë mundësi tjera. Sulejmani, alejhis-selam, kishte mundësi të drejtonte erërat, dhe kuptonte dhe fliste gjuhën e shpezve, exhinëve dhe shtazëve. Allahu e urdhëroj Sulejmanin, alejhis-selam, ti mësonte të dy palët njerëzit dhe xhinët të gërmojnë tokën dhe të nxjerrin mineralet e saj dhe të ndërtojnë nga to orendi të ndryshme dhe armë. Allahu gjithashtu e favorizojë atë me një minierë nga bakri që ishte metali më i mirë në atë kohë.

-Gjatë kohës së tij kuajt ishin mjet i zakonshëm i transportit. Ata kishin veti themelore për mbrojtje, të mbajnë me vete ushtarët dhe të transportojnë ushqimet dhe armët e luftës. Shtazët ishin mirë të mbajtura dhe të trajnuara. Një ditë Sulejmani, alejhis-selam, bëri një rishikim dhe demonstrim të shtallës së tij. Durimi, bukuria dhe qëndrimi i kuajve e fascionuan Sulejmanin, alejhis-selam, aq shumë saqë vazhdojë t'i ledhatojë dhe t'i

admiroj kuajt. Dielli ishte gati në perëndim, dhe koha për faljen e mesme ishte gati duke përfunduar. Kur ai e kuptoi këtë, ai bëri thirrje: "Unë sigurisht se i dua gjërat e stolisura të jetës më tepër sesa përkushtimin ndaj Zotit tim! Kthej ato tek unë".

-Allahu shfaqti: Kur në një parambrëmje iu shfaqën atij kuaj që, kur ishin të ndalur, rrinin gatitu në tri këmbë, e ishin edhe shumë të shpejtë. E ai tha: "Unë i dhashë përparësi dashurisë së kuajve, ndaj Zotit tim, derisa (dielli) e fsheh dhe perëndoi". "M'i ktheni ata mua!" Atëherë filloi t'u mësojë këmbëve e qafave. Ne e sprovuam Sulejmanin dhe e mbajtëm në postin e tij si një trup, e pastaj u rikthye në gjendjen e parë. Tha: "Zoti im, më fal (gabimin), më dhuro asi pushteti që askush pas meje nuk do të ketë; vërtet, Ti je Dhuruesi më i madh. Ne ia nënshtruam erën që, sipas urdhërit të tij, ajo të ecën lehtë dhe nga të dëshirojë ai. Ndërsa djajtë (ia nënshtruam) për çdo ndërtim dhe zhytje në ujë. Dhe të tjerët (djaj) që ishin të lidhur në pranga. Ky është shpërblimi Ynë, e ti dhuro ose mos dhuro, për këtë nuk përgjigjesh. Ai vërtet ka vend të lartë te Ne dhe ardhmëri të mirë. (Kur'an Sad 30-40).

-Një ditë Sulejmani, alejhis-selam, grumbulloi ushtrinë e tij, që kishte batalione të ndryshme prej njerëzve, xhinëve, shpezëve dhe shtazëve. Ai i marshoi ata në vendin e Askalonit. Sapo ishin duke kaluar në një luginë, një thnegël e pa ushtrinë e Sulejmanit se po afrohen në atë drejtim, dhe filloi t'i thërras dhe t'ju tërheq vëmendjen thneglave tjera. "Kthehuni në shtëpitë tuaja. Përndryshe Sulejmani dhe ushtria e tij do të ju shkelin pa ju vrejtur fare!" Sulejmani kur dëgjoj fjalët e thneglës buzqeshi. Atij i vinte mirë që thnegla e kishte kuptuar se ai ishte i Dërguar i Allahut xh. sh, dhe se nuk do t'ju shkaktojë qëllimisht dëm krijesave të Allahut. Dhe

Sulejmani, alejhis-selam, e falënderoi Allahun që shpëtoi jetërat e thneglave.

-Allahu tregon: "E Sulejmanit ishte tubuar ushtria e vet që përbëhej nga exhinët, nga njerëzit dhe nga shpendët dhe ata mbanin rendin. Deri atëherë kur arritën mbi luginën e buburrecave, një buburrec tha: "O ju buburreca, hyni në vendet tuaja që të mos u coptojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos ju vërejtur". E ai (Sulejmani) buzëqeshi i gëzuar prej fjalës së tij dhe tha: "Zoti im, më mundëso që të falënderoj të mirat Tuaja që m'i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më shtie në mesin e robërve Tuaj të mirë!"(Kur'an, Neml 17-19).

-Në Jerusalem, në një gur gjigant Sulejmani, alejhis-selam, ndërtoi tempullin e tij shumë të bukur, që t'i tërheq njerëzit që vijnë aty dhe t'i bëjnë ibadet Allahut . Sot ky tempull është i njohur me emrin "Kupolla e Gurit", prej aty një numër i madh i pasuesve ju bashkangjiten Sulejmanit në kryerjen e Haxhit për në qytetin e shenjtë të Mekës. Pasi që e kompletuan haxhin e tyre, ata udhëtuan për në Jemen dhe arritën në qytetin e San'a. Sulejmani, alejhis-selam, mbeti i impresionuar me metodat e shquara të tyre për kanalizimin e ujit nëpër të gjitha qytetet e tyre. Ai ishte i etur që të ndërtoj një sistem të njëjtë të ujit në vendin e tij, por nuk kishte mjaft pranvera.

-Ai ishte nisur për të gjetur zogun pupëz, i cili kishte mundësi që ta zbulonte ujin nën tokë. Ai kishte dërguar sinjale për zogjtë pupëz për t'ju lajmëruar, por askush nuk i përgjigjej sinjaleve të tij. Në zemërim, ai deklaroi se nëse zogu nuk ka arsye të fortë për mospërgjegjën ndaj tij, do ta dënoj ashpër.

-Zogu pupëz përfundimisht erdhi tek Sulejmani, alejhis-selam, dhe i shpjegoi arsyen për vonesën e tij: "Kam zbuluar diçka që ti

nuk ke njohuri fare për atë gjë. Unë kam ardhur nga Sebei (Sab'a) me lajme shumë me rëndësi". Dhe zogu vazhdoi: "Sebei është e drejtuar nga mbretëresha me emrin Belkize (Bilqis), e cila ka çdo send me bollëk, duke përfshirë edhe fronin madhështor. Por edhe përkundër tërë kësaj pasurie e bollëku shejtani ka hyrë në zemrën e saj dhe në zemrat e popullit të saj. Ajo drejton mendjet e tyre plotësisht. Isha i shokuar kur pashë se ata po e adhurojnë Diellin në vend të Allahut të Plotëfuqishëm .

-Për të konfirmuar mesazhin e zogut Sulejmani, alejhis-selam, e ia dërgoi Belkizes një letër me anë të zogut. Ai e udhëzoi zogun që të fshihet dhe të shiqon çdo reagim të saj.

-Zogu e lëshoi letrën para mbretëreshës Belkize dhe fluturoi për t'u fshehur. Ajo menjëherë si kureshtare e hapi letrën dhe e lexoi "Vërtet!. Dhe e lexon: " Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) "Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!" (Bismil-lahir-Rahmanir-Rrahim!) (në vazhdim shkruan) "Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (edhe besimtarë)!"(Kur'an El-Neml 30-31)"

-Mbretëresha ishte shumë e shqetësuar dhe menjëherë ftoj në mbledhje këshilltarët e saj. Ata reagues si ftesë për luftë, dhe e ndienin këtë si sfidë që u bëhej atyre, informacion për luftë dhe humbje, dhe duke kërkuar nga ata nënshtrim të kësaj kërkesë.

-Ata i thanë mbretëreshës Belkize se ata munden vetëm ti ofrojnë këshillë, por është e drejta e saj të urdhërojë për luftë. Ajo e kuptoi se ata dëshironin të takojnë invazionin e Sulejmanit, alejhis-selam, kërcnim me luftë. Megjithatë ajo ju tha: "Paqja dhe miqësia është më e mirë dhe më e mençur, lufta bie vetëm poshtërim, skllavërim për njerëzit dhe i shkatëron gjërat e mira. Unë kam vendosur që ti dërgoj dhurata Sulejmanit, alej-

his-selam, të zgjedhur nga thesari më i çmuar që kemi. Njerëzit që do ti dërgojnë dhuratat tek Sulejmani, alejhis-selam, do të kenë rastin të mësojnë për të, mundësitë e tij dhe të ushtrisë së tij.

-Skuadra zbuluese e Sulejmanit, alejhis-selam, e informuan atë se po vijnë të dërguarit e mbretreshës Belkize me dhuratat e saja. Ai menjëherë e kuptoi se mbretëresha i ka dërguar njerëzit e saj në mision kontrollues, kështu ai dha urdhër për grumbullim të ushtrisë së tij. Të dërguarit e Belkizës duke hyrë në mes të ushtrisë së Sulejmanit e kuptuan se fuqia e ushtrisë së tyre ishte asgjë në krahasim me ushtrinë e Sulejmanit. Ata filluan t'i nënçmojnë dhuratat e tyre, duke kaluar nëpër dyshemet e pallatit të Sulejmanit, i cili ishte i ndërtuar nga dru sandali dhe në brendësi nga ari.

-Ata e lajmëruan Sulejmanin, alejhis-selam, për studimin e ushtrisë së tij, dhe ata ishin të befasuar me numrin dhe shumëllojshmërinë e ushtarëve, e cila përfshinte luaj, tigra dhe shpezë. Të dërguarit e Belkizes mbetën të shtangur nga habia, duke kuptuar se ata po qëndronin para një ushtrie të pabërballueshme.

-Lajmëtarët e Belkizes mbetën të mahnitur nga madhështia dhe shkëlqimi që i rrethonte. Ata padurueshëm i prezentuan dhuratat e mbretreshës së tyre dhe i thanë Sulejmanit, alejhis-selam, se Belkizja ka dëshirë që t'i pranosh këto dhurata si një akt i miqësisë. Ata mbetën të shokuar nga reagimi i tij: Ai as që kërkoi që të hapen dhuratat nga lajmëtarët e Belkizes. Ai ju tha atyre: "Allahu më ka japur me bollëk pasuri, mbretëri të madhe dhe profetësinë. Prandaj, unë jamë përtej mitosjes. Qëllimi im kryesor është që të përhapi besimin në Tevhid, në Njëshmërinë e Allahut".

-Ai gjithashtu ju drejtua atyre që t'i kthejnë prapa dhuratat e tyre te mbretëresha e tyre dhe t'i thojnë asaj që nëse nuk ndalet nga mënyra e saj e adhurimit ai do të ç'rrejnos mbretërinë e saj, dhe do ta largojë popullin e saj nga ajo tokë.

-Të dërguarit e mbretreshës u kthyen mbrapa me dhuratat e tyre dhe ja përcollën porosinë e Sulejmanit, alejhis-selam, mbretreshës së tyre. Ata gjithashtu i rrëfyen asaj për gjërat e mrekullueshme që i kanë parë. Në vend që të merr ofensivë, ajo vendosi që ta vizitojë Sulejmanin, alejhis-selam.

-Në shoqërim me titullarët mbretëror dhe shërbyesit, ajo e la Sebëin, duke dërguar një lajmëtar para saj që të informoi Sulejmanin, alejhis-selam, se ajo është duke arrdhur që ta vizitojë atë.

-Sulejmani i mblodhi exhinët të mbretërisë së tij, dhe i pyeti se cili nga ata ka mundësi që t'ja sjell atij fronin e Belkizes tek ai para se ajo të arrijë. Njëri nga ata tha: "Unë do ta sjell tek ti para se të kryhet kjo mbledhje"! Sulejmani, alejhis-selam, nuk reagoi fare në këtë propozim, siq dukej ai priste metodë më të shpejtë. Exhinë filluan të garojnë ndërmjet veti vetëm për ta kënaqur atë. Njëri nga ata me emrin Ifrit tha: "Unë do ta sjell për ty, sa të mbyllësh kapakët e syrit".

Dhe më shpejt se kjo, exhini që kishte njohurinë e Librit, hala pa u ngritur Sulejmani nga karriga, dhe froni i Belkizes ishte para tij. Me të vërtetë ky mision i exhinit Ifrit zgjati sa një rrahje e kapakut të syrit. Tempulli i Sulejmanit ishte në Palestinë, ndërsa froni i Belkizes ishte në Jemen. Tre mijë kilometra më larg. Kjo ishte një mrekulli e vërtetë e zbatuar nëpërmjet atyre që qëndronin me Sulejmanin, alejhis-selam.

-Kur mbretëresha Belkize arriti në pallatin e Sulejmanit, ajo ishte e mirëpritur me madhështi dhe kremtim. Pastaj duke treguar

fronin, Sulejmani e pyeti Belkizen se a është i njëjtë froni i saj në Jemen sikurse ky. Ajo filloi ta shiqojë, e ta shiqojë. Në mendjen e saj ajo ishte e bindur se froni të cilin po e shiqon nuk mundet të jetë froni i saj i cili gjindet në Jemen. Dhe ajo e zbuloi ngjashmërinë e mrekullueshme dhe tha: "Është sikurse të ishte ai origjinali që e kam, dhe është i ngjajshëm me atë në çdo lidhje, unë e respektoj". Sulejmani, alejhis-selam, gjykoj se ajo ishte e mençur dhe diplomatike.

-Sulejmani pastaj e ftoi atë në një sallon të mrekullueshëm, dyshemeja e të cilit ishte prej xhamit të shkëlqyer i cili lëkundej. Belkizja duke menduar se është ujë, duke ju afëruar dyshemesë, ajo e ngriti kadale fustanin e saj përmbi shputat e këmbës nga friga për mos ta lagur atë. Sulejmani, alejhis-selam, kur e pa i shpjegoi asaj se është i ndërtuar prej xhamit të fortë.

-Ajo ishte e hutuar. Ajo kurrë më parë nuk kishte parë këso gjërash. Belkizja e kuptoi se ishte në shoqërinë e një personi shumë të dijshëm, i cili nuk është vetëm sundues i një mbretërie të madhe, por edhe i Dërguar i Allahut për së miri. Dhe mbretëresha Belkize u pendua për adhurimin që i kishte bërë Diellit. E pranoi fenë e Allahut, dhe kërkoi nga populli i saj të veprojnë të njëjtën.

-Dhe mbaroi, Belkizja e pa se besimi i popullit të saj është copëtuar para Sulejmanit. Ajo e kuptoi se Dielli të cilin e adhuronte populli i saj, nuk ishte asgjë vetëm se një krijesë e Allahut.

-Dielli u errësua në zemrën e saj për herë të parë, dhe zemra e saj u shëndritë nga një dritë e cila nuk shuhet kurrë, nga drita e Islamit.

Allahu na tregon këtë rrëfim në Kur'an:" Dhe vështroi shpendët e tha: "Ç'është që nuk e shoh pupëzën? Jo, ajo nuk qenka këtu!" Unë do të dënoj atë me një dënim të ashpër ose do ta therrë ose ka për të më

sjellë ndonjë argument të fortë (si arsytim). Ajo nuk zgjati shumë e tha: "Unë kuptova atë që ti nuk je i njohur dhe të erdha nga Sebei me një lajm të sigurt". Në të vërtetë unë gjeta një grua që po i sundonte ata (Popullin e Sebe-it) dhe asaj i ishte dhënë çdo send, e ajo kishte një fron të madh. Madje takova atë dhe popullin e saj se adhurojnë diellin e jo All-llahun, po djalli ua kishte hijeshuar atë veprim të tyre dhe i kishte shmangur prej rrugës së drejtë, andaj ata nuk gjejnë udhëzim. (i kishte shmangur) Për të mos adhurar All-llahun që nxjerr në shesh (e di) të fshehtë në qiej e në tokë, dhe që e di atë që fshehni dhe atë që publikoni. All-llahu është një, nuk ka Zot tjetër pos Tij, Zot i Arshit të madh. Ai (Sulejmani) tha: "Do të shohim se a e thua të vërtetën apo je nga gënjeshtarët!" Shko me këtë letrën time e hidhja atyre, largohu (pak) nga ata dhe përgjo se çka bisedojnë!" Ajo (gruaja - Belkisa) tha: "O ju pari, mua më ka arritur një letër madhështore!" (e lexova) Kjo është prej Sulejmanit (mandej e hapi, kur qe, në të) "Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!" (Bismil-lahir-Rahmanir-Rrahim!). (në vazhdim shkruan) "Të mos u mbani në të madh kundër meje, po të më vini të dorëzuar (edhe besimtarë)!" Ajo tha: "O ju pari, më sugjeroni në këtë çështje timën se unë nuk do të vendosi asgjë derisa edhe ju të jepni pëlqim!" Ata (paria) i thanë: "Ne jemi të fuqishëm dhe jemi luftëtarë të rreptë, por puna qëndron te ti, e ti mendo se çka do të na urdhërosh!" Ajo tha: "Kur sundusit e pushtojnë ndonjë vend, ata e rrënojnë atë e parinë më të zgjedhur të atij vendi e nënshtrojnë. Kështu ata veprojnë!" Po unë do t'u dërgoj atyre një dhuratë (të madhe), e do të shohë se çka do të na sjellin të dërguarit (me dhuratë). E kur i erdhi ajo Sulejmanit, ai tha: "A me pasuri më ndih-

moni mua? E atë që All-llahu më ka dhënë mua është shumë më e dobishme nga ajo që u ka dhënë juve! Por ju krenoheni me dhuratat tuaja!" Kthehu te ata (i tha kryesuesit të të deleguarëve), se për Zotin ne do t'u vijmë atyre me një ushtri, së cilës ata nuk do të mund t'i bëjnë ballë dhe do t'i dëbojmë prej aty të nënshtruar e të poshtëruar! Ai (Sulejmani) tha: O ju pari, cili prej jush do të më sjellë fronin e saj, para se të vijmë ata të dorëzuar?" Njëri prej xhinëve të vrazhdë (Ifriti) tha: "Unë do ta sjellë atë ty, para se të ngritesh nga vendi yt, unë për të kam fuqi dhe jam i sigurt!" E ai i cili kishte dituri nga libri tha: "Unë ta sjell atë ty sa çel e mshel sytë (këtij i tha sille)!" E kur e pa atë (fron) të vendosur pranë tij (Sulejmani) tha: Kjo është dhuntia e Zotit tim që të më sprovtojë mua se a do ta falënderoj, apo mos do ta përbuz. E kush falënderon, ai falënderon për të mirën e vet, e kush përbuz, Zoti im (s'ka nevojë), është i pa nevojë e bujar!" Ai (Sulejmani) tha: "Ndryshonia asaj fronin që ta provojmë se a po e njeh apo është nga ata që nuk dinë ta njohin!" E kur erdhi ajo, iu tha: "A është i këtillë froni yt?" Ajo tha: "Si të ishte vetë ai?!" (Sulejmani tha:) Neve na është dhënë dituria përpara saj dhe ne ishim besimtarë para saj. Pse atë (Belkisën) e kishte penguar (nga besimi i drejtë) ajo që adhuronte, pos All-llahut, dhe ishte nga një popull jobesimtar. Asaj iu tha: "Hyn në pallat, e kur atë mendoi se është një ujë i madh dhe i përvol këmbët". Ai (Sulejmani) tha: "Ky është një pallat i lëmuar prej qelqi!" Ajo tha: "Zoti im, unë i kam bërë krim vetes e tash i dorëzohem (pranoj besimin) All-llahut, së bashku me Sulejmanin, Zotit të gjithësisë ". (Kur'an, Neml 20-44).

-Punët publike të Sulejmanit ishin kryesisht të kryera nga exhinët. Kjo ishte për arsye të gabimeve të tyre, sepse i kanë shtirë

njerëzit të besojnë se janë të fuqishëm, e dinë të padukshmën dhe mund ta rregullojnë të ardhmërinë. Si i Dërguar i Allahut, ishte detyrë e Sulejmanit, alejhis-selam, të largojë këto besime të pavërteta nga pasuesit e tij.

-Sulejmani, alejhis-selam, jetoi në mes të madhështisë, dhe të gjitha krijesat me lejen e Allahut ishin të nënshtruara ndaj tij. Mandej Allahu i Madhëruar e përcaktoj vdekjen për të. Jeta e tij dhe vdekja e tij janë përplot me mrekullira dhe çudira, kështu që vdekja e tij harmonizohet me jetën dhe madhështinë e tij. Vdekja e tij, sikurse edhe jeta ishte e veçantë. Njerëzit është dashur të mësojnë se e ardhmja nuk mund të njihet nga peygamberët e as nga exhinët, por vetëm nga Allahu, Krijuesi i Gjithsisë. Përpjekja e Sulejmanit nuk mbaroi me vdekjen e tij, por edhe vdekja e tij u bë shembull.

-Ai ishte i ulur duke e mbajtur shkopin e tij, duke mbikëqyrur exhinët duke punuar në minierë. Ai vdes duke qëndruar në këtë pozitë. Për një kohë të gjatë, askush nuk ishte i vetëdijshëm për vdekjen e tij, pasi që ai shihej duke qëndruar drejtë. Exhinët vazhduan me mosmarveshjet dhe punën e rëndë të tyre duke menduar se Sulejmani, alejhis-selam, po i shiqon.

-Shumë ditë më vonë, një krimb i uritur filloi të ha shkopin e Sulejmanit, alejhis-selam. Krimbi vazhdoi kështu për të ngrënë shkopin deri sa e thërmoi tërësisht, deri sa mbëriti te lëkura e dorës së Sulejmanit, alejhis-selam, dhe kur trupi i tij i madh ra për tokë. Njerëzit vrapuan tek ai, dhe e kuptuan se ai kishte vdekur që një kohë të gjatë, dhe se exhinët nuk e kanë vretur të padukshmen. Sepse po ta kishin ditur exhinët të padukshmen ata nuk do të kishin vazhduar punën, sepse e kishin kuptuar se Sulejmani, alejhis-selam, ka vdekur.

-Allahu tregon: " Edhe Sulejmanit ia nënshtruam erën që paraditja (e udhëtimit me të duke shkuar) ishte sa një muaj dhe pasditja e saj (në të kthyer) sa një muaj (udhëtimi). I bëmë që atij t'i rrjedhë burim i remit dhe me urdhërin e Zotit të tij, ia nënshtruam xhinët që punonin sipas dëshirës së tij, e kush largohet prej tyre nga urdhëri Jonë, atij do t'ia shijojmë zjarrin e fortë. I punonin atij çka ai dëshironte: pallate të fortifikuara, skulptura, pjata (të drunjëta) sikurse rezervuare, enë (kazana) të palëvizshme. Veproini duke falënderuar, o familje e Davudit, e nga robërit e Mi, pak janë mirënjohës. E kur

ia caktuam atij vdekjen, askush tjetër, nuk i njoftoi ata (xhinët) për vdekjen e tij, përveç krimbit që i brejti shkopin e tij, e kur u rrëzua ai, për xhinët u bë e qartë se sikur të ishin ata që e dinin të fshehtë, nuk do të vazhdonin të qëndronin në mundimin e rëndë. (Kur'an Sebe' 12-14).

-Falënderimi i qoftë Allahut i Cili e di të mshehtë dhe të dukshmen, i Cili i ngrit robërit e Tij besimtarë. Dhe u jap nga të mirat e Tij të pakufishme vetëm që të janë mirënjohës ndaj dhuntive të Tij të panumërta. Të gjitha falënderimet qofshin për Allahun Zotin e botërave.

Marrë nga: islamia.com

(Rrëfimi bazohet në librin e Ibën Kethirit-Rrëfime mbi Pejgamberët)

Përktheu: Arlind Gusinja

28.5.2004

Aborti është vrasje

Përmes kësaj dëshirojmë që të tërheqim vëmendjen në disa raste të këtij akti të ndytë! Dikush do të thotë se gruaja ka të drejtë që që të bëjë çka të dojë me vetveten. Ajo ndoshta ka të drejtë me veten por jo edhe me tjerët, sepse fëmijët tanë nuk janë pronë e jona, por ata na janë dhënë në mbrojtje, që Zoti ynë me ta të na sprovojë se cili do të veprojë në mënyrë më të mirë!

Aborti është vrasje. Edhe atë e tmerrshme! Mënyra se si disa mjekë, nëse mund të quhen të atillë, e kryejnë nxjerrjen e dhunshme të foshnjës, e kjo nuk është asgjë tjetër përveçse vepër kriminale e shkallës më të lartë! Ata me gërshtërit kirurgjik e coptojnë foshnjën copë-copë, derisa nuk e mënjanojnë ate nga mitra. Embrioni (fryti i formuar

– fëmija) si edhe çdo krijesë tjetër ka nerva dhe me vetë atë ai ndjen dhembje të tmerrshme! Paramendoni që juve dikush t'ua presë duart dhe këmbët!

Kurse Allahu i lartmadhëruar ka thënë: "A nuk ju kemi krijuar juve nga një lëng i dobët? Dhe atë e vendosëm në një vend të sigurtë. Për deri në një kohë të caktuar..!" (Kuran: Murselat, 20-22)

Kjo don të thotë se barku i nënave tona është vend i sigurtë, zonë e mbrojtur dhe e ndaluar për njeriun që ta dëmtojë këtë siguri!

Kush mund të merr guximin që ta bëjë këtë vepër të ndyer? Atë mundet vetëm ai i cili nuk i frigohet dënimit të Ditës së Madhe! Ai i cili mendon se një vepër e tillë do të ngelë e padënuar!

“..cili mbyl një njeri pa pasë mbytur ai dikë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë fesat në tokë, është sikur ti ketë mbyl të gjithë njerëzit në tokë. E kush bëhet shkak që dikush ngjallet (shpëton jetën e tij) është sikur t'i ketë ngjallur të gjithë njerëzit! (Kuran: Maide, 32)

Fëmijët janë dhunti e madhe nga Allahu

Zoti ynë i Lartmadhëruar ka paraparë që ti ngrëjmë ato nga paaftësia, ti mbrojmë, ti ushqejmë, ti veshim dhe ti mbathim derisa që të arrijnë fuqinë dhe aftësinë. Dhe kjo për shumë shkaqe: që të krijohet lidhja e dashurisë dhe rrespektit, të na falënderojnë atëherë kur ne dobësohemi dhe të na kthejnë atë dashuri dhe rrespekt që ua dhuruam.

Fëmija mund të jetë rikthim në një jetë më të mirë për një numër të madh njerëzish.

Nëse nënat e tyre kanë një jetë të rregulluar, ndoshta kujdesi për fëmijën ua kthen rregullsinë në jetë. Sa shumë nëna mu fëmijët e tyre i kanë nxjerrur ato nga dëmet e narkomanisë, prostitucionit dhe alkoolizmit.

Për dashurinë e nënës mundet të shkruhen libra me vëllime voluminoze, ndërsa shumë gra sot i ikin nënërisë nga frika se ajo do tua prish karrierën ose do tua dobëson gjendjen ekonomike. Dijeni se nënëria është ndjenjë e lindur, dhe se ajo është një nga urtësitë e të qenurit të gruas në këtë botë. Ai i cili ikën nga natyra e vet e lindur, nuk mund të jetojë jetë të lumtur. Dijeni pra se as gruaja e as burri nuk do ta gjejnë gëzimin e tyre duke bërë vepra nga të cilat do të turpëroheshin bile edhe qentë!

Përgaditi: xhamati shqiptar pranë xhamisë “EL BUHARI” - Wien, Maj, 2004
4.6.2004

Sjellja e mirë ndaj injorantit

Pasi që një person të jetë larguar nga shoqëria e atyre shokëve injorantë dhe të jetë drejtuar shoqërisë së atyre të cilët janë pak (por e mira dhe ndikimi i mirë ekziston në këtë botë), ai atëherë do marrë një zell të ri dhe një drejtim të ri, dhe do bëhet i huaj për njerëzit – madje nëse ai është një i afërm ose një shok i ngushtë i tyre.

Kjo gjë do ta bëjë atë një të huaj, i dashur ndaj njerëzve. Ai mund të shohë qartë errësirën nga e cila ata vuajnë por ata nuk mund të shohin shkëlqesinë të cilën ai e gëzon. Ai i fal ata aq sa të mundet, përveç kësaj ai vazhdon duke i urdhëruar dhe duke i këshilluar ata për të mirë me gjithë fuqinë e tij.

Kështu ai shikon tek ata me dy sy:

1. Me një sy ai njihë urdhërat dhe ndalimet e Allahut. Duke u bazuar në këtë, ai i këshillon ose i paralajmëron ata, i zë për miq apo ose largohet prej tyre duke ua dhënë të drejtat e tyre dhe duke ruajtur të tija.

2. Me syrin tjetër ai njihë përcaktimin dhe gjykimin e Allahut. Duke u bazuar në këtë ai simpatizohet me ta; ai bën dua për ta; ai i kërkon Allahut, subhanehu ve teala, që t'i falë. Ai kërkon arsytim për ta në çështjet që nuk dhunojnë urdhërat dhe shariatit e Allahut. Ai u afrohet me këndshmëri, dhëmbshuri dhe falje, duke iu përmbajtur urdhërave të Allahut (drejtuar të dërguarit të tij): "Ti (Muham-

med) merre të lehtë, urdhëro për të mirën dhe largohu prej të padijshmëve”. [Araf: 199]

Nëse një person i përmbahet këtij ajeti kjo i mjafton atij dhe e shëron atë. Ajeti thërret për:

1. Sjelljet e mira në marrëdhënjen me njerëzit: duke i falur ata dhe duke treguar ndaj atyre dhëmbshuri...

2. Përmbushja e të drejtave të Allahut te njerëzit duke urdhëruar për ate çfarë është e mirë...

3. Shmangia e të keqes së tyre, duke u ruajtur nga dëmi i injorancës së tyre pa u mjerë për t'u hakmarrur ndaj tyre

Si mundet një person të arrijë perfeksionin? Dhe çfarë politike dhe sjelljeje mund të ketë në këtë botë si kjo? Nëse një njeri përpiket ta ketë në konsideratë çdo të keqe që e arrin atë nga njerëzit...

Nëse ai respektohet nga ata të gjithë atëherë çfarëdo që do të ketë mes tij dhe njerëzve do të jetë e mirë madje edhe nëse në dukje mund të duket e keqe. Vetëm e mira mund të rezultojë nga urdhërimi për të mirë madje dhe nëse është e përfshirë në një situatë të keqe dhe të dëmshme. Allahu, subhanehu ve teala ka thënë: “S’ka dyshim se ata që trilluan shpifjen, janë një grup prej jush. Ju mos e merrni atë si ndonjë dëm për ju, përkundrazi, ajo do të jetë në dobinë tuaj. Secilit prej tyre do t’i takojë dënimi sipas pjesëmarrjes në mëkat, e atij prej tyre që e barti pjesën e madhe (të shpifjes) i takon dënimi i madh”. [En-Nur: 11]

Dhe Ai i është drejtuar të dërguarit të Tij,

sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: “Ti ishe i butë ndaj atyre, ngase All-llahu të dhuroi mëshirë, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do shkapërderdheshin prej teje, andaj ti falju atyre dhe kërko ndjesë për ta, e konsultohu me ta në të gjitha çështjet, e kur të vendosësh, atëherë mbështetu në All-llahun, se All-llahu i do ata që mbështeten”. [Ali Imran: 159]

Ky ajet e mëson të dërguarin e Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të përmbush të drejtat e Allahut dhe të drejtat e njerëzve. Kur njerëzit bëjnë gabim ata ose do të dhunojnë limitet e Allahut ose të dëmtojnë vet personalitetin e të dërguarit të Tij, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Nëse ata dëmtojnë Resulullahun, sal-l all-llahu alejhi ve sel-lem, ai duhet t’i përgjigjet kësaj duke i falur ata. Por nëse ata i tejkalojnë limitet e Allahut atëherë ai, sal-l all-llahu alejhi ve sel-lem, duhet t’i kërkojë Allahut, subhanehu ve teala që Ai t’i falë ata dhe që t’ua zbutë zemrat e tyre.

Gjithashtu ai, sal-l all-llahu alejhi ve sel-lem, duhet të nxjerrë mendimet e tyre duke i konsultuar ata sepse kjo i bën ata më të prirur për tu bërë më të bindshëm dhe të vullnetshëm për të pranuar këshillën. Menjëherë kur formohet vendimi i tij ai nuk duhet të kërkojë këshillë më por duhet të mbështetet tek Allahu dhe të vazhdojë para për të përmbushë ate çfarë ai ka vendosur, sepse Allahu do ata të cilët i besojnë Atij.

Imam Ibën Kajjim el-Xhevziye
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
Marrë nga: islamweb.net
11.6.2004

Si t'i shërbej fesë në jetën e përditshme?

Si mund t'i shërbej fesë sime në jetën time të përditshme? Çfarë kontributi mund të jap përderisa i kryej punët e përditshme? Kjo është pyetje që shumë prej nesh ia bëjmë vetvetes dhe është një pyetje me vend.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Çdo person në mëngjes e shet veten e tij. Ai ose e shpëton ate ose e dërgon në humbje.”

Prandaj ne pyesim veten: A duhet të përqëndrohem në urdhërimin e njerëzve në të mirë? Apo ti ndalojë ata nga veprat e këqija? Apo më mirë do të ishte për mua që t'i tuboj fëmijët dhe tu ndihmoj të mësojnë Kuran përmendësh? Apo më mirë do ishte sikur të isha pjesmarrës në ndonjë aktivitet bamirës?

Mënyrat me anë të të cilave ne si muslimanë mund t'i shërbejmë fesë sonë janë të shumta për tu numëruar.

Çdonjëri prej nesh duhet t'i ketë parasysh mundësitë dhe prirjet e veta, si dhe personalitetin e vet kur të vendos se çka do të bën. Sidoqoftë, janë disa kontribute dhe direktiva të përgjithshme që kanë të bëjnë me çdonjërin prej nesh, e të cilat mund të fillojmë t'i praktikojmë menjëherë.

Si për fillim, ne duhet të mundohemi të bëhemi shembull për të tjerët. Këtë duhet ta bëjmë në ibadetin tonë, në marrëdhëniet tona me të tjerët dhe në sjelljen tonë. Ne duhet të përpiqemi që çdoherë të jemi të kujdesshëm dhe të drejtë. Ne duhet t'u japim përparësi të drejtave të tjerëve edhe nëse kjo është në dëm tonin. Kjo është çështja fillestare dhe më kritike e të gjitha shërbimeve tona.

Çështja tjetër i përket marrëdhënieve tona me familjen dhe me të afërmit tanë. Ne duhet ti përforcojmë marrëdhëniet me farefi-

sin duke i respektuar ata dhe duke u bërë mirë atyre. Është obligim yni që ta thërrasim familjen tonë në islam dhe ta urdhërojmë në vepra të mira. Ky obligim fillon me prindërit dhe fëmijët tanë, pastaj me vëllezërit, motrat dhe gratë tona, e kështu me rradhë.

All-llahu, subhanehu ve teala, duke iu drejtuar Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Dhe tërhiqju vërejtjen farefisit tënd më të afërt.” [Shuara: 214]. Pas shpalljes së këtij ajeti Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e tuboi farefisin e tij dhe tha: “O kurejshitë, shpëtoni veten tuaj, sepse unë nuk mund të bëjë asgjë për ju tek All-llahu. O bijt e Abdu Menafit! Unë nuk mund të bëjë asgjë për ju tek All-llahu. Oj Safije, halla e të dërguarit të All-llahu! Unë nuk mund të bëjë asgjë për ty tek All-llahu. Oj Fatime, bija e Muhammedit! Unë nuk mund të bëjë asgjë për ty tek All-llahu. Kërkoni nga pasuria ime çka të dëshironi, por unë nuk mund të bëjë asgjë për ju tek All-llahu.”

Pastaj duhet t'u kushtojmë kujdesë kolegëve dhe shokëve tanë. Ne duhet që çdoherë të jemi të gatshëm t'u ndihmojmë atyre. Ata do të na përgjigjen më shumë kur do t'ju ofrojmë literaturë ose ndonjë kasetë, apo kur ti thërrasim në ndonjë ligjeratë (ders) fetare.

Ne gjithashtu duhet të jemi të kujdesshëm me fqinjët tanë dhe me komunitetin në të cilin jetojmë. Fqinjët tanë kanë të drejta tek ne thjeshtë nga të qenurit fqj i yni. Ne duhet t'i respektojmë këto të drejta. Ne duhet të kultivojmë dashamirësinë mes nesh dhe atyre të cilët jetojnë në lagjen tonë. Kjo do të na e lehtësojë që të ndikojmë tek ata në lidhje me çështjet fetare.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kush e beson All-llahun dhe Ditën

e fundit le të sillet mirë me fqiu.”

Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu ka thënë: “Vall-llahi nuk beson. Vall-llahi nuk beson.” Kur e pyetën kush, ai tha: “Ai, nga dëmi i të cilit nuk është i qetë fqiu i tij.”

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i kushtoi kujdes të madh definimit të të drejtave të fqiu. Ai ka thënë: “Nëse ai (fqiu) sëmuret, vizitoje ate. Nëse ka fat të mirë, urreje. Nëse e godet ndonjë fatkeqsi, ngushëlloje. Mos e ndërto ndërtesën tënde në atë mënyrë që do ta pengojë flladin të arrijë në vendbanimin e tij përveçse me lejen e tij. Mos e ngacmo atë me aromën e gjellës përdërisa nuk i jep prej ushqimit tënd. Nëse

blen pemë, atëherë jepi prej tyre, e nëse nuk vepron kështu, atëherë (pemët) sjelli në shtëpinë tënde në mënyrë diskrete (të fshehtë), dhe mos lejo që fëmijët ti marrin pemët jashtë e ti lakmojnë fëmijët e tij me to.”

Interesimi për lagjen tonë gjithashtu do të thotë pjesmarrje në xhaminë lokale. Ne natyrisht se duhet të jemi të rregullt në namazet me xhema. Ne gjithashtu duhet të kalojmë një kohë në xhami (duke bërë dhikër ose duke lexuar Kur’an sh.p.). Ne duhet të kujdesemi që të prezentojmë në aktivitetet që bëhen në xhami, përveçse kur kemi arsye.

Lusim All-llahun të na mundësoj të jemi në shërbim të Tij në çdo aspekt të jetës sonë.

Marrë nga: islamtoday.net
Përktheu: Omer Islami

n

Vlerat e dijetarëve

- I -

O ju robër të All-llahut, ju porosis ju dhe vetveten që të jemi të devotshëm.

Robër të All-llahut!

All-llahu prej robërve të vet i do dijetarët, i ka zgjedhur dhe dalluar, duke i bërë trashëgimtar të pejgamberëve. Ua ka shtuar të mirat dhe bamirësinë duke i bërë prej robërve të Tij të devotshëm dhe të lumtur. I ka ndërruar dhe fisnikëruar e i ka rradhitur në rendin e evlijave. I ka lavdëruar në Librin e Tij duke i përshkruar si njerëz që kanë frikën e tij:

"...Po All-llahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës". (Fatir: 28).

A e dini se çka janë dijetarët?!

Dijetarët janë prijës të udhëzimit, llamba të ndriçimit, ithtarë të mëshirës dhe pëlqimit, ata pasohen, imitohen dhe me to orientohet.

Sa e sa nxënës i kanë mësuar, sa e sa të devijuar i kanë udhëzuar në rrugën e drejtë, sa e sa njerëz të humbur kanë drejtuar rrugës së drejtë.

Prania e tyre në mesin e njerëzve është dhunti dhe mëshirë, kurse marrja e tyre dhe vdekja është denim dhe vuajtje:

"All-llahu nuk e mer dijen duke e ngritur nga gjoksi i dijetarëve, mirëpo e mer me marrjen e dijetarëve, saqë kur nuk mbetet asnjë dijetar, njerëzit marrin për prijës injorantët, u japin fetva pa dije; devijojnë vet dhe të tjerët i devijojnë". (Buhariu dhe Muslimi).

Dija është mëshirë nga All-llahu, e mirë dhe udhëzim prej Tij. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Ai ia dhuron urtësinë atij që do, e kujt i është dhënë urtësia, atij pra i është dhuruar mirësi e madhe, ...". (El-Bekare: 269).

Dija është largpamësi (vizion) nga Zoti.

"Thuaj: "Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është All-llahu, e unë nuk jam nga idhujtarët." (Jusuf: 108).

Dija është fakt, me të cilin i sqaron të vërtetat dhe pranë këtyre fakteve hesht secili njeri:

"Thuaj: "Unë i përmbahem (faktit) të vërtetës (që më erdhi) nga Zoti im....". (El-Enam: 57).

Dija është rruga e Zotit që e shpjen njeriun deri te xhenneti i përhershëm dhe kënaqësia e All-llahut:

"Kush ecë rrugës për të kërkuar dije, All-llahu ia pehtëson rrugën për në xhennet". (Muslimi).

Sa e shkurtë është rruga e xhennetit dhe e mëshirës për dijetarët.

Kanë bartur Kur'anin dhe Sunnetin, kanë ngjallur kullat e ndriçimit të fesë dhe milletit.

All-llahu e di se sa kanë kontribuar dhe flijuar për këtë dije të bekuar dhe këtë të mirë të madhe.

Robër të All-llahut!

Kur All-llahu e do një njeri, në zemrën e tij futë dashurinë për dijetarët, kurse ai që e do një popull ringjallet me ta.

Erdhi një njeri te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e tha:

"O i Dërguar i All-llahut, një njeri e do një popull, mirëpo nuk i arrinë ata". Domethënë në namazin, mirësinë, agjërimin. Pra i do njerëzit e mirë, mirëpo nuk është aq i mirë, i do dijetarët, mirëpo nuk ka dituri.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, tha: "Njeriu është me atë që e do". (Buhariu dhe Muslimi).

Ai që i do dijetarët, ringjallet me njerëzit e devotshëm dhe të lumtur, me:

"...ata që All-llahu i shpërbleu: (me) pejgamberët, besnikët e dalluar, dëshmorët dhe me të mirët. Sa shokë të mirë janë ata!" (En-Nisa: 69).

Kur All-llahu e do një njeri, në zemrën e tij futë dashurinë për miqtë e Tij dijetarë, andaj i do për hirë të All-llahut, lutet për ta, beson në vlerën e tyre dhe është ndihmësi më i mirë i tyre.

Dashuria ndaj dijetarëve është adhurim, afërsi, besim në All-llahun dhe urdhërim nga e mira dhe ndalim nga e keqeja.

I dojmë pse e kanë mësuar përmendsh Kur'anin, sepse e kanë kuptuar sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem,, ua kanë mësuar tjerëve dhe në to kanë thirrur. I dojmë për shkak të fesë. I dojmë për shkak të pamjes së njerëzve të mirë dhe simboleve të burrave të devotshëm. I duam për shkak telasheve të mëdha që i përjetojnë prej ummetit dhe të mirave të mëdhaja që ia ofrojnë ummetit.

All-llahu ynë zmadhohau shpërblimin dhe rëndoua peshojën në ahiret.

Dashuria ndaj dijetarëve, robër të All-llahut, është mëshirë nga All-llahu, tebareke ve teala.

Ai që i do dijetarët kujdeset për ndejat e tyre, kujdeset për këshillat e tyre, kujdeset për thirrjen e tyre dhe zbatimin e asaj që ata e thonë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e sqaron vlerën e dijetarëve kur e përmend atë njeriun me mëkate, i cili kalon pranë disa njerëzve të mirë që ishin tubuar në një hallkë të dijes. U ul me ta për ta përmendur All-llahun, edhe pse kishte mëkate dhe të meta. U ngritën melaqet te Zoti, az-ze ve xhel-le, dhe i treguan për rastin e këtyre njerëzve. Kurse All-llahu, subhanehu ve teala, tha:

"Edhe atij ia kam falur, sepse ata janë burra që kush ulet me ta nuk vuan". (Buhariu).

Ai që i do dijetarët kujdeset për tubimet dhe këshillat e tyre. Është i rregulltë në tubimet e tyre dhe i zbaton të mirat që i mëson atje. Andaj All-llahu ua ban të dashura këto mexhlise burrave të devotshëm, ua ban të dashur tubimet e atyreve që e përmendin All-llahun, andaj nuk lodhen nga prania në ato mexhlise dhe flijojnë për arritjen e tyre. Andaj, ji, All-llahu të mëshiroftë, ky njeri, sepse i privuar është ai që privohet nga ky bereqet.

Ai që i do dijetarët lutet për ta, bën dua me rahmet për të vdekurit e tyre dhe i përmend për të mirë:

"Edhe ata që kanë ardhur pas tyre e thonë: "Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë që para nesh u pajisën me besim dhe mos lejo në zemrat tona farë urrejtjeje ndaj atyre që besuan. Zoti ynë Ti je i butë, mëshirues!" (El-Hashr: 10).

I përkujton me dua të mira dhe kërkon nga All-llahu që t'i kaplojë ata mëshira e Tij.

Dijetarët e ummetit nga brezat e kaluar, nga sahabet, tabiinet, pasuesit e tyre deri në ditën e Kijametit, ata janë ithtar të mirës dhe haditheve, ithtar të sunnetit dhe shikimit, këta vetëm për të mirë duhet përmendur, kurse ai që i përmend për të keqe nuk është në rrugën e drejtë.

Përhapen vlerat e tyre dhe përmenden gjurmët e tyre pozitive.

Kanë vdekur mirëpo në zemrat e njerëzve nuk kanë vdekur të mirat, fjalët dhe këshillat e tyre.

Ai që i do dijetarët kujdeset që të ketë edukatë me ta, hesht kur ata flasin, i dëgjon kur ata bisedojnë, i respektojnë kur ata urdhërojnë ose ndalojnë, u dorëzohen tërësisht, nuk u kundërshtohen me mendime dhe nuk kërkon rrugën e ithtarëve të devijimit dhe epsheve.

Sa shumë kemi nevojë për edukatë me dijetarët, kur ata flasin, bisedojnë dhe japin fetva, duhet të dëgjojmë këto fjali të shëndëritshme dhe këshilla elekuente nga Kur'ani dhe Sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. I duam dhe nga dashuria ndaj tyre kemi frikrespekt për ta.

Të nderoj nga madhërimi, e jo nga frika

Sepse dashuria yte ma mbushi syrin

Dashuria e atij që i do dijetarët del në shesh kur flet dijetari, ai heshtë, ka një frikë-respekt, ndikohet dhe i lotojnë sytë, këto fjalë dhe këshilla të tyre i lëshon në zemrën e tij sikur shiun në tokën e pjellshme.

Sa shumë kemi nevojë të kemi edukatë me dijetarët në çdo fjalë që e thonë dhe në çdo urtësi që e tregojnë përderisa është nga Kur'ani ose nga sunneti i Pejgamberit, alejhisselam.

Sa shumë kemi nevojë ti nderojmë nëpër tubime, tua ngrisim pozitën, ti nderojmë dhe madhërojmë.

Ibn Abbasi, radijall-llahu anhu, hynte te emirul-muminine, Omeri, radijall-llahu anhu, e kur hynte te ai, ky vinte në pozitë të lartë dhe në kokë të mexhlisit, mbi pleqtë bedrian dhe të moshuar. Kur ata u ankuan për këtë gjest, ai ua tregoi vlerën dhe dijen e tij. (Buhariu).

Dijetarët duhet të nderohen, madhërohen dhe vlerësohen, ai që i nderon është i ndershëm, kurse ai që i nënçmon është i poshtër dhe dheltnak.

Sa shumë kemi nevojë për vlerësimin e dijetarëve duke i përhapur fetvatë dhe dijen e tyre, duke i botuar librat e tyre dhe duke i shpërndarë anëmbanë botës, ndoshta do të kemi shpërblim sikur shpërblimi i tyre.

Sa shumë kemi nevojë të përhapim të mirën që e thonë ata që të kemi edhe ne sikur shpërblimin e tyre.

Robër të All-llahut!

Sa shumë kemi nevojë që të jemi të sjellshëm me dijetarët kur nuk janë të prani-shëm, duke i përmendur me fjalë të larta dhe të madhërishtme, përderisa nuk arrinë në gradën e ndalesës dhe ekstremizmit, i përmendim duke i nderuar, vlerësuar dhe madhëruar, sepse kjo është nga sunneti i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Nderimi i tyre gjatë dedikimit është nga sunneti i të mirëve dhe të devotshmive, kurse nënçmimi gjatë dedikimit është vepër e njerëzve të poshtër. Andaj dijetarët kanë thënë:

"Kush e thërret dijetarin në emër është sjellur keq".

Është sjellur keq, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"...Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" (Ez-Zumer: 9).

Injoranti e thirrë dijetarin ashtu sikur thirrren masa e gjërë:

"Thirrjen e të dërguarit mos e bëni si thirrjen tuaj ndaj njëri-tjetrit...". (En-Nur: 63).

Nuk duhet ta thërrasim dijetarin në emër, por duhet të thirret sipas cilësisë dhe pozitës, thirret ashtu siç e meriton nderimin, madhërimin dhe respektin.

All-llahu ynë zmadhohua shpërblimin. All-llahu ynë na dhuro dashurinë dhe respektin e tyre. All-llahu ynë na shoqëro me të devotshmit, në një gjendje nga e cila nuk na vjen keq, nga e cila nuk kemi nevojë të pendohemi, pa u sprovuar dhe duke mos ndryshuar asgjë.

E them këtë fjalim timin dhe kërkoj falje nga All-llahu i Madh për ju dhe për mua dhe për mbarë msulimanët, andaj edhe ju kërkon falje prej Tij sepse Ai është Falës dhe i Mëshirshëm.

- II -

E falënderojmë All-llahun, Zotin e botërave. Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër përpos All-llahu, i cili është Një dhe pa rival, Hyjniu i të parëve dhe të fundit dhe dëshmoj se zotëriu dhe Pejgamberi ynë, Muhammedi, është rob dhe i dërguar i zgjedhuri dhe besniku. Paqa dhe bekimi qofshin mbi te, familjen e tij të pastër dhe të mirë dhe mbi të gjithë sahabet dhe mbi ata që janë udhëzuar sipas udhëzimit të tyre deri në ditën e Kijametit.

Robër të All-llahut!

Keni frikë All-llahun me një frikë të vërtetë. Kapuni për Islamin me litarin e fuqishëm, kujtone sa më shumë vdekjen dhe afrimin e kohës së daljes para Zotit.

Besimtar musliman!

Nëse All-llahu i jep dhunti njeriut dhe i dhuron pasardhës, djem dhe vajza, le të jetë nga falënderimi ndaj All-llahut që ti mëson dije të dobishme.

Prej dhuntive më të mëdha për një njeri është që All-llahu të vëndon mirësinë, përqëndrimin dhe shpëtimin te pasardhësit e tij. Kjo vjen vetëm me suksesin e All-llahut. Burrat e devotshëm i kanë ngritur shuplakat drejt më të Mëshirshmit prej mëshiruesve që t'u dhuron mirësinë e vajzave dhe djemve:

"...Zoti ynë, na bën që të jemi të gëzuar me (punën) e grave tona dhe pasardhësve tanë, e neve na bën shembull për të devotshmit". (El-Furkan: 74).

Njeriu duhet ta ketë parasysht që së paku një djal ta dërgojë që të mësojë dijen.

Kujdesuni që t'i thërrisni fëmijët e juaj që të nxënë dije fetare, të marrin pjesë në hallkat e dhikrit, të dojnë dijetarët, të nderojnë dhe madhërojnë. Mbjellne këtë në zemrat e tyre nëse dëshironi të keni sikur shpërblimi i tyre. Kujdesuni që të mbjellni këto vlera morale në shpirtin e tyre.

Kujdesuni që të mbjellni dashurinë e dijes në zemrat e djemve dhe vajzave.

Nëse All-llahu ta dhuron një djalë të devotshëm, i cili të zëvendëson me dije, pa dyshim se kjo është një e mirë shumë e madhe.

Sa e sa prindër kanë mësuar fëmiun e tij, kurse dija e fëmiut të vet ishte në peshojën e veprave të mira. Mund të privohet baba nga dija, mirëpo nuk privohet nga sukcesi i All-llahut, nëse e merr djalin e tij përdore në kopshtet e dijes dhe respektit. Nuk do të privohesh nga sukcesi nëse mbjell në zemrën e fëmiut tënd dashurinë ndaj dijetarëve, pjesmarrjen në hallkat e dijes dhe pëfitimin nga të mirat e dynjasë dhe ahiretit. Nëse All-llahu e di se zemra yte ia do dijen djalit tënd, ndoshta ta kënaq syrin gjatë jetës tënde para vdekjes, dhe e sheh si një dijetar të muslimanëve. Kjo nuk është rëndë për All-llahun, andaj mos thuaj: kush jam unë, kush është biri im, por thuaj:

"...Kjo është dhuratë e All-llahut që i jep atij që do. All-llahu është dhurues i madh, i dijshtëm". (El-Maide: 54).

Ai që do ta ketë djalin dijetar, All-llahu i jep sukses në shkaqet dhe ia lehtëson, nëse sheh se është i sinqertë në këtë drejtim.

All-llahu ynë të lutemi të na përmirësosh djemt dhe vajzat tona, të na dhurosh të mirën e tyre dhe lutjet e tyre të mira pas vdekjes.

Dërgoni salavate dhe selame mbi mëshirën e dhuruar dhe dhuntinë e ofruar, sepse All-llahu këtë na e ka urdhëruar....

Marrë nga: www.alminbar.net

Koha e provimeve

Këto ditë të gjithë ne jemi dëshmitar të lëvizjeve të jashtëzakonshme në meset tona familjare. Të gjithë kanë shtuar kapacitetin e mësimave dhe shfletimeve. Kurse familjet u ofrojnë kushte më të mira për mësim, ose së paku kështu duhet të jetë.

Pra, thënë shkurt familjet tona kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

Andaj me këtë rast duhet patur parasysh disa elemente:

Një: Nozulli më i mirë për arritjen e suksesit dhe epërsisë, e jo vetëm në provimet e shkollave, por në të gjitha kërkesat e kësaj bote dhe ahiretit, për tu ballafaquar me të gjitha krizat dhe në situatat më të vështira, është tevekuli, mbështetja All-llahut, subhanehu ve teala, shtimi i përmendjes së All-llahut, lidhja ngushtë për Te, kërkimi i ndihmës, përkrahjes dhe suksesit prej Tij, mbështetja në All-llahun, subhanehu ve teala, i cili është Zoti i botërave, në Dijën e të Cilit është çdo gjë dhe i Cili është i Mundshëm për çdo gjë, pasi që urdhëri i Tij është mes kafit dhe nunit (kun).

Mbështetja në All-llahun është nozulli më i mirë, pasi që është rruga e besimtarëve:

"...andaj besimtarët le t'i mbështeten vetëm All-llahut". (Ali Imran: 122).

O ju nxënës!

Mbështetnu All-llahut dhe keni bindje në Te, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, ka thënë:

"...e kush u përmbahet dispozitave të All-llahut, atij Ai i hap rrugë, dhe e furnizon atë prej nga nuk e kujton fare, kush i mbështetet All-llahut, Ai i mjafton atij...". (Et-Talak: 2-3).

Mbështetja në All-llahun, tebareke ve teala, është zakoni i besimtarëve në të gjitha rastet e tyre, e jo vetëm në raste të vështirësisë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Ibn Abbasit, radijall-llahu anhu:

"Njihë All-llahun në bollëk që të njihë gjatë vështirësive...". (sahih, Ahmedi dhe të tjerët).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte njeriu që më së shumti i mbështetej All-llahut, kur i zbritnin atij ajetet e Zotit dhe ai ballafaqohej me kundërshtarët dhe tallësit e tij. Në këtë gjendje të vështirë All-llahu e urdhëronte që Atij ti mbështetej:

"Mos i dëgjo jobesimtarët e hipokritët dhe mos u vë veshin mundimeve të tyre ndaj teje, e mbështetju All-llahut se All-llahu është mbrojtje e mjaftueshme". (El-Ahzab: 48).

"Po ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij! Zot i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka zot tjetër vetëm Ai, pra Atë merr për mbështetje". (El-Muzemil: 8-9).

Kurse Pejgamberi, alejhisselam, duke e këshilluar Ibn Abbasin, radijall-llahu anhu, i thotë:

"Kur të lypish lyp nga All-llahu, edhe kur të kërkosh ndihmë kërkije nga All-llahu...". (sahih, Tirmidhiu).

O ju besimtar!

Ju që jeni bërë gati për provimet e fundit të vitit mbështetuni në All-llahun, sepse asgjë nuk të ban dobi nëse All-llahu nuk të ndihmon, nuk të ban dobi as kujtesa, as inteligjenca e as përkushtimi e as përgaditja.

Po, ato janë shkaqe të dobishme dhe të mëdhaja, mirëpo me lejen e All-llahut, i cili i shkakton shkaqet.

Dy: prindërit dhe mësuesit duhet t'u ndihmojnë fëmijëve të tyre për të arritur sukses, të krijojnë ambijent të përshtatshëm për ta, të jenë të butë me ta dhe t'ua vlerësojnë mundin dhe të kenë parasysh dallimet individuale dhe mundësitë e tyre të ndryshme.

Duhet t'u ndihmojnë atyre, ti stimulojnë e jo t'u kërcënohen dhe ti trishtojnë.

Mësuesit duhet t'u ndihmojnë nxënësve, të jenë të butë me ta, t'ua sqarojnë pyetjet, ta eliminojnë trishtimin prej tyre, pra, të sillen me nxënësit sikur me fëmijët e tyre.

Mësuesit duhet të jenë të sinqertë në këtë detyrë, ta bëjnë për hirë të All-llahut, pasi që janë duke e kryer një detyrë shumë të madhe, e ajo është edukimi dhe arsimimi i brezave të ardhshëm, andaj duhet patur para sysh se All-llahu e mbikqyrë punën tonë. Tre: nxënës të nderuar, ju duhet të përpigëni në përsëritjen e mësimeve, të jeni të sinqertë gjatë studimeve dhe mësimit.

Nxënës të nderuar!

Keni nijet të pastër për All-llahun dhe kërkone me këtë vepër kënaqësinë e All-llahut, në këtë mënyrë dija bëhet adhurim, madje adhurimi më i madh. Pasi që çdo vepër e lejuar në islam, me nijet të mirë dhe sinqeritet bëhet adhurim.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Edhe marëdhëniet intime konsiderohen sadaka". I thanë: o i Dërguar i All-llahut edhe kur ndonjëri prej nesh e kënaq epshin do të ketë shpërblim. Tha: nëse e shfrynte

epshin në haram a do të kishte mëkat, ashtu po ta shfrynte në hallall do të kishte shpërblim". (Muslimi).

Pra, sinqeriteti në kërkimin e dijes e shndërron ate në adhurim dhe afërsi me Zotin.

Kurse sa i përket dijes fetare, aty domosdo duhet të jetë i pranishëm sinqeriteti, përndryshe nuk ka aspak vlerë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Ai që mëson dije, me të cilën kërkohet Fytyra e All-llahut, dhe e mëson vetëm për të fituar diç prej të mirave të kësaj bote, ai nuk do ta nuhat aromën e xhennetit ditën e Kijametit". (sahih, Ebu Davudi).

Nxënës të nderuar!

Edhe nëse kemi sinqeritet, i mbështetemi All-llahut, bajmë shumë dua, shpresojmë shpërblimin nga nxënia e dijes, duhet ti realizojmë shkaqet e suksesit, duke u përpjekur me seriozitet për të mësuar, përsëritur dhe organizuar kohën. Duhet që mos të harxhojmë kohë kot në natën e provimeve, mosfaljen e namazit, mosrespektimin e prindërve dhe mashtrimin gjatë provimeve.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Ai që na mashtron nuk është prej nesh...". (Muslimi).

Pra, mashtrimi dhe vjedhja gjatë provimeve është prej mëkateve, andaj edhe i ka thënë këto kërcënime të mëdhaja në këtë drejtim.

Mashtrimi dhe vjedhja nuk është rrugëdalje prej problemit dhe situatës, ajo vetëm se të futë në kënetë pa e hetuar fare, nga e cila nuk ka dalje dhe mbijetesë.

Vetëm puna dhe përpjekja janë shkaku i vetëm i cili të ofron sukses, e asgjë tjetër.

Nxënës të nderuar!

Suksesi dhe epërsia është dhunti e All-llahu, andaj për këtë duhet ta falënderojmë, sepse me falënderim na shtohen të mirat:

"Dhe (përkujtoni) kur Zoti juaj njoftoi bindshëm: "Nëse falënderoni, do t'ua shtoj të mirat, ...". (Ibrahim: 7).

Andaj, mos mendoni se kjo është nga intelgjencia e juaj, nga aktiviteti juaj, nga përpjekja juaj, por është vetëm dhunti e All-lahut, për këtë edhe nuk duhet të jemi mburraveca dhe të krenohemi me këto gjëra, por duhet ta falënderojmë Dhuntidhënësin dhe Bamirësin, subhanehu ve tealà.

Kurse nëse dështon në provim, nuk duhet të mërzitesh dhe të dëshpërohesh, sepse kjo është gjë e caktuar nga Zoti, andaj duhet durim dhe dorëzim të mirë Zotit, xhel-le shanuhu:

"Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (libër - Levhi Mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për All-llahun është lehtë. Ashtu që të mos dëshpëroheshi tepër për atë që ju ka kaluar, e as të mos gëzohi tepër me atë që Ai u ka dhënë, pse All-llahu nuk e do asnjë arrogant që u lavdërohet të tjerëve". (El-Hadid: 22- 23).

Pa dyshim se në kohën kur jemi duke i kaluar provimet duhet të na kujtohet provimi më i madh, provimi ku nuk ka më afat të dytë, por fitojmë ose përhershmerinë e xhennetit ose përhershmerinë e xhehenemit:

"Në këto (rrëfime) me të vërtetë ka një përvojë për atë që i frikësohet dënimit të botës tjetër. Ajo është ditë e tubimit të njerëzve dhe ajo është ditë dëshmuese. Dhe atë (ditë) nuk e shtyejmë vetëm deri në një afat që është i caktuar. E kur të vijë ajo ditë, askush nuk do të flasë, pos me lejen e Tij, e prej tyre (të tubuarve), ka fatzi dhe fatbardhë. E për sa u përket atyre fatkëqinjëve, ata janë në zjarr, aty ata kanë dihatje, kërrhamzë të vështirë (në frymëmarrje). Aty janë përgjithmonë, sa të jenë qiejt dhe toka, përveç atë çka do Zoti yt, vërtet Zoti yt punon çka dëshiron". (Hud: 103- 107).

Me të vërtetë është një ditë e madhe ku sprovohen zemrat dhe llogariten sekretet:

"Ditën kur do të gjurmohen të fshehtat. E ai (njeriu) nuk ka as forcë as ndihmëtarë". (Et-Tarik: 9- 10).

Atë ditë do të peshohen veprat dhe do të llogariten edhe në qoftëse janë sa grimca e atomit:

"Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa pesha e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës". (El-Enbija: 47).

"E kush punoi ndonjë të mirë, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë. Dhe kush punoi ndonjë të keqe, që peshon sa grimca, atë do ta gjejë". (El-zilzal: 7- 8).

Urime atij që do të korrë sukses në këtë ditë, ai do të fitojë lumturi të përhershme, kopshte dhe lumenj, pozitën e vërtetësisë tek Zoti i tij i Gjithfuqishëm.

Sa të pafat janë ata që do të dështojnë në këtë provim, ata do të shkatërrohen dhe do të hidhen në zjarrin e kallur, ku:

"Atyre as nuk u lehtësohet (vuajtja) dhe aty janë të dëshpëruar". (Ez-Zuhruf: 75).

"...sa herë që të pushojë flaka Ne ua shtojmë flakën e zjarrit". (El-Isra: 97).

"...Ata as nuk gjykohen që të vdesin (të rehatohen), e as nuk u lehtësohet ndëshkimi". (Fatir: 36).

Andaj, ju që bëheni gati për provimin e kësaj bote, duhet të përgaditeni edhe për atë provim gjigant, sepse atë ditë:

"Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të shëndoshë". (Esh-Shuara: 88- 89).

"Edhe pse ata shihen ndërmjet vete (edhe njihen, por ikin prej njëri-tjetrit). Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet. Dhe me gruan e vet dhe me vëllain e vet. Edhe me të afërmit e tij

që ai te ata mbështetej. Edhe me krejt çka ka në tokë, e vetëm të kishte shpëtuar! Jo, kurrsesi, ajo (para) është Ledhdha - flaka (emër i xhehennemit). Është që heq kapakët e kokës. Që e thërret (tërheq prej vetes) atë që është zbrapsur e larguar (prej besimit). Dhe që ka tubuar (pasuri) dhe e ka ruajtur (fshehur)". (El-Mearixh: 11- 18).

E lusim All-llahun për ndihmesë dhe sukses në provimin e madh:

"Pasha Zotin tënd, ata të gjithë do t'i marrim në përgjegjësi. Për atë se ç'vepruan". (El-Hixhr: 92- 93).

Kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë:

"Nuk do të lëvizin këmbët e njeriut ditën e Kijametit derisa nuk pyetet për:

- jetën ku e ka kaluar;
- ç'farë ka bërë me dijen e tij;
- ku e ka fituar pasurinën dhe ku e ka harxhuar;
- trupin ku e ka shfrytëzuar". (sahih, Tirmidhiu).

E lus All-llahun për të gjithë ne që të na jep sukses dhe përgaditje të mirë për ditën e kthimit.

Paqa dhe bekimi qofshin për Muhammedin, Pejgamberin e zgjedhur, pasiqë All-llahu na ka urdhëruar me këtë vepër.

Dr. Halid Abdullah Kasim

Prof. në fakultetin e pedagogjisë.

Përshtati: B. H.

28.5.2004

Ruajtja e sherijatit

-I-

O ju musliman keni frikë All-llahun dhe vlerësonë me një vlerësim të vërtetë, besoni All-llahut dhe Pejgamberit të Tij, do tu jep dy hise të rahmetit, do tu jep dritë me të cilën do të ecni, do t'ua fal mëkatet, kurse ai që ia kthen shpinën kësaj, ai pason epshin e tij: "...e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakt prej All-llahut, ndjek epshin e vet? S'ka dyshim se All-llahu nuk udhëzon popullin zullumqar". (El-Kasas: 50).

O ju njerëz!

Muslimanët sipas vendimeve të sherijatit të tyre dhe teksteve të qarta dhe të prera, obligohen te All-llahu që të kapen për te, ta shtërnojnë me dhëmballë, ta mbrojnë pozi-

tën e tij që mos të dëmtohet ose thehet, ose të depërtojë dora e çoroditësve, të cilët do ti përmbysnin tekstete dhe premisat e tij, do të luanin me rregullat e tij si do të donin, normalisht se në mungesë të përjetimit të prestigjit të Kur'anit në shpirtërat e njerëzve dhe mungesës së madhe të asaj që All-llahu e realizon me sulltan, me forcë dhe edukim. Pasiqë ai që sigurohet nga denimi sillet keq, kurse atij që i mungon drita dhe udhëzimi, rrotullohet vërdallë në errësi. Në këtë kohë nuk ka kush e mbron njeriun përpos All-llahut dhe përpos kapjes për porosinë e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ku thotë:

"Kapuni për sunnetin tim dhe sunnetin e halifeve të drejtë e udhëzues që vijnë pas

meje, kapuni për te me dhëmballë dhe keni dro shpikjet, sepse çdo shpikje është bidat". (Sahih, Ahmedi dhe të tjerët).

Robër të All-llahut!

Muslimanët janë të kapur fortë për fenë e tyre dhe janë të fuqishëm në besimin e tyre, me to krenohen para popujve tjerë. Në besimin e tyre dhe tekstet e shpalljes kanë lidhjen më të fuqishme për tu lidhur me njëri tjetrin dhe për ta mbrojtur njëri tjetrin në ëmbrellën panislamizmit të vërtetë.

Prej gjërave që janë thelluar në shpirtin e muslimanit është fakti se në besimin në All-llahun dhe në atë që ka ardhur nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke iu nënshtruar dhe dorëzuar, ka garancë për lumturinë në dy botërat dhe se ai që privohet nga të kapurit për to dhe nënshtrimi para tyre, do të privohet nga sukcesi dhe lumturia. Të vërtetën e ka thënë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur thotë:

"Do të shijon shijen e besimit ai që është dakord ta ketë Zot All-llahun, fe Islamit dhe Pejgamber Muhammedin". (Muslimi).

Nuk ka shije pa besim, nuk ka besim pa dakordim me sherijatin e All-llahut dhe të Pejgamberit, dhe pa zbatimin e tyre në të gjitha çështjet e jetës pa përjashtime.

Të gjithë muslimanët janë të detyruar që të japin tërë mundin e tyre për të ruajtur sherijatin e tyre që mos të rrëshqasin për përqendrimin në te, të përjetojnë të këqijat nga shkaku i ikjes prej tij. Ata gjithashtu nëse nuk e mbrojnë sherijatin do të marrin pjesë në mëkat që të gjithë, nëse nuk e kryejnë këtë obligim kolektiv aq njerëz sa duhet për ta thelluar pozitën e gjykimit me sherijat dhe për ta mbrojtur nga duart e njerëzve të prishur, që tentojnë herë pas herë ta prekin atë.

O ju musliman!

Me të vërtetë problemet e mëdha dhe vështirësit e ndryshme që i kanë kapluar

muslimanët, e kanë prishur ndërldhjen e tyre, kanë arritur të krijojnë te ata një pjesë e trishtimit dhe ankthit, që në zemrat e disa muslimanëve të krijon ndjenjë për dështim dhe mëdyshje në bindjet e tyre për disa aspekte të sherijatit, turpërim nga të kapurit për fenë dhe nga krenaria me sherijatin e gjallë. Madje kjo gjë i kaloi këto përmasa sa që lindi një grup njerëzish që dëshirojnë që shkaqet e dështimit dhe dobësisë tek muslimanët t'ia referojnë zbatimit të sherijatit në shekullin e globalizimit dhe përleshjes së civilizimeve, andaj filluan të trillojnë akuza për besimin e ummetit, për origjinalitetin dhe mbarkomtarizmin e misionit të tij. Ata shohin se në zbatimin e sherijatit, ashtu si e kanë zbatuar muslimanët edhe në të kaluarën edhe në të sotmen, qëndron pengesa e përqafimit të civilizimeve dhe një lloj prapambeturie dhe dekadencë që nuk i kënaq mosbesimtarët dhe shtete të tyre, të cilët nuk do të dakordohen me ummetin tonë përdërisa nëse nuk bëhemi si ata. Andaj, robër të All-llahut, mos u habitni për fillimin e zbërthimit të ruzave të sherijatit dhe futjes së dyshimeve në premisat dhe bazat e fesë, gjeneralizimi i kaosit në referencat fetare, zhurma dhe ngacmimi i ndryshimeve dhe zëvendësimit të bindjeve, sa që ajo që ishte haram deri dje, sot ka mundësi të bëhet hallall, kurse ajo që deri dje ishte krenari sot është dobësi dhe dështim.

Janë përzier burimet e raporteve në rradhët e biseduesve, sa që gazetari është fekih dhe referencë fetare, i cili i vëndon kriteret për atë që ia ka qëlluar dhe atë i cili ka gabuar, kurse politikani është shndërruar në ligjvënës, e njeriu i thjeshtë kritikues, mungon referenca e ligjshme, pasi që e skajësuan në mesin e njerëzve. Tërë kjo është duke ndodhur për shkak të largimit të dijetarëve dhe mungesës së fuqisë së sulltanit, ngritjes së të ultëve, injorantëve dhe zhurmashive,

që të na shfaq realiteti i hidhur një fotografi të pastër të përshkrimit të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, të asja që do të ndodh në kohën e fundit:

"All-llahu nuk e ngrit dijen duke e marrë prej njerëzve, por me vdekjen e dijetarëve, ashtu edhe ngritet dija prej tyre. E në mesin e njerëzve mbeten kryetar injorantë, u japin fetva pa dije, ata vet devijojnë por edhe tjerët i devijojnë". (Buhariu dhe Muslimi).

Dhe në përputhje me hadithin tjetër të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

"Njerëzve do tu vijë disa vite mashtruese, i besohet gënjeshtarit dhe përgënjeshtrohet i vërteti, i besohet tradhtarit dhe nuk i besohet besnikut, e do të flet ruvajbida". I thanë: çka është ruvajbida? Tha: "Mendjelehtë që flet për çështjet e masës së gjërë". (hasen, Ahmedi dhe të tjerët).

Robër të All-llahut!

Ne, në këtë kohë të fundit, jemi dëshmitar të ndikimit të shumë njerëzve me shumë oferta dhe debate që i prekin bazat e fesë dhe premisat e saja, nëpërmjet projekteve të përsëritura në mjetet e ndryshme të komunikimit masiv, qofshin ato kanalet satelitore, gazetatat, radiot, forumet, tribunat, e të ndryshme.

Ajo që më së shumti na habit, të nderuar musliman, është ajo që mendojnë propozuesit e këtyre projekteve se ata i kanë sjellur ummetit gjëra që nuk ua kanë sjellur as të parët dhe se me këtë ia kanë kaluar edhe selefit të ndershëm, të mashtruar nga lëvizja mediale që i stimulon këto polemika dhe debate, llojlojshmëria e shtrembërimit të kuptimeve të teksteve të sherijatit, konfrontimi i tyre mes vehte, dhënia përparësi logjikës, bashkjetesës botërore, interesit ndërkombëtar dhe nacional para tekstit fetar. Ata që i ofrojnë këto projekte kanë dështuar nga aspekti i vetpëlqimit me metodologjinë e tyre, saqë menduan se metodologjia e tyre është

më e mirë se metodologjia e selefit, sepse sipas supozimeve të tyre metodologjia e selefit është vetëm besim në fjalët e Kur'anit dhe hadithit, pa i kuptuar ato dhe ka kuptuar synimin e All-llahut dhe Pejgamberit, i konsideruan ata sikur të jenë në pozitë të analfabetëve, për të cilët All-llahu ka thënë:

"E ka disa prej tyre që janë analfabetë, nuk e kuptojnë librin, por jetojnë vetëm në shpresa, duke mos qenë të sigurt". (El-Bekare: 78).

Metodologjia e këtyre zhurmave është shtrembërimi i kuptimeve të teksteve dhe nxjerja e tyre nga e vërteta e tyre, të cilat i ka kuptuar selefus-salihu, me llojloj metaforash dhe gjëra të çuditshme gjuhësore. Ky supozim i prishur ua detyroi atyreve që kapen për te, ta refuzojnë Kur'anin dhe Sunnetin, fjalët e sahabeve dhe tabiinëve. Kurse rezultat i kësaj ishte përhapja e dyshimeve, lëvizja e akides dhe largimi i tij nga besimi i prerë dhe bindja e paluhatshme. Kjo shkaktoi pikënisjen e thirrjeve dhe parrullave që kishin jehonë në shumë vende islame, ajo që quhet globalizim kulturor dhe informativ, që domethënë skajësim i hegjemonisë së sherijatit islam, mosbesimit në te që të fekondohen njohuritë dhe kulturat pa kufizime dhe rregulla, duke e bartur gjatë këtij procesi parrullën e ripërtërisjes, reformës, zhvillimit të sherijatit, përmirësimit të dedikmit fetar, përhapjen e tërë kësaj duke ikur nga ajo që e quajnë "ngurtësi tekstuale". Në realitet belaja nuk qëndron në ato parrulla të ngritura por edhe në vizionet dhe përmbajtjet. Më herët kanë thënë: "Nën shkumën e dhallës është e qarta".

Nuk do të kishte ardhur gjendja deri në këtë shkallë po mos të ishte dobësuar hegjemonia e vërtetuar shkencore dhe referenca e kulluar fetare, kurse gjuha e gjendjes së referencës është e skajësuar në mesin e këtyre parrullave dhe e dështuar e përsërit thënien:

"Djemt e axhes më thonin: mirësevjen, e kur më panë të falimentuar, vdiq mirëseardhja". ("Reudatul-Ukala", fq. 226).

E mëshiroftë All-llahu Ibn Kajimin, rahimehull-llah, i cili e përshkruan këtë gjendje duke thënë:

"po të shihje se si deformuesit e deformojnë fjalën më të mirë, më të qartë, më të çiltër dhe më të vërtetë, përplot udhëzim, sqarim dhe dije, me domethënie të kota dhe komente të prishura do të çuditëshe dhe do të fshihje në brendësitë e tokës. Herë do të çuditëshe, herë do të hidhërohëshe, herë do të qaje e herë do të qeshje, e herë do të dhimbte ajo që i ka ndodhur Islamit dhe shpalljes". ("Es-Sevaikul-Mursele", 1/300-301).

O ju musliman!

Kryetarët, dijetarët dhe thirrësit e kanë obligim që të jenë ruajtës të sherijetit, ta mbrojnë nga çdo sulm dhe të dalin përballë përbuzësve të sherijetit, dispozitave dhe rregullave statike të tija, sqarimin e të vërtetës, thirrja e tyre në te me urtësi, këshillë të mirë dhe polemizimi me ta në formën më të mirë. Gjithashtu nuk duhet të neglizhojmë këta njerëz dhe veprimet e tyre ose të thuhet: kritikata kundër tyre mund të thonë rënie në nivelin e tyre dhe dhënie pozitive që nuk e meritojnë. Sepse mbrojtja e sherijetit është më e gjërë se sa të përcaktohet me një person. Pasiqë haku është gjëja e humbur të cilën e kërkon besimtari.

Imam Uthman Daremiu ka fjalë rreth kësaj ku thotë:

"Dijetarët e më hershëm të selefit urrenin të futeshin në këso bisedash dhe të ngjashmet me to, sepse ishin të rehatshëm prej tyre, mirëpo ne u sprovuam me këso njerëz në kohë kur Islami është dobësuar dhe kanë shkuar dijetarët, andaj e kemi të domosdoshëm reagimin ndaj të kotës që kanë sjellur me të vërtetë". ("Er-Redu Alel-Xhehmijeti").

Ebu Hasen El-Eshariu, rahimehull-llah, ka një fjalë të mirë në fillimin e reagimit kundër Xhubaiut, mutezilit, ku mes tjerash thotë:

"Pashë se Xhubaiu kishte përpiluar një libër mbi komentin e Kur'anit, ku kishte komentuar në kundërshtim me atë që e ka shpallur All-llahu, azze ve xhel-le, dhe në këtë libër nuk kishte transmetuar asnjë shkronjë nga ndonjë mufesir, po mos të kishte mashtruar me këtë libër të tij shumë njerëz të thjeshtë dhe ti largonte nga e vërteta shumë të tillë, nuk do të kishte arsye angazhimi me te".

Kurse Ibn Kajimi, rahimehull-llah, flet për shkakun e daljes përballë deformuesve dhe devijuesve të teksteve të sherijetit dhe ulësve të dinjitetit të tij, duke thënë:

"Zbulimi i të metave të këtyre njerëzve, sqarimi i turpit të tyre, rregullave të prishura të tyre është nga xhiahadi më i mirë në rrugë të All-llahut, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka thënë Hasan ibn Thabitit:

"Shpirti i Shenjtë të përkrah përderisa ti je duke e mbrojtur All-llahun dhe Pejgamberin e Tij". Hadithin e transmeton Muslimi. ("Es-Sevaikul-Mursele", 1/301).

Musliman të nderuar!

Keni frikë All-llahun dhe ruane sherijatin dhe menhexhin e Tij në realitetin e jetës tuaj, mbrone ate, sepse nuk ka shpëtim për anijen e islamit përveç se duke u kapur për te, me nënshtrim, dorëzim, madhërim dhe respekt:

"...pra të mos ju mashtrojë jeta e kësaj bote dhe të mos ju mashtrojë ndaj All-llahut djalli mashtrues". (Lukman: 33).

"E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kurrësi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshëpruarit". (Ali Imran: 85).

All-llahu na bekoftë me Kur'anin Fisnik, na bëftë dobi me ajetet dhe përkujtimet që gjinden në te. E thash këtë që dëgjuat, nëse

është e saktë ajo është prej All-llahut, e nëse është gabim, ajo është prej meje dhe shejtanit, andaj kërkoj falje nga All-llahu se All-llahu është Falës.

-II-

E falënderojmë All-llahun që është Një, paqë dhe bekimi qofshin mbi ate që pas tij Pejgamber tjetër nuk ka...

Keni frikë All-llahun, o ju musliman, dhe dijeni se vetëm Islami është fe e pranuar te All-llahu dhe se All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Kush i kundërvihet të dërguarit, pasiqë i është bërë e qartë e vërteta dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë në atë që e ka zgjedhur (në Dunja) e e fusim në xhehennem. Përfundim i keq është ai". (En-Nisa: 115).

All-llahu, subhanehu ve teala, na ka urdhëruar që respektin tonë ndaj All-llahut dhe Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ta kemi të sigurtë dhe ndaj trashëgimtarëve të Pejgamberëve, e ata janë dijetarët hyjnor:

"O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektioni të dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë". (En-Nisa: 59).

Nga vërtetësia e besimit është madhërimi i sherijetit dhe respektimi i tij, sepse është nga All-llahu dhe Pejgamberi i Tij, andaj nuk lejohet të përbuzet e as të sulmohen rregullat dhe premiset e fesë, nuk lejohet as të futemi në to pa dije, sepse All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të dërguarit të Tij, kini kujdes All-llahun, se me

të vërtetë All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha". (El-Huxhurat: 1).

Domethënë: mos thoni gjëra që janë në kundërshtim me fjalën e All-llahut dhe të Pejgamberit, mos i anashkaloni ata me diç dhe mos gjykoni për ndonjë çështje nga ligjet e fesë tuaj pa All-llahun dhe Pejgamberin.

Kjo gjë përforcohet edhe ma shumë, ro-bër të All-llahut, kur vinë telashet dhe sprovat, siç na thotë All-llahu, tebareke ve teala:

"Madje kur u vjen atyre (munafikëve) ndonjë lajm qetësues (kur fitojnë myslimanët) ose shqetësues (kur dështojnë), ata e përhapin atë, e sikur t'ia linin atë (përhapjen lajmit) Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxjerrin përfundime (se si do të duhej shpallur). Por sikur të mos ishte dhuntia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, atëherë ju, pos një pakice, do të ndiqnit rrugën e djallit". (En-Nisa: 83).

Në këtë rrugë kanë ecur selefus-salihu ynë, andaj suksesin dhe mëkëmbjen e kishin aleat. Kjo ka ndodhur përshkak të madhërimin të teksteve të shpalljes, veprimi sipas tyre dhe mosdhënia përparësi asgjës para tyre.

Tregohet me sened të vërtetë nga Ebu Hanifeja, Maliku, Shafiu dhe Ahmedi, rahimehumull-llah, thënia:

"Hadithi i vërtetë është medhhebi im".

Erdhi një njeri te Imam Shafiu, rahimehull-llah, dhe e pyeti për një çështje. Ai iu përgjigj: Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për këtë çështje ka gjykuar kështu e kështu. Ky njeriu i tha Imam Shafiu: ti çka thua për këtë çështje? I tha: subhanall-llah, a më sheh se jam në kishë, ose në sinagogë, sheh se në mes kam uçkur (si murgjërë)! Them: kështu ka gjykuar Pejgamberi, kurse ti më thua: ti çka thua për këtë çështje?!

Secili musliman e ka obligim ti dorëzohet plotësisht sherijetit të All-llahut, ti nënshtrohet gjërave që janë në to, dhe tërë këtë ta

pranon me pranim dhe vërtetim, duke mos iu kundërvënë me iluzione të kota, edhe nëse njerëzit i quajnë të logjikshme, interes, ose presion civilizues. Ashtu sikurse nuk i lejohet askujt ti mvesh sherijetit dyshime, mëdyshje, ose tu jep përparësi mendimeve të njerëzve ose mbeturinës së mendjes së tyre. Asgjë nuk pranohet nga kjo përpos arbitrimit, nënshtrimit, dorëzimit dhe përlules para sherijetit:

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht". (En-Nisa: 65).

"Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejo-

het) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetërfare. E kush e kundërshton All-llahun dhe të dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës". (El-Ahzab: 36).

Dërgoni selame dhe salavate mbi njeriun më të mirë dhe shpirtin më të pastër, Muhammedin, birin e Abdullahut, birin e Abdul-Mutalibit, pronarin e pishinit (haudit) dhe shefatit.

All-llahu ju ka urdhëruar me një gjë me të cilën ka filluar nga Vetvetja, e pastaj nga melaqet:

"Është e vërtetë se All-llahu dhe engjëjt e Tij me madhërim e mëshirojnë Pejgamberin. O ju që keni besuar, madhërojeni pra atë (duke rënë salavatë) dhe përshëndeteni me selam". (El-Ahzab: 56).

Suud Shurejmi

Imam dhe hatib i Mesxhidul-Haramit në Kabë, 9/4/1425

Përshtati: B.H.

Marrë nga: www.alminbar.net

4.6.2004

Mendjelehtët

Falenderimi i takon Allahut, që nga mëshira e vet dërgoi pejgamberë dhe shpalljen, për të na mësuar neve fenë, dhe se si të jemi të sjellshëm, të mençur dhe asnjëherë të mos jemi mendjelehtë. Me radhë në suren Araf, Allahu i Lartmadhërishëm, duke na rrëfyer në vazhdim për shembullin e Musait alejhis-selam, thotë:

155. Musai zgjodhi nga populli i vet shtatëdhjetë veta për kohën e takimit me Ne. E pasi që i kapi ata dridhja (e tokës), tha: "Zoti im! sikur të kishe dashur Ti, i kishe

zhdukur më parë ata dhe mua. A po na zhduk neve për atë që bënë të marrët nga ne? Kjo është vetëm sprovë e Jotja, që me të e bën të humbur atë që do, dhe e vë në rrugë të drejtë atë që do. Ti je mbrojtësi ynë, pra falna e mëshirona, se Ti je më i miri që falë (gabimet).

Pra pas krejt çka ndodhi Musa alejhis-selam morri për në takim shtatëdhjetë veta nga populli i vet. Dhe kur për një moment ata bënë një gabim ato i kapi e dridhja. Kjo që si një paralajmërim për ta. Kurse Musa alej-

his-salam bëri dua duke kërkuar falje gabimesh dhe mëshirë nga Allahu. Në këtë ajet Allahu neve na tregon një pyetje të cilën e bëri Musa, alejhis-salam, para duasë së tij e ajo ishte: a po na shkatërron neve për ate që bëjnë mendjelehtët tonë (sefih sh. sufeha, ata që janë të marrë, budallët, të papërgjegjshmit)?

Kjo dhe është një pyetje të cilën muslimanët e bëjnë kur e dijnë se për çfarë gabimi është duke ju ardh atyre dënimi; për ndonjë punë apo fjalë të papërgjegjshmëve? Kjo është një pyetje me të cilën kërkohet të dihet hiqmeti, urtësia e kësaj. E urtësia është në ate se Allahu askujt nuk i ban zullum, kurse muslimanët nuk duhet me i lanë të papërgjegjshmit të bëjnë punë ose të thonë fjalë për të cilat krejt muslimanët mandej hjekin. Kjo sepse Allahu neve na mëson në një ajet tjetër në suren Nisa:

“Mendjelehtëve mos u jepni pasurinë tuaj që All-llahu e bëri për ju mëkamje, e ata ushqeni nga ajo, veshni dhe u thoni fjalë të mira.”

Pra Allahu na ndalon neve që të japim përgjegjësinë e mallit mendjelehtëve e ku mbetet që atyre tu ipet ndonjë funksion, post apo udhëheqje me çështjet e muslimanëve. Ne si muslimanë ata që veç më janë treguar se janë mendjelehtë, se nuk dijnë të kryejnë punë, të mbajnë përgjegjësi, ti matin fjalët, nuk duhet ti hupim krejt, e as ti fshehim, por ato duhet me i mbajtë, me i ushqyer, por asnjëherë me i lanë që të thonë fjalë apo të bëjnë punë për krejt muslimanët, sepse azabi ju vjen mandje krejtve. Kjo është hiqmeti i kësaj, kjo është urtësia. Allahu e din më së miri, e ne prej fjalëve të Tij jemi të urdhëruar që mësim dhe këshillë të marrim.

Ramadan Ramadani

Pjesë nga hutbeja e mbajtur në xhaminë “Isa beg”-Shkup, më 04-06-2004.

11.6.2004

Bazat e sunnetit

Imam Ahmedi, radijall-llahu anhu, ka thënë: Bazat e sunnetit te ne janë:

1- Të kapurit për ate në të cilën kanë qenë shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem;

2- Pasimi i tyre;

3- Lërja e bidateve;

4- Çdo bidat është devijim;

5- Braktisja e hasmive dhe ndejës me ithtarët e epsheve;

6- Braktisja e polemikave sterile dhe hasmive në fe.

7- Tek ne sunnet janë gjurmët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

8- Sunneti e komenton Kur'anin dhe është udhërrëfyes (për kuptimin e) Kur'anit;

9- Në sunnet nuk ka analogji, nuk i sillen shembuj, nuk perceptohen me logjikë dhe epshë, por është pasim dhe flakje e tej epshit.

11- Prej sunnetit të domosdoshëm, nga e cila nëse e lë ndonjë gjë, nuk e pranon dhe i beson, nuk mund të jeshë prej ithtarëve të tij është:

12- Besimi në Kaderin, të mirën dhe të keqen dhe besimi i haditheve që flasin për te. Nuk thuhet: pse? Dhe si? Por është vetëm vërtetim dhe besim. Ai që nuk e di komentin e hadithit, por ia arrinë që ti kuptojë, i mjafton kjo dhe bëhen vendimtare për te, andaj duhet ti besojë ato dhe t'u nënshtrohet. Si në shembullin e hadithit të "Sadikul Masduk" (ai që flet të vërtetën dhe i vërtetuar, Pejgamberi, hadithi i njohur me këtë emërtim e që flet për ymrin, rizkun dhe se a do të jetë njeriu fatlum ose fatzi.) Ose hadi-

thet që flasin për kaderin, të pamurit Zotin, Kur'anin, e shumë sunnete tjera për gjëra që janë mekruh ose të ndaluara. Njeriu nuk mund të bëhet Ehli Sunnet (ithtar i sunnetit), edhe nëse në fjalët e tija ka sunnet, përderisa nuk e le polemikën sterile dhe nuk i dorëzohet sunnetit, e tu besojë gjurmëve.

13- Kur'ani është Fjala e All-llahut, e nuk është i krijuar, nuk duhet të jeshë i dobët e të mos thuash: nuk është i krijuar. Fjala e All-llahut nuk është e ndarë nga Ai dhe në Te nuk ka asgjë të krijuar.

Kujdes nga polemika me ata që kanë shpikur në këtë gjë, që flasin për fjalën e të tjera. E edhe nga ata që ndalohen në këte e thonë: "nuk e di a është i krijuar ose nuk është i krijuar, por është Fjalë e All-llahut." Ky është bidatçi, mu sikur ai që thotë se Kur'ani është i krijuar. Por është Fjala e All-llahut, e cila nuk është e krijuar.

14- Besimi në të pamurit Zotin në Ditën e Kijametit, siç transmetohet nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në hadithe të vërteta.

15- Dhe se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka parë Zotin e vet, pasi që tregohet me transmetime të vërteta nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem., Transmeton Katadeja nga Ikrimeja, nga Ibën Abbasi. E transmeton Hakemi nga Ebani nga Ibën Abbasi. E transmeton Ali ibën Zejdi nga Jusuf ibën Mehrani nga Ibën Abbasi. Hadithi tek ne kuptohet sipas kuptimit të dukshëm, ashtu siç ka ardhur nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse të folurit në këtë çësh-

tje është bidat. Por e besojmë ashtu siç ka ardhur dhe në te nuk polemizojmë me askend.

16- Besimi në Mizanin (peshorën) e cila do të vendoset në Ditën e Kijametit, sikur ka ardhur (në hadithin): "Do të llogaritet njeriu në Ditën e Kijametit, e nuk do të jetë i rëndë as sa një krah i mushkonjës". Do të peshohen veprat e njerëzve siç ka ardhur në hadithe. Duhet t'u besojmë dhe ti vërtetojmë dhe të ikim nga ata që i refuzojnë këto gjëra dhe duhet lënë polemikën me ta.

17- All-llahu u flet robërve në Ditën e Kijametit, e duke mos patur mes tyre dhe Atij përktihyes (përcjellës). Besimi në këte dhe vërtetim i së njëjtës.

18- Besojmë në ekzistimin e Pishinës (Haudit) dhe se ky i takon Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, pishinë, ku do të vijë ummeti i Tij Ditën e Kijametit. Është i gjërë sa i gjatë, aq sa mund të ecë njeriu për një muaj. Numri i enëve të saja është sa yjet në qiell, siç na kanë treguar lajmet e sakta në më shumë burime.

19- Besojmë në dënimin e varrit.

20- Besojmë se ky ummet do sprovohen në varret e tyre, do të pyeten për imanin islam, Zotin dhe Pejgamberin e tyre. Do tu vjen Munkeri dhe Nekiri, ashtu siç dëshiron All-llahu... Besimi në këte dhe vërtetim i së njëjtës.

21- Besojmë në Shefatin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për ata njerëz që do të dalin nga zjarri pasi që të jenë djegur e të jenë bërë shkrum. Do të urdhërohet që të dërgohen në një lum te dera e xhennetit, siç ka ardhur në gjurmë, ashtu siç dëshiron All-llahu. Besimi në këte dhe këtë duhet vërtetuar.

22- Besojmë se Mesihu Dexhalli do të del, mes syve të tija do të shkruan Kafir, u besojmë haditheve që flasin për këtë çështje dhe besojmë se kjo do të ndodhë.

23- Besojmë se Isai, alejhisselam, i biri i Merjemes, do të zbret dhe do ta vret ate (Dexhallin) në Bablud.

24- Besimi është fjalë dhe vepër, shtohet dhe pakësohet, siç ka ardhur në lajm: "Besimtari me iman më të plotë është ai që është me moral më të mirë".

25- "Ai që e le namazin ka bërë kufër" dhe "Nuk ka vepër, e cila kur lihet bëhet kufër, përpos namazit". Ai që e le namazin ai është kafir. All-llahu e ka lejuar vrasjen (luftimin) e tij.

26- Besojmë se më të mirët e këtij ummeti pas Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, janë: Ebu Bekri, pastaj Omeri, pastaj Othmani. Këtyre tre personave u japim përparësi ashtu si u ka dhënë përparësi Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Në këta tre askush nuk ka divergjenca. Pas këtyre treve vijon pesëshja e konsultimit: Ali ibën Ebu Talibi, Talha, Zubejri, Abdur-Rahman ibën Aufi dhe Sadi, që të gjithë të vlefshëm për të qenë halife dhe secili prej tyre është Imam. Këtë qëndrim e kemi nga hadithi i Ibën Omerit, radijall-llahu anhu: "I numëronim sahabet, kurse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte gjallë dhe shokët e tij të pranishëm: Ebu Bekri, pastaj Omeri, Pastaj Othmani, e pastaj heshtim". Pastaj pas pjesmarësve në konsultim, bedranët prej muhaxhirëve, pastaj bedranët nga ensarët, sipas hixhretit që kanë bërë dhe hershmërisë së ardhjes tyre në Islam, një pas një.

27- Pastaj njerëzit më të mirë pas këtyre, shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjenerata në të cilën është dërguar Pejgamberi, alejhisselam. Secili që e ka shoqëruar një vit, ose një muaj, ose një ditë, ose një orë, ose e ka parë, është prej shokëve të tij, aq sa e ka shoqëruar, nëse kontributin e ka patur me vehte, ka dëgjuar prej tij dhe e ka shikuar së paku një herë. Shoku më i ultë i tij është më i mirë se tërë gjene-

rata që nuk e kanë parë, edhe në qoftë se e takojnë All-llahun me të gjitha veprat e tyre. Ata të cilët e kanë shoqëruar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, që e kanë parë dhe e kanë dëgjuar, ai që e ka parë me sytë e veta dhe i ka besuar qoftë edhe një orë është më i mirë përshkak të shoqërisë se sa tabiinët edhe po qese këta i kanë vepëruar të gjitha veprat e mira.

28- Dëgjimi dhe respekti janë për ummetin dhe të parin e besimtarëve, qoftë ai i mirë ose i keq, dhe për ate që e ka marrë përsipër hilafetin, janë mbledhur njerëzit rreth tij dhe janë dakord me te, edhe për ate që e ka marrë këtë me shpatë, gjersa është bërë halife dhe është quajtur Emirul-Muminin.

29- Besojmë se beteja vazhdon deri në Ditën e Kijametit, me udhëheqës, qofshin ata të mirë ose të këqinjë dhe nuk duhet lërë.

30- Ndarja e pasurisë së luftës, zbatimi i kodit penal vazhdon të jetë detyrë e imamëve, askush nuk duhet ti akuzon në këtë dhe ti kundërshton.

31- Lejohet dhe zë vend sadakaja/zekati që u paguhet atyre. Kush ua jep atyre ajo i pranohet, pa marr parasysht se a janë ata të mirë ose të këqinjë.

32- Falja e namazit të xhumasë pas tyre, pas atij që ai e ka caktuar si guvernator, mbetet si obligim dhe vepër e lejuar. Falet dy rekate, kurse ai që i përsërit ato ai është mubtedi' (bidatçi), njeri që i ka lënë pas shpinde gjurmët, që e kundërshton sunnetin, nuk ka asgjë nga vlera e xhumasë. Edhe po nuk e sheh të arsyeshme namazin pas prijësve, qofshin këta të mirë ose të këqinjë, është sunnet që të falet me ta dy rekate dhe të beson se janë të plota. Nuk duhet të ketë aspak dyshim për këte në zemrën e tij.

33- Ai që del kundër prijësit prej prijësave të muslimanëve, rreth të cilit janë mbledhur njerëzit, të cilit ia kanë konfirmuar njerëzit

hilafetin, në çfarëdo mënyre qoftë kjo, me pajtim ose me fuqi, ky dalës ka çu fuqinë e muslimanëve, ka kundërshtuar argumentet nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e nëse vdes duke qenë kundër prijësit, vdes me vdekje injorante.

34- Nuk lejohet lufta kundër sulltanit, e as dalja kundër tij për asnjë njeri. Ai që e bën këtë ai është shpikës, është jashta sunnetit dhe rrugës.

35- Lufta kundër hajnave dhe havarixhëve është e lejueshme. Nëse synojnë ate apo pasurinë e njeriut, atij i takon ta mbrojë vehten dhe pasurinë e tij, ta mbrojë ate me krejt mundësitë që ka, kurse nëse e lënë ose ndahen prej tij, atij nuk i takon ti kërkojë, apo të shkon pas tyre. Kjo si takon askujt përveç imanit ose prijësve të muslimanëve. Atij i takon ta mbron vehten në atë pozitë, kurse e bën nijet që me mundin e tij mos ta vret askend. Nëse e mbyt ate me dorën e tij, duke e mbrojtur vehten në përleshje, të vrrin e largon Zoti (nga mëshira e Tij), e nëse vritet ky gjatë kësaj përleshjeje, duke e mbrojtur vehten dhe pasurinë, kam shpresë të jetë shehid. Siç është treguar në hadithe dhe në të gjitha gjurmët, ky njeri është urdhëruar ta lufton, e jo ta vret ose ta përcjellë, andaj atij nuk i lejohet që nëse e mund ose e lëndon, ose e robëron, që ta vret, e as të zbaton dënimin fetar për te, por çështjen e tij e ngritë deri tek ai që All-llahu i ka dhënë pushtet, e ata gjykojnë për te.

36- Për askend nga njerëzit e kibles nuk dëshmojmë për shkak të veprave të tija se është i xhennetit ose i zjarrit, por shpresojmë për të mirin kemi frikë për te dhe frikohemi për të keqin dhe mëkatarin, dhe shpresojmë për te mëshirën e Allahut.

37- Ai që takon All-llahun me një mëkat, për të cilin e meriton nga Zoti zjarrin, mirëpo pendohet dhe nuk insiston në këtë mëkat, All-

llahu ia pranon pendimin. All-llahu e pranon pendimin nga robërit e Tij dhe i fal gabimet.

38- Ai që takon All-llahun, pasi që i është ekzekutuar atij në dynja dënimi për shkak të mëkatit, ajo është shpagim i atij mëkati, siç na ka ardhur në lajmet nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

39- Ai që e takon All-llahun duke insistuar në mëkate, pa u penduar nga mëkatet, të cilat sjellin denime, çështja e tij është tek All-llahut, nëse Do e dënon, e nëse Do ia fal.

40- Ai që e takon All-llahun, si kafir, atë Ai e dënon dhe nuk e fal.

41- Gurrëzimi (er-rexhm) është hak i merituar për ate që ka bërë zina (imoralitet) dhe ka qenë i martuar, nëse ai e pranon këte ose ka dëshmi kundër tij.

42- Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka gurrëzuar (në cilësi të prijësit ka urdhëruar ekzekutimin e këtij dënimi sh.r.)

43- Imamët e drejtë pas tij poashtu kanë gurrëzuar.

44- Ai që nënçmon ndonjërin nga shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ose e urren ate për shkak të ndonjë ndodhie që e ka bërë, ose ia përmend të këqijat, është bidatçi, derisa të dërgon rahmet mbi të gjithë ata dhe të ketë zemër të shëndoshë ndaj tyre.

45- Nifaku është kufër: ta mohon Zotin dhe të adhuron të tjerët, kurse haptazi të shfaq islamin, sikur munafikët në kohën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

46- Fjala e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Kush i ka tre gjëra është munafik". Kjo është për frikësim. E transmetojmë ashtu siç na ka ardhur dhe nuk e komentojmë.

47- Fjala e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Mos u ktheni pas meje në mosbesimtarë e të devijuar, ta vritni njëri tjetrin". "Kur të takohen dy muslimanët me shpatat e tyre: vrasësi dhe i vrari janë në zjarr". "Sharja e muslimanit është mëkat, kurse vrasja e tij kufër". "Kush i thotë vëllaut të vet: o kafir, ka marr njëren prej të dyjave". "Ka bërë kufër ai që diferencohet nga prejardhja e tij edhe nëse e bën këte imët".

48- Këto dhe shumë hadithe të ngjajshme, nga ato që janë të vërteta dhe të ruajtura, i pranojmë ashtu si janë edhe nëse nuk ua dimë komentin, nuk flasim për to e as që polemizojmë. Këto hadithe i komentojmë ashtu siç kanë ardhur dhe nuk i kthejmë pos me hadithe më meritore se ato.

49- Xhenneti dhe xhehenemi janë të krijuara, siç ka ardhur nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Hyra në xhennet dhe pashë një pallat". "..pash Keutherin". "Shikova në xhennet dhe pashë shumicën e banorëve të saj...", "shikova xhehenemin e pashë...kështu". Ai që supozon se nuk janë krijuar akoma, ai përgënjeshtron Kur'anin dhe hadithet e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe nuk e mendoj si njeri që beson në xhennetin dhe zjarr.

50- Ai nga njerëzit e kibles që vdes si monoteist, i falet namazi i xhenazes dhe kërkohet falje për te, nuk ndalohet kërkimi i faljes për te, nuk lihet falja e namazit (të xhënazes) atij për te për shkak të ndonjë mëkati që ka bërë, qoftë (ky mëkat) i vogël ose i madh. Çështja e tij është te All-llahu.

Imam Ahmed

Traktati "Usulu s-Sunne" nga Imam Ahmed ibën Hanbel esh-Shejbani sipas transmetimit të Abdus ibën Malik El-Attari.

Përktheu: Bekir Halimi

Rregullat e vetë-zhvillimit në Islam

Zhvillimi bart nocionin e zmadhimit të kapaciteteve dhe potencialeve të një personi. Ai përfshin një lëvizje përpara nga një pozitë e caktuar, në një pozitë të arritjes më të madhe, një rasti dhe një përfitimi. Me qëllim të zhvillimit, individual ose kolektiv, është e nevojshme të definohen qëllimet që një person dëshiron t'i arrijë, faktorët që ndikojnë zhvillimin, dhe procesin e arritjes së qëllimeve të dëshiruara për zhvillim. Çdo qenie njerëzore është e lindur me një sasi të diturisë themelore. Se si kjo sasi modelohet varet nga kapacitetet thelbësore, ambientit arsimor dhe ndikimeve tjera të jashtme.

Islami vendos një pjesë të madhe të theksit në "vetë-zhvillim" ku një individ merr përgjegjësinë e kuptimit të qëllimit të jetës, dhe për formimin e asaj jete në mënyrën më të mirë të mundshme, për përfitimin e tij dhe për përfitimin e shoqërisë së gjërë; Islami poashtu ofron një udhëzim gjithëpërfshirës për të arritur këtë qëllim.

Zhvillimi njerëzor përbëhet nga proceset e rritjes dhe ndryshimit që bëhen prej lindjes deri në përfundim të jetës. Prosesi i zhvillimit ndikohet nga jashtë nëpërmjet receptorëve nervorë dhe organeve, dhe është përdërrerë vetë-shtyrëse nga gjërat që ndodhin brenda trupit dhe mendjes së njeriut. Fokusi jonë këtu është zhvillimi i mendjes së njeriut, që bëhet nëpërmjet receptorëve nervorë dhe proceseve të brendshme mentale. Ky zhvillim përfshin mësim nëpërmjet shqisave dhe njohjen (gjykimin) që paraqitet kur

mësimi përmbledhet në dituri për përdorim të vazhdueshëm.

Islami identifikon dy burime që luajnë rolin e edukimit ose korrupsionit të zhvillimit njerëzor. Inspirimi nga udhëzimi Hyjnor edukon zhvillimin njerëzor. Mos kushtimi i vëmendjes udhëzimit Hyjnor dhe rrëzimi ndaj kompleteve, që paraqiten nga ambienti i brendshëm ose i jashtëm, korrupsion zhvillimin njerëzor.

Zhvillimi njerëzor mund të vështrohet nga perspektiva të ndryshme, edhe si interes themelor njerëzor edhe si disciplina të formalizuara të studimeve siç është psikologjia, shkenca, filozofia, sociologjia, antropologjia dhe kështu me rradhë. Studimet bashkëkohore rreth zhvillimit njerëzor shpesh përfshihen në analiza dhe korrigjime (zgjidhje) kur zhvillimi njerëzor është i penguar për shkak të temperamentit, problemet me identifikimin ose identitetin e personit, shoqërinë, gjasat ose faktorët tjerë. Këtu, do të fokusohemi në principet themelore të zhvillimit njerëzor – me qëllim të mbulimit të faktorëve që mund ta pengojnë zhvillimin e duhur. Duke pasur parasysh kapacitetet e ndryshme mendore të njerëzve, çka duhet të bëhet me qëllim të sigurimit se ata të gjithë zhvillohen në mënyrë më të mirë të mundshme, për t'i arritur qëllimet e dëshiruara? Përderi sa ekzistojnë shumë faktorë që janë thelbësorë për zhvillimin e njeriut, së pari do t'i theksojmë ato që mund të jenë më kryesore. Faktorët më të rëndësishëm që luajnë rol seminal janë ato të të qenurit të vetëdijshëm

për veten, të qenurit të vetëdëshëm për kryerjen e veprave të duhura, dhe shmangies nga veprimi impulsiv.

Si mund që një person t'i inkuadrojë (aktivizojë) këta faktorë? Nëpërmjet procesit të quajtur identifikim ose 'konstruimi i një identiteti' (që është gjetja e mënyrave që ndihmojnë në zhvillimin e potencialit më të mirë njerëzor, dhe modelet që i paraqesin ato mënyra). Ajo mund të shihet si proces i shpejtë që na jep një ndjenjë se i takojmë një gjëje të largët dhe të çmueshme. Në vend se thjeshtë t'i miratojmë praktikën që i vërrejmë rreth nesh, shpesh mund të jetë më lehtë për të vështruar modelin dhe pas-taj thjeshtë të imitojmë atë person. Mirëpo, gjetja e një modeli të mirë në ambientin tonë bashkëkohor mund të mos jetë lehtë dhe në momente të caktuara ajo mund të jetë edhe habitëse, sidomos nëse të ashtuquajturit modele kalojnë nëpër ndryshime jetësore dhe pasojat e pasimit të stilit të tyre jetësor mund të bëhen të njohura më vonë. Veç kësaj, një top model, pavarësisht sa i mirë, mund të mos ketë mundësi të paraqesë çdo gjë në jetë. Edhe nëse kjo ishte e vërtetë, principet që i paraqet top modeli mund të mos jenë të qarta. Principet mund të rrjedhin vetëm përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve të përsëritura. Këtu na ndihmon historia. Nëse i shohim disa top modele nga historia, mund t'i shohim mësimet e nxjerrura nga historia e civilizimeve.

Duke u kthyer tani tek identifikimi, faktorin e vetëm më të rëndësishëm në zhvillimin njerëzor, duhet të identifikohemi me disa burime të pagabueshmë të udhëzimit, principet e pamohuara të zhvillimit njerëzor, dhe me kujdes të zgjedhim disa top modele. Shumica do të pranojnë Zotin si burim i pagabueshëm i udhëzimit, diturinë që Zoti na e solli neve në tokë rreth të mirës dhe të ke-

qes në civilizimin njerëzor, dhe Pejgamberët që kanë pasur rolin e top modeleve për arritjen e superioritetit në potencialin njerëzor. Për këtë shkak, të qenurit të vetëdëshëm për Zotin, i jep personit një identifikim rreth asaj se çka është e mirë për zhvillimin e potencialit njerëzor. Ajo parandalon armiqësimin. Një person çdoherë mund të gjejë mbështetje në prezencën e Zotit; fjalë për fjalë të bisedojë me Zotin në prosperitet dhe fatkeqësi, duke e mbajtur personalitetin e personit në një balans harmonik, duke u shmangur ekstremeve rreth personit ose të tjerëve në prosperitet, dhe duke u shmangur nga dëmi i stresit dhe mllëfit. Kuptohet, një person mund të shohë se është më lehtë të identifikohet me ndonjë (person) më fizik se Zoti në përpjekjet për të arritur qëllimet e njëjta. Megjithatë, prezenca e Zotit mund të ndjehet nga çdokush që i mbështetet Atij. Kjo është një gjë për të cilën Zoti na ka siguruar. Faktorët tjerë të rëndësishëm që mund të dalin nga ky proces i identifikimit janë të qenurit të sinqertë dhe të ndershëm, dhe kërkimi i mirëqenies individuale dhe kolektive në çështjet e ndryshme. Për t'i arritur këto qëllime, kërkimi për diturinë që ekziston dhe pjesëmarrja në rrjedhën e diturisë së re nga ajo ekzistuese janë parakushte themelore.

Pastrimi nga korrupsioni

Ne, rregullisht i lajmë duart para se të prekim ushqimin për shkak se duart tona janë në kontakt me aq shumë objekte që mund të përmbajnë bakterie të dëmshme nga të tjerët që prekin objektet e njëjta. Lajmë veshëmbathjen tonë kur bëhet me djersë ose papastërti nga trupi dhe rrethina jonë. Lahemi për të mbajtur trupin tonë të pastër. Të gjitha këto përpjekje për pastërti bëhen për të mbajtur veten në gjendje të mirë fizike. Por, si qëndron puna me disa përpjekje

për të mbajtur mendjen tonë të pastër dhe në shëndet të mirë? Shumë gjëra me të cilat bijmë në kontakt mund të korruptojnë mendjen tonë. Mund të shohim një person duke u kënaqur me rrahjen ose ofendimin e një personi tjetër. Ajo le përshtypje në mendjen tonë dhe mund të na bëjë që më vonë të bëjmë edhe ne të njëjtën gjë në mënyrë impulsive. Shohim njerëz që arrijnë sukses nëpërmjet gënjeshtreve dhe mashtrimeve, dhe mendja jonë mund ta perceptojë atë si një sjellje e pranueshme, sidomos nëse ata mashtrues konsiderohen si modele. Një fëmijë mund të kalojë nëpër keqpërdorim nga prindërit, të cilët konsiderohen të ndershëm në shoqëri dhe gjatë rritjes mund të përfshihen në një sjellje të njëjtë disfunktionale.

Shikimi dhe dëgjimi janë vitalë për mësimin dhe zhvillimin njerëzor. Ato mund të na ngrisin në lartësi të paparamendueshme të superioritetit njerëzor. Megjithatë, duhet të mësojmë t'i përdorim ato si duhet. Ndryshe, atë që e shohim dhe dëgjojmë mund ta korruptojë mendjen dhe të na degjenerojë në humnerën më të thellë të ekzistencës njerëzore.

Si ta pastrojmë veten nga ndikimet korruptuese rreth nesh? Duhet të reflektojmë asaj që e shohim dhe që e dëgjojmë dhe t'i ndajmë ato në përvojat që janë një formë e dëshirueshme e sjelljes dhe ato që janë të padëshirueshme në dritën e disa rregullave udhëzuese.

Ne mund ta quajmë ushtrim të mendjes, dhe e ngjashme me format tjera të ushtrimit, ushtrimi i mendjes ka nevojë për regjim dhe rregull.

Procesi i pastrimit të mendjes, ndryshe i quajtur edhe si pastrimi i zemrës dhe shpirtit, në Islam njihet si tazkiyyah. Parakushti për të filluar me tazkiyyah është të dihet se mendja e njeriut është e prirur për t'u bërë e korruptuar. Korrupsioni mund t'i atribuohet përfitimit të elementeve brenda një personi, ose ndikimeve të jashtme, ose madje

edhe të djave. Megjithatë, përgjegjësia për çfarëdo sjellje të padëshirueshme qëndron brenda personit që e kryen atë dhe jo personit ose ambientit që e ka shkaktuar atë. Të gjithë ne mbajmë përgjegjësi për veprimet tona. Sistemi ligjor do të na bëjë të përgjegjshëm nëse e shkelim ligjin, dhe Zoti do të na bëjë të përgjegjshëm nëse në sfida të udhëzimit hyjnor.

Një person nuk mund ta përdorë arsytimin se dreqi më shtyri ta bëjë atë, ose shefi më shtyri ta bëjë atë, dhe kështu me radhë. Nëse kapemi duke çuar shpejtë veturën në autostradë, nuk mund të lirohemi nga përgjegjësia për shkak se edhe të tjerët kishin çuar shpejt dhe nuk janë kapur. Zoti sheh dhe dëgjon çdo gjë. Nuk vjen në shprehje moskapja. Njëjtë siç kanë për qëllim rregullat e komunikacionit të na mbrojnë neve dhe të tjerët nga lëndimi, edhe udhëzimi hyjnor është thjesht për dobinë tonë. Koncepti i përgjegjësisë për veprimet e një personi quhet mas'uliyah. Suksesi në pastrimin e mendjes, shpirtit ose psikës, ka nevojë për njohjen se bota mund ta ndotë mendjen, shpirti mund të korruptohet nëpërmjet nxitjes, dhe dëshirat mund të planifikojnë të mbulojnë mendjen e një personi, dhe ta zhytin në një abnormalitet. Ta konsiderojmë këtë deklaratë nga Kur'ani: "Epshi është shumë nxitës për të keqen" (12:53). Çdokush është i lindur me një shpirt që është i pastër, i lirë nga korrupsioni ose papastërtia. Instinkti natyror ose dispozita e secilit shpirt njerëzor është ta bëjë atë që është e mirë. Përderisa personi rritet, porosinë e dëshirueshme nëpërmjet shikimit, dëgjimit, prekjes, shijes ose ndjenjave tjera, ndikojnë në pastërtinë e shpirtit të tij. Për këtë shkak çdo përvojë njerëzore duhet të kontrollohet për ndikimet potenciale korruptuese. Rifortimi i këtyre ndikimeve korruptuese, brenda men-

djes së njeriut, quhet procesi i pastrimit ose tazkiyyah. Këto ajete nga Kur'ani iluminojnë këtë koncept:

"Pasha njeriun dhe Atë që e krijoi atë! Dhe ia mësoi se cilat janë të këqijat dhe të mirat e tij. Pra, ka shpëtuar ai që e pastroi vetveten. E ka dështuar ai që e poshtëroi vetveten". (91:7-10).

Poashtu: "E kush iu frikësua paraqitjes para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve. Xhenneti është vendi i tij." (79:40-41).

Pavarësisht nga përpjekjet më të mëdha që një person mund t'i bëjë për pastrimin e mendjes, ende janë të mundshme devijimet (anomalitë). Mund të bëjmë gabime ose gjynahe. Çka ndodh atëherë? Një mendje e ushtruar si duhet posedon atë që quhet shpirt vetëkritik (nafs-e-lawwama). Ajo do të reagojë me pranimin se diçka nuk është bërë si duhet; dështimin do ta pranojë me përlësi dhe do ta angazhojë mendjen ta riformojë atë në mënyrë të përshtatshme. Nga ana tjetër, dikush që ka një shpirt të përcaktuar (nafs-e-ammara) pranimet e tilla mund t'i sheh si poshtëruese, dhe kështu duke u bërë e prirur për devijime edhe më të mëdha në të ardhmen. Nëse një akt i gabueshëm njihet (pranohet) me një përcaktim të konsiderueshëm për ta shmangur përsëritjen e saj, atëherë ajo është një akt i vetëpastrimit dhe zhvillimit të duhur njerëzor. Në të kundërt, një konsiderim i papërgjegjshëm i akteve të tilla çon në korrupsion të mëtutjeshëm të shpirtit dhe vetë-degjenerimit.

Regjimi i vetë-zhvillimit

Të kuptuarit e rregullave në përgjithësi është e kapshme për shumicën e njerëzve. Zbatimi i atyre rregullave në praktikë kërkon guxim, këmbëngulësi dhe rregull.

Ta konsiderojmë këtë pjesë të hadithit të Muhammedit s.a.v.s. për një nga gjërat që i ndodhën atij gjatë paraqitjes së tij para Zotit.

Pejgamberi tha: "... Allahu urdhëroi pesëdhjetë lutje (namaze) për pasuesit e mi, duke u kthyer me këtë urdhër të Allahut, kalova pranë Musait (a.s.) i cili më pyeti, 'Çka urdhëroi Allahu për pasuesit e tu?' U përgjigja, 'Ai për ta urdhëroi pesëdhjetë lutje'. Musai tha, 'Ktheu tek Zoti yt (dhe kërko zvogëlim) sepse pasuesit e tu nuk do të kenë mundësi ta bëjnë atë'. (Kështu që u ktheva tek Allahu dhe kërkoja zvogëlim) dhe Ai i zvogëloi ato përgjysëm. Kur kalova pranë Musait sërish dhe e informova për atë, ai tha, 'Kthehu tek Zoti yt, sepse pasuesit e tu nuk do të kenë mundësi ta bëjnë atë'. Kështu që u ktheva tek Allahu dhe kërkoja zvogëlim të mëtutjeshëm dhe gjysma e tyre u zvogëlua. Sërish kalova pranë Musait dhe ai më tha: 'Kthehu tek Zoti yt për shkak se pasuesit e tu nuk do të kenë mundësi ta bëjnë atë. Kështu që u ktheva tek Allahu dhe Ai tha, "Këto janë pesë lutje dhe ato të gjitha janë (baraz me) pesëdhjetë (në shpërblim) për shkak se Fjala Ime nuk ndryshon".

Lutjen që ne ia ofrojmë Zotit është një akt i përkujtimit të Tij dhe udhëzimit që Ai na e ka shpallur për ta formuar jetën tonë. Në këtë ushtrim formal përfshihemi pesë herë në ditë. E, pjesa e mbetur e kohës? Kjo na kërkon t'i reflektohem moralit të thënies së lartpërmendur të Pejgamberit. Ndoshta numri ideal për të qëndruar formalisht para Zotit do të ishte shtatëdhjetë herë në ditë, siç u informua Pejgamberi fillimisht. Por kjo do të ishte barrë shumë e madhe për ta mbajtur pjesa më e madhe e qenieve njerëzore, siç ndërhyri Pejgamberi Musa, a.s.. Përderisa numri formal i lutjeve është pesë, periudha tjetër duhet të mbushet, me mundësitë më të mëdha, në përkujtim të vazh-

dueshëm të Zotit dhe reflektimeve të veprimeve tona në dritën e udhëzimit. Duhet të jemi të vetëdëshëm për Allahun në çdo moment, pavarësisht nga koha dhe vendi, dhe t'i kushtojmë vëmendje udhëzimit të Tij në të gjitha punët tona. Në vend se të reagojmë në mënyrë impulsive, para se të folim ose veprojmë, duhet të mendojmë. Duhet t'i reflektohemi asaj që ndoshta e kemi folur ose e kemi vepruar. Procesi i pastrimit të mendjes në Islam konsiderohet forma më e madhe e vuajtjes njerëzore. Duhet të pasohet me këmbëngulje, durim dhe përcaktim, me besim në atë që Zoti na e ka shpallur, dhe veprimet që manifestojnë këtë besim në çdo moment, në vështirësi si dhe në prosperitet.

Shumicës prej nesh, gjatë fëmijërisë na kanë thënë të mbajmë ditare dhe t'i shënojmë gjërat e ndryshme që ndodhin gjatë ditës. Mençuria e asaj këshille qëndron më pak në krijimin e trashëgimisë dhe më shumë në reflektim, siç do të bënim zakonisht kur i shënojmë gjërat, dhe i rregullojmë në mënyrë që mund të jenë të dëshirueshme nga ato që mund të jenë të padëshirueshme. Ekziston nevoja që rregullisht të kujtohem në mbresat që kanë mbetur në mendjet tona nga ajo që mund ta shohim, dëgjojmë, ndjejmë dhe veprojmë, dhe t'i rivendosim ato në formacione mendore, lidhje për kujtesë, që i dimë si të dëshirueshme. Kjo është mënyra e vetme përmes të cilës mund t'i shmangemi sjelljes impulsive të bazuar në atë që e hasim në mjedisin tonë. Është e pamundur t'i rregullojmë gjërat ashtu siç i hasim, sidomos kur ato paraqiten në radhitje të shpejtë, ose në pjesë teatrale të cilat na mahnisin në moment. Duhet të ndajmë kohë t'i rishqyrtojmë ato gjëra në lëvizje të ngadalshme dhe pa ndikimet momentale dhe zërat e prapaskenës. Të gjithë kemi nevojë për reflektim dhe vetmi të qetë, në për-

pjekje për të formuar kuptimin e çështjeve në dritën e udhëzimit hyjnor.

Një person mund të pyet nëse ka fjalë të caktuara apostafate për t'u përfshirë në përkujtimin e Zotit dhe reflektimit të mendimeve dhe veprimeve. Pejgamberët e kanë parashtruar pyetjen e njëjtë. Përderi sa nuk ka kufi rreth asaj se çka mund të thotë një person, ajo që ne duhet të themi për Zotin është shumë e thjeshtë, e lehtë për të mbajtur mend dhe e drejtpërdrejtë në domethenie. Ja disa shembuj:

...Nuk ekziston zot tjetër përveç Allahut.

Kjo shprehje e thjeshtë ofron kulmin e zhvillimit njerëzor. Rikujtimi i vetvetes se nuk ka zot tjetër përveç Zotit ofron kornizën më të mirë të mundshme për zhvillim njerëzor pasi që atë që na thotë Zoti (Allahu) ta bëjmë është për të mirën tonë, dhe për ne nuk ka nevojë t'i nënshtrohemi asnjë fuqie në kundërshtim me atë që Zoti na e thotë. Zoti ka pushtet ndaj të gjitha gjërave dhe Zoti na i rregullon çështjet në mënyrë të drejtë nëse i drejtohem Atij. Duhet të themi sa më shpesh La ilaha il-l Allah. Pa përsëritje mund të harrojmë dhe mund të mos e kujtojmë këtë mençuri dhe kështu të bëjmë vepra të këqija, pa pasur qëllim.

Poashtu

... Të gjitha falenderimet qofshin për Allahun (al-hamdu lilāh)

La ilāha illa Allah na udhëzon të bëjmë gjëra të mira. Çdo e mirë që na vjen është nga Allahu. La ilāha illa Allah është siguri për bërjen e punës së mirë, dhe al-hamdu lil āh (të gjitha falenderimet qofshin për Allahun) është një njohje, me gjith përulësi, që e fitojmë vetëm atë që është bërë e mundshme nga Zoti.

Shprehjet La ilaha il-l Allah dhe al-hamdu lilāh duhet të jenë rikujtues gjithpërfshirës

në rregullimin e çështjeve tona dhe ato janë elemente themelore pastruese në pastrimin e mendjes dhe shpirtit tonë, duke na mundësuar të mbetemi në një rrugë që është në dobinë tonë më të madhe.

Shembuj të shprehjeve të zgjeruara në përkujtimin e Zotit për vetë-zhvillim janë:

“Lavdi Allahut, dhe të gjitha falenderimet qofshin për Allahun, nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe Allahu është më i madhi”. Po- ashtu “Nuk ka Zot përveç Allahut, Ai është Një dhe nuk ka shok. Ai është i Plotfuqishëm, dhe Ai është i Gjithndershëm, dhe Ai është i Plotfuqishëm mbi çdo gjë”.

Përfundime

Ekzistojnë mënyra dhe fjalë pafund në shprehjet për përkujtim të Allahut, dhe kërkimit afërsi me Të për zhvillim personal. Mirëpo, fjalët e thjeshta mund të arrijnë thellësi- ra të pakufizuara në domethënie kur shprehen me devotshmëri dhe sinqeritet. Është kjo fuqi e thjeshtësisë së çuditshme që është brenda mundësive të secilit prej neve.

Më në fund, një sigurim për shpërblimet që na i ka premtuar Allahu në këtë dhe në botën tjetër: “Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që e përkujton madhërinë e Zotit të vet dhe falet”. (87:14-15)

Dr. Syed Imtiaz Ahmad – nënkryetar i ISNA Canada
Përktheu: Xh.Aliu
28.5.2004

Dërgimi i ushtrisë së Usames-rrëfimi dhe mësimet

Në këtë artikull paraqitet një qëndrim shembullor i Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, në fillim të hilafetit të tij dhe mësimet që duhet të merren nga ky qëndrim.

Rrëfimi

Ishte muaji Sefer i vitit njëmbëdhjetë të Hixhrës kur i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mori një sëmundje prej së cilës nuk u shërua më. Sëmundja avanconte me ditët që kalonin. Një ditë ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i thirri shokët dhe iu drejtua atyre: "Bëjeni praktikë të nderoni dhe dërgoni delegacione me dhurata dhe shpërblime. Përzini politeistët nga Gadishulli arabik dhe dërgoni ushtrinë e Usames. Tregoni këndshmëri ndaj ensarëve dhe falni gabimet e

tyre..." pastaj ai ra i pavetdijshëm shkaku i dhimbjes dhe ndërroi jetë katër ditë pas kësaj.

Kur lajmet e vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, u përhapën, herezia ngriti kokën e saj duke çuar një numër njerëzish jashtë islamit. Dexhalët si Musejleme el-kedh-dhab dhe Esved pretenduan profetësi dhe u bënë shkak që një grup njerëzish t'i ndjekin ata. Vdekja e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, iu duk si një mundësi armiqve të islamit për të sulmuar el-Medinën dhe për të vënë planet e tyre të prishura.

E gjithë kjo i shqetësoi ndjekësit e sinqerë dhe të devotshëm të islamit të cilët ishin të mërzitur nga vdekja e Pejgamberit të dashur, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, lideri dhe udhërrëfyesi i tyre. Se sa ishte ajo dhimbje e

tyre kuptohet nga dëshmia e Enesit, radiajallahu anhu, i cili ka thënë: "Unë nuk kam parë një ditë më të mirë dhe më të shkëlqyeshme sesa dita kur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, erdhi tek ne dhe unë nuk kam parë ditë më të keqe ose të errët sesa ajo ditë në të cilën Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, vdiq".

Nëse Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk do të kishte futur guxim, vendosmëri dhe qëndrueshmëri në sahabet e tij, ata do të kishin rënë në dëshpërim në këtë situatë alarmante.

Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, u bë halife dhe në ditën e tretë pas vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ai lajmëroi dërgimin e ushtrisë së Usames siç ishin urdhërat e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Para vdekjes së tij i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e kishte dërguar edhe më parë Usamen, radijallahu anhu, me një numër të madh sahabesh të dalluar për të luftuar romakët, megjithatë ekspedita u ndal në el-Xhurf, një vend 5 km jashtë Medines, për shkak të sëmundjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Në përgjigje të urdhërave të halifes njerëzit u grumbulluan në el-Xhurf por ata nuk ranë dakord me të për të dërguar një numër të madh sahabesh për të luftuar romakët e ndërsa Medina kryeqendra e muslimanëve të lihej e pambrojtur. Kështu ata i kërkuan Ebu Bekrit, radijallahu anhu, për ta tërhequr ushtrinë por ai, radijallahu anhu, refuzoi me vendosmëri thirrjen e tyre duke thënë: "Edhe nëse do të lihem vetëm e të di që bisha të egra mund të më shqyejnë, unë do ta dërgoja ushtrinë e Usames. Unë nuk do të zbrapsem në asnjë mënyrë nga ajo që Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na ka urdhëruar të bëjmë për të vazhduar".

Më vonë disa nga ensarët të cilët ishin në shoqërinë e Usames, radijallahu anhu, iu afruan Omer ibën Hattabit, radijallahu anhu, për t'i kërkuar halifes për ta zëvendësuar Usamen, radijallahu anhu, i cili ishte vetëm 17-18 vjeç, me një person tjetër me më shumë eksperiencë për të udhëhequr ushtrinë. Omeri, radijallahu anhu, ia përcolli opinionet e ensarëve Ebu Bekrit, radijallahu anhu, ndaj të cilave ai iu përgjigj negativisht dhe nga zemërimi e kapi Omerin për mjekre dhe i tha: "O Omer! Të humbët nëna ty (një shprehje arabe për të treguar jo-aprovim) i Dërguari i Allahut ka urdhëruar Usamen të udhëheqë ushtrinë dhe ti je duke më kërkuar ta heq atë nga kjo pozitë! "

Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, pastaj iu drejtua el-Xhufrit në mënyrë që të dërgonte ushtrinë. Usame, radijallahu anhu, ishte duke ecur në kalë dhe Halifeja e shoqëroi atë në këmbë. Usame, radijallahu anhu, i tha Ebu Bekrit: "Ose ti do të ecësh në kalë ose unë do të zbres". Ebu Bekri i është përgjigjur: "As ti nuk do të zbrësh nga kali as unë nuk do të eci mbi kalë. Çfarë unë humbi duke ecur në rrugën e Allahut! Shtatëqind të mira shkruhen për ushtarin musliman për çdo hap që ai merr në rrugë të Allahut dhe rangi i tij rritet me shtatëqind dhe shtatëqind gjynahe i hiqen atij". Ai pastaj i kërkoi Usames, radijallahu anhu: "Nëse ti do të më ndihmosh mua atëherë dërgoje Omerin në Medine me mua". Usame, radijallahu anhu, veproi sipas kërkesës së halifes dhe e ktheu Omerin, radijallahu anhu, në Medine.

Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, pastaj këshilloi ushtrinë me dhjetë gjëra, ai tha: "

1. Mos iu afroni pronave (për të vjedhur).
2. Mos gënjeni.
3. Mos mashtroni.
4. Mos vrisni fëmijë, gra.
5. Mos preni pemë frutdhënëse.

6. Mos preni deve, lopë ose dhi përveçse për të ngrënë.

7. Ju do të kaloni ndër njerëz të tillë të cilët e kanë mbyllur veten në vende adhurimi (murgjit) mos i thoni asnjë gjë atyre dhe lini ata siç janë.

8. Ju do të kaloni ndër njerëz të cilët do t'ju servirin llojë të ndryshme ushqimesh kështu thoni bismillah kur të hani.

9. Ju do të kaloni ndër njerëz të cilët do ta kenë pjesën e përparme të kokës të rruar me bishtaleca të varur nga të gjitha anët e kokës, vritni ata me shpatë.

10. Mbroni veten me emrin e Allahut".

Pastaj ai iu kthye Usames dhe i urdhëroi atij të kryente sulmin në të njëjtën mënyrë siç i Dërguari i Allahut e ka urdhëruar.

Usame, radijallahu anhu, marshoi përpara me ushtrinë e tij dhe arriti Xhordon dhe Bal-kan. Kur lajmet e vdekjes së pejgamberit dhe pastaj lajmet e një ushtrie të madhe muslimane i arritën romakët; ata u habitën: "Sa e çuditshme është që lideri i tyre ka vdekur dhe ata po afrohen për të sulmuar tokat tona. Me të vërtetë ata janë të fuqishëm ndryshe nuk do të guxonin të na sulmonin ne! "Kjo ushtri e madhe është një provë e fuqisë së tyre të madhe. Kështu armiqët e islamit u frenuan (ishin të frikësuar) nga të sulmuarit e muslimanëve në Medine ose të blloktonin ushtrinë. Ushtria muslimane arriti destinacionin e saj i mundi romakët dhe u kthye me një sasi të madhe plaçke lufte.

Mësimet

a) Rrethanat ndryshojnë

Incidenti i mësipërm konfirmon faktin që rrethanat ndryshojnë dhe nuk janë kurrë të njëjta. Gjendja para vdekjes së të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndryshoi krejtësisht pas vdekjes së tij. Përpara islami dhe muslimanët ishin duke shijuar

suksesin dhe njerëzit po e pranin islamit me numër të madh...

Në vitin e nëntë të hixhretit delegacionet nga zona të ndryshme arrinin vazhdimisht, për të pranuar islamit, aq sa që ai vit u quajt "viti i delegacioneve". Në kohën e çlirimit të Mekës muslimanët ishin 10 mijë dhe një vit më vonë në luftën e Tabukut numri i tyre u rrit në tridhjetë mijë. Tani arabët shikonin Medinen me respekt dhe nuk u mbetej asnjë zgjidhje tjetër përveçse t'i nënshtroheshin muslimanëve.

Pastaj erdhi një kohë kur rrethanat papritur ndryshuan dhe Medineja u bë shënjestër e të gjitha fiseve arabe të cilët donin të asgjësonin çdo shenjë të islamit.

"E punon atë që dëshiron". [el-Buruxh: 85: 16]

"Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten". [el-Enbija: 21: 23].

"As gëzimi nuk qëndron i përgjithmonshëm e as vështirësitë, ndonjëherë njerëzve i jepet kënaqësi dhe armiqët e tyre i rrethojnë vështirësitë dhe ka kohë që situata ndryshon. Një gjë nuk qëndron e njëjtë gjithmonë dhe as efektet e saj nuk janë të perjetshme". [Shih Tefsir el-Taberi (4: 218)]

Është obligim për muslimanin të bëhet i durueshëm nëse përballet me vështirësi dhe vuajtje. Ai duhet gjithmonë ta kujtojë që ndihma e Allahut është e lidhur me durimin dhe nuk është karakteristike e besimtarit të dëshpërohet nga Mëshira e Allahut që:

"...E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi". [el-Inshirah: 94: 5-6]

Kështu nga muslimanët është e kërkuar të qëndrojnë të vendosur kundër të këqijave dhe mosbesimit në të gjitha rrethanat siç Allahu ka urdhëruar në Kur'an:

"Ti përqëndrohu vendosmërisht ashtu si je i urdhëruar, e bashkë me ty edhe ata që u

penduan (prej idhujtarisë), e mos tejkaloni (kufijtë e caktuar), se me të vërtetë Ai është shikues i asaj që veproni". [Hud: 11: 112]

b) Vështirësitë nuk pengojnë besimtarin të kryejë urdhërat e Allahut

Vdekja e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte një ngjarje shumë tragjike për sahabet veçanërisht për Ebu Bekr es-Siddik, radijallahu anhu, sepse ai ishte më i afërti i të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në mesin e tyre. Amër bin el-Asi, radijallahu anhu, ka transmetuar: "... unë isha tek (pejgamberi) dhe i thashë: "Cili është më i dashur për ty? "Ai ka thënë: "Aisha" Unë e pyeta "prej burrave? " Ai ka thënë: "Babai i saj (Ebu Bekr es-Siddik)". [Sahih el-Buhari] Ebu Bekri, radijallahu anhu, nuk mund t'i kontrollonte emocionet madje edhe kur ai kishte ndjenjën që i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do largohet nga kjo botë. Kur Allahu shpalli ajetin: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe. E kush detyrohet nga uria (të hajë nga të ndaluarat), duke mos anuar dhe duke mos patur qëllim mëkatit, All-lahu falë shumë dhe është mëshirues". [el-Maide: 4: 3]

Sahabet e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, shfaqën gëzim mbi shpalljen e këtij ajeti por Ebu Bekri ishte i trishtuar dhe qau. Ai e kuptoi që ky ajet tregon largimin e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ngase pejgamberllëku nuk ishte i kërkuar më pas plotësimit të fesë.

Ebu Bekri ishte aq i trishtuar mbi vdekjen e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që për kushdo që të vdiste, do tu thoshte: "Kujto vdekjen e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nga kjo vështirësitë e tuaja do të pushojnë dhe Allahu do të të shpërblejë".

Por a e pengoi kjo vështirësi e madhe Ebu Bekrin të kryente urdhërat e Allahut? A e bëri të neglizhonte urdhërat e Allahut? Jo, përkundrazi vetëm pas tre ditësh pas vdekjes së pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Ebu Bekri urdhëroi ushtrinë e Usames për të marshuar drejt cakut të saj.

Dhe vështirësia nuk ishte vetëm që i Dërguari i Allahut kishte ndërruar jetë por gjithashtu që një grup njerëzish kishin dalë nga feja dhe frikësohej që çifutët dhe murtedët (ata që kishin dalë nga feja) do të sulmonin Medinen.

Kjo situatë dhe rreziku i Medines ishte i njohur për Ebu Bekrin, por sërrish ai ishte i vendosur të vinte në praktikë urdhërat e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Dhe në këto rrethana ai, radijallahu anhu, la një dëshmi që është shkruar në historinë e islamit: "Edhe nëse do të lihem vetëm e të di që bisha të egra mund të më shqyejnë, unë do ta dërgoja ushtrinë e Usames. Unë nuk do të zbrapsem në asnjë mënyrë nga ajo që Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na ka urdhëruar të bëjmë për të vazhduar".

Këto dëshmi të Ebu Bekrit nuk janë të papritura sepse ai ishte edukuar nga Pejgamberi Muhammed - në atë mënyrë që në çdo situatë, të vështirë dhe të lehtë, ai do të punonte për ngritjen dhe forcimin e islamit.

Ebu Bekër es-Siddik radiallahua anhu gjithmonë qëndroi i vendosur mbi mësimet të cilat ai i mori nga i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe ne shohim se ai gjithmonë përpigjej për të përhapur fenë islame. Dhe në shtratin e tij të vdekjes, Ebu Bekri, radijallahu anhu, e këshilloi Omer Ibën Hattabin radiallahua anhu: "Omer! Dëgjo çfarë kam për të të thënë dhe pastaj kryejë atë. Unë mendoj se do të vdes sot (dhe ishte e hënë) nëse do të vdes (gjatë ditës) atëherë ti dërgoi njerëzit përpara agimit. As-

gjë nuk duhet të të pengojë ty nga të kryerit e urdhërave të Allahut. Ti e pe se çfarë unë bëra pas vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, edhe madje kur njerëzit ishin të rrethuar nga vështirësi të tilla që nuk ka shembuj për ta. Vallahi! Nëse unë do të isha vonuar në kryerjen e urdhërave të Pejgamberit ose do kisha shfaqur dobësi, atëherë ne do të poshtëroheshim dhe Allahu do të na kishte dënuar ne dhe pastaj Medineja do të ishte shkatërruar".

SubhanAllah! Sa e madhe ishte dëshira e tij për të ndjekur mësimet e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem! !

Mu si Ebu Bekri edhe Omeri, radijallahu anhu, nuk vonoi në kryerjen e urdhërave të Allahut. Së shpejti pas vdekjes së Ebu Bekr es-Siddik, Omeri, radijallahu anhu, e dërgoi ushtrinë përpara namazit të sabahut. Pa dyshim, vdekja e Ebu Bekrit ishte një kohë e dëshpërueshme për Ummetin por kjo gjë nuk e ndaloi Omerin, radijallahu anhu, nga përbushja e obligimeve të tij.

c) Thirrja në islam nuk ndalet

Këto incidente gjithashtu provojnë që thirrja në islam nuk është e kufizuar vetëm për disa individë por ajo duhet të kryhet nga çdo musliman i cili i ka mundësitë të veprave të këshu. Allahu, subhanehu ve teala, e shpalli islamin në mënyrë që të ishte superiore ndaj të gjitha feve të tjera.

Allahu thotë në Suren el-Tevbe, ajeti i tridhjetë e tretë: "Ai (All-llahu) është që e dërgoi të Dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejtën idhujtarët".

Allahu ka vendosur që një grup prej muslimanëve gjithmonë do të vazhdojnë në përhapjen e islamit. Imam Muslim, rahimehullah, shënon në sahihun e tij nga Xhabiri, radija-

llahu anhu, që i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Unë dëgjova të Dërguarin e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të thotë: "Një grup njerëzish nga ummeti im do të vazhdojnë të luftojnë në mbrojtje të së vërtetës dhe do të qëndrojnë triumfues deri në ditën e gjykimit". [Sahih Muslim]

Duke dërguar ushtrinë e Usames radijallahu anhu, Ebu Bekri, radijallahu anhu, e provoi me fjalët dhe veprat e tij që muslimanët kurrë nuk e kanë lënë thirrjen në islam e as që ata do të ndalen nga thirrja e njerëzve për në fenë e vërtetë.

I njëjti entuziazëm dhe kurajo për përhapjen e fesë së Allahut gjendet tek të gjithë sahabet e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Në luftën e Uhudit kur konfuzioni zuri vend midis muslimanëve dhe u përhap si një zhurmë që i Dërguari i Allahut ishte vrarë, disa nga sahabet u ulën, të ndikuar nga këto lajme të tmerrshme. Ata u dorëzuan. Enes Ibën en-Nadr, radijallahu anhu, shkoi tek ata dhe i tha atyre: "çfarë ju shtyri juve që të jeni ulur? "Ata iu përgjigjen: "I Dërguari i Allahut është vrarë". Ai i tha: "Atëherë çfarë jeni duke bërë ju me jetërat tuaja pas tij". Ngrihuni, luftoni dhe vdisni për ate për të cilën i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka vdekur". Pastaj ai shkoi para dhe u takua me Sad Ibën Muadh, radijallahu anhu, dhe i tha: "O Sad Ibën Muadh! Pasha Zotin e Nadrit, Xhenneti; unë ja ndiej erën që vjen nga kjo anë e Uhudit". Transmetuesi thotë: "Ne gjetëm më tepër sesa tetëdhjetë plagë nga shpata dhe shiçeta në trupin e tij (Enes Ibën en-Nadrit). Ne e gjetëm të vdekur dhe trupi i tij është copëtuar aq keq sa askush nuk ishte në gjëndje ta njihje përveç motrës së tij, e cila e njohu nga gishtërinjt e tij..." [Sahih el-Buhari]

d) Obligimi, shpërblimet dhe dobitë e ndjekjes së Sunnetit

Një nga mësimet themelore që mund të merren nga ky akt i Ebu Bekrit, radijallahu anhu, është që ndjekja e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, është obligim mbi muslimanët edhe në kohërat e vështirësive dhe pengesave, Allahu thotë: " çka t'ju jep Pejgamberi, atë merreni e çka t'ju ndalojë, përmbanju dhe keni frikë All-llahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër". [el-Hashr: 59: 7]

Është shënuar në sahih el-Buhari nga Ubade Ibën Samit, radijallahu anhu, që ai ka thënë: "Ne u betuam tek i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, që bie zemra dakord ose nuk bie, ne do t'i bindemi urdhërave tuaja, në çdo situatë". Në një tjetër transmetim thuhet: "...në kohëra të vuajtjes dhe në ato të kënaqësisë, dhe gjithashtu kur ai, i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, preferon dikënd tjetër para nesh". [Sahih el-Buhari]

Sikur që Ebu Bekri, radijallahu anhu, dërgoi ushtrinë e Usames në ditën e tretë pas vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, mund të gjinden shembuj të shumtë në biografitë e sahabeve, radijallahu anhum, që ata nxitonin drejt ndjekjes së të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Imam Buhari, rahimehullah, transmeton nga el-Bara, radijallahu anhu, që ai ka thënë: "Kur i Dërguari i Allahut erdhi në Medine, ai u fal në drejtim të Bejt el-Makdis (Kuds) për gjashtëmbëdhjetë ose shtatëmbëdhjetë muaj, megjithëse ai dëshironte t'i drejtohet Qabes. Allahu, subhanehu ve teala, shpalli: "Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e Ne gjithëqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes), dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah ajo anë. E atyre që

u është dhuruar libri, ata e dinë sigurisht se kjo (kthesë) është e vërtetë nga Zoti i tyre. E All-llahut nuk mund t'i fshihet ajo që veprojnë ata". [el-Bekare: 2: 144] Kështu ai iu drejtua Kabes. Një njeri fali namazin e ikindisë me të dhe pastaj u largua dhe erdhi tek një grup ensarësh dhe i tha: "Unë dëshmoj që unë jam falur me Pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe që atij iu është urdhëruar për t'iu drejtuar Qabes. Kështu ata iu drejtuan Qabes ndërkohë që ata ishin në ruku gjatë faljes së ikindisë". [Sahih el-Buhari]

Kështu sahabet madje nuk pritën të ngrinin kokat nga rukuja dhe nxituan për t'u kthyer andej kah i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte kthyer (për t'u falur).

Një tjetër shembull që mund të merret është nga transmetimi i Enes Ibën Malik radijallahu anhu, i cili ka thënë që një njeri erdhi tek i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe ka thënë: "gomerët (janë prerë dhe) janë ngrënë". Ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk iu përgjigj. Një tjetër njeri erdhi tek ai dhe i tha, gomerët (janë prerë dhe) janë ngrënë. Ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk iu përgjigj. Një i tretë erdhi dhe i tha, gomerët janë asgjësuar. Mbi këtë ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, urdhëroi një thirrës të lajmëronte njerëzit: "Allahu dhe i Dërguari i tij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ju ka ndaluar ju të hani mishin e gomerëve shtëpiak". Kështu enët u derdhën ndërsa mishi po zihej në to".

Jo vetëm burrat prej sahabeve kanë nxituar në të ndjekurit e urdhërave të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem; madje edhe gratë ishin shumë të ngutshme në të ndjekurit e Pejgamberit tonë të dashur, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ebu Usejd el-Ensari, radijallahu anhu, ka thënë që ai ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërsa ai ishte jashtë xhamisë, bu-

rrat me gratë përziehen në rrugë dhe kësh-tu i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Tërhiquni mbrapa se ju (gratë) nuk duhet të ecni në mes të rrugës; mbani anët e rrugës. Kështu gratë ecnin afër mureve sa që veshjet e tyre i ndeshnin ata". [Sahih, Sunen Ebu Davud (3/989)]

Le ti gjykojmë vetët tona a jemi ne si bu-rrat dhe gratë në kohën e Dërguarit të Alla-hut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të cilët ndo-qën secilin dhe çdo urdhër të Dërguarit të Allahut me nxitim? Pse nuk ndjekim edhe ne pejgamberin tonë të dashur në të gjithë atë që ai ka ardhur, e jo të ndjekim jobesimtarët ne veshje, zakone dhe tradita. Sa herë ndodh që është e pamundur të dallosh mus-limanët nga jobesimtarët përshkak të ngjashmërisë së tyre!

Ne duhet të jemi të kujdesshëm që nderi jonë dhe sukcesi të mbështetet vetëm në të ndjekurit e Sunetit të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Nëse ne largohemi nga rruga e tij ne do të poshtërohemi në këtë jetë dhe në tjetrën. Kur Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, vendosi për të Dërguar ushtrinë e Usames, radijallahu an-hu, muslimanët u rrethuan me të gjitha llojet e vështirësive dhe ata nuk qenë dakord për çështjen. Megjithatë, Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, nuk morri në konsideratë mosrënien dakord dhe urdhëroi ushtrinë e Usames për të udhëhequr ushtrinë e tij drejt Bizantit dhe të gjithë njerëzit iu bindën ur-dhërave të halifes. Kështu kur njerëzit vep-ruan në përputhje me urdhërat e të Dërgua-rit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Allahu, subhanehu ve teala, i begatoi ata me fitore dhe sasi të mëdha prejë lufte. Ai gjithashtu shkaktoi që armiqt e islamit t'i fri-kësoheshin muslimanëve dhe kështu siguria dhe paqja mbizotëroi në Medine.

Nuk është për tu habitur nderi dhe sukse-si që arritën muslimanët për shkak të dërgi-mit të ushtrisë së Usames në përputhje me urdhërat e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, sepse është traditë e Allahut, subhanehu ve teala, që Ai mbështet dhe ngre lart ata të cilat i binden të Dërguarit të Tij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ai thotë në Kur'an:

"E bindjuni All-llahut dhe të Dërguarit, ash-tu që të mëshiroheni". [ali-Imran: 3: 132]

"Falni rregullisht namazin, jepni zeqatin dhe respektoni të Dërguarin në mënyrë që të mëshiroheni". [Nur: 24: 56]

Kështu kushdo që i bindet të Dërguarit e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të arrijë sukses dhe fitore dhe kushdo që nuk i bindet atij ka zgjedhur një rrugë për tu poshtëruar. Nëse sot muslimanët janë duke u përballuar me vështirësi dhe shtypje nga qufarët (jobesimtarët) dhe kanë humbur si-gurinë dhe paqen - padyshim që kjo është rezultat i dështimit tonë për të kryer fenë me të cilën Allahu e ka dërguar të Dërguarin e Tij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem!

e) Askush nuk është i pagabueshëm për-veç të Dërguarit të Allahut

Sahabet, radijallahu anhum, bënë një ga-bim kur ata nuk ranë dakord me Ebu Bekrin, radijallahu anhu, për sa i përket dërgimit të ushtrisë së Usames, radijallahu anhu. Kjo tregon që askush nuk është i pagabueshëm. Askush nuk flet dhe vepron me shpallje nga Allahu, përveç Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Allahu, subhanehu ve teala, tho-të në Kur'an: "Dhe ai nuk flet nga dëshira e tij. Ai nuk është tjetër pos shpalljes që i shpallet". [en-Nexhm: 53: 3-4]

Askush nuk është ma'sum (i pagabue-shëm) përveç të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Ne nuk jemi të urdhëruar t'i bindemi askujt përveç Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Allahu thotë: " Ne nuk dërguam asnjë të dërguar vetëm që me urdhërin e Allahut t'i bëhet respekt (nga njerëzit) atij". [en-Nisa: 4: 64] dhe "çka t'ju jep Pejgamberi, atë merreni e çka t'ju ndalojë, përmbaniju dhe keni frikë Allahun, se All-llahu është ndëshkues i ashpër". [el-Hashr: 59: 7]

Allahu gjithashtu shpjegon që nëse njerëzit i binden personave të tjerë përveç të Dërguarit të Tij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, do të rezultojë me vetë shkatërrimin e tyre. Ai ka thënë: "O besimtarë, mos bëni asgjë para (se të orientoheni në udhëzimet e) Zotit dhe të Dërguarit të Tij, keni kujdes Allahun, se me të vërtetë All-llahu i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha". [el-Huxhurat: 49: 7]

Kështu madje kur Allahu na ka urdhëruar t'i bindemi liderëve tanë ai e bëri një kusht që lideri të jetë i drejtë dhe urdhërat e tij të mos i tejkalojnë limitet që Allahu, subhanehu ve teala, ka vendosur. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, e ka shpjeguar këtë çështje në shumë hadithe. Një herë Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dërgoi disa njerëz nën udhëheqjen e një njeriu nga Ensarët dhe i urdhëroi ushtarët që t'i binden atij. Ai lideri u bë i zemëruar dhe tha: "A nuk ju ka thënë pejgamberi të më bindeni mua! "Ata i thanë "Po". Ai i tha: "Mblidhni drunj zjarri për mua". Kështu ata mblodhën dru zjarri. Ai i tha: "Bëni një zjarr". Kur ata e bënë atë, ai i tha "Hyni në të". Kështu ata e patën për qëllim ta bënin atë dhe filluan ta mbanin njëri tjetrin dhe të thonin: "Ne vrapojmë drejt pejgamberit nga zjarri". Ata vazhduan ta përsërisnin atë derisa zjarri u fik... kur lajmet e arritën pejgamberin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ai tha: "Nëse ata do të kishin hyrë në të (zjarr) ata nuk do të kishin dalë prej tij deri në ditën e gjykimit.

Bindja (ndaj ndokujt) është për në ma'ruf (ate që është e mirë sipas sheriatit sh.r.). [Sahih el-Buhari vol. 5 nr. 629]

f) Ndryshimi në mendime ndërmjet muslimanëve të drejtë

Historia e nisjes së Usames gjithashtu tregon që ndryshimi në mendime është i mundshëm madje edhe midis njerëzve të drejtë si sahabet, radijallahu anhum, të cilët nuk ranë dakord. Mosmarrëveshjet me siguri që do të ekzistojnë sepse Allahu thotë: "...njeriu është i krijuar i dobët". Njeriu është i dobët në diturinë e tij dhe në të kuptuarin e tij. Si rezultat ai me siguri do të bëjë gabime. Për më tepër mosmarrëveshjet kanë ekzistuar midis sahabeve madje edhe në kohën e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Kur i Dërguari i Allahut u kthye nga lufta e Ahzabit dhe hoqi mburojën, Xhibrili, alejhis-selam, erdhi tek ai dhe i tha: "Ne (melekët) nuk i kemi hedhur ende armët tona kështu përgatitu për Beni Kurejdha". I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka urdhëruar sahabet e tij për t'u nisur për luftë dhe ka thënë: "Askush nga ju nuk duhet ta falë ikindinë përveçse në Beni Kurejdha". [Sahih Buhari dhe Sahih Muslim]

Sahabet e kuptuan këtë urdhër në mënyra të ndryshme. Disa menduan që qëllimi i të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte që ata të nxitonin kështu që kur koha e ikindisë të vinte ata të ishin në Beni Kurejdha. Rrjedhimisht kur koha e ikindisë erdhi ata ishin ende në rrugë dhe ata u fallën e nuk e vonuan ate (ikindinë) nga koha e saj. Sahabet e tjerë e kuptuan urdhërin e të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se ata nuk duhet të faleshin derisa të arrinin Beni Kurejdhan dhe ata u fallën pas kohës së saj (kohës së parë të nama-

zit). Kur i Dërguari i Allahut u informua rreth kësaj ai nuk akuzoi asnjërin palë nga ata!

Kështu mosmarrëveshjet vetvetiu nuk janë të këqija por urrejtja dhe keqdashja midis njerëzve kundër personit/grupit që mban një pikëpamje të ndryshme është e keqe. Dhe çfarë është edhe më e rrezikshme është kokëfortësia që edhe kur pasi dalin në shesh gabimet e nuk pranohet e vërteta!

g) Referimi tek Kur'ani dhe Sunneti kur ndodh mosmarrëveshja

Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, e zgjidhi mosmarrëveshjen midis sahabeve, radijallahu anhum, duke iu referuar urdhërat të të Dërguarit të Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Ai provoi me sjelljen e tij që pa marrë parasysh vështirësinë e situatës urdhërat e Allahut duhet të kryhen. Ai i refuzoi të gjitha mendimet e sahabeve, radijallahu anhum, për të tërhequr ushtrinë ose ate për të zëvendësuar Usamen, duke thënë: "... Unë nuk do të zbrapsem në asnjë mënyrë nga ajo të cilën Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, na ka udhëruar të bëjmë për të vazhduar". Me këtë qëndrim Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, vendosi në praktikë urdhërat e Allahut, subhanehu ve teala: "O ju që besuat, bindjuni All-llahut, respektoni të Dërguarin dhe përgjegjësit nga ju. Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë të All-llahu (te libri i Tij) dhe te i Dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë". [en-Nisa: 4: 59]

Ngjajshëm me këte, kurdo që një mosmarrëveshje dilte midis selefus salihin, (të parët tanë të mirë) ata i referoheshin Kur'anit dhe Sunnetit. Është shënuar në Sahih el-Buhari që kur halifeja, Omer Ibën Hattab, radijallahu anhu, ishte duke udhëtuar drejt Shamit në rrugë ai ishte informuar që një së-

mundje kishte dalë në Sham. Kështu ai u ndal dhe kërkoi këshillën e sahabeve. Ai u këshillua me të dyja palët; muhaxhirinët dhe ensarët dhe ata ndryshonin në mendime për çështjen, gjë e cila rezultoi në dy opinione; kurse ai korrekt ishte që ata nuk duhet të udhëtonin drejt Shamit por të ktheheshin në Medine. Gjatë këtij diskutimi AbdurRahman bin Avf, radijallahu anhu, i cili nuk kishte qenë fillimisht prezent, erdhi dhe tha: "Unë kam ardhur me disa lajme mbi këtë çështje. Unë kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, të thotë: "Nëse ju dëgjoni për të (sëmundje) që ndodhet në një vend mos shkoni atje dhe nëse ajo del në atë vend në të cilin jeni ju, mos u largoni prej tij". Kështu ata të gjithë u kthyen prapa.

h) Nënshtrimi i të vërtetës kur ajo zbulohet

Mosmarrëveshja zuri vend ndërmjet sahabeve përsa i përket ushtrisë së Usames, radijallahu anhu, por së shpejti u zgjidh kur Ebu Bekri u bëri të qartë atyre që i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka udhëruar që ushtria të shkonte të luftonte romakët dhe që asnjë person nuk kishte të drejtë të ndryshonte urdhërat e të Dërguarit të Allahut. Pas kësaj nuk kishte asnjë që nuk ra dakord me Halifen dhe të gjithë aprovuan vendimin e tij sepse ata e kishin të njohur mirë që: "Kur All-llahu ka vendosur për një çështje, ose i Dërguari i Tij, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në atë çështje të tyre personale të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton All-llahun dhe të Dërguarin e Tij, ai është larguar shumë larg së vërtetës". [el-Ahzab: 33: 36]

i) Maxhoranca që kundërshton urdhërat e Allahut dhe të Dërguarin e Tij nuk ka asnjë rëndësi apo autoritet

"Mos iu frikëso rrugës së vërtetë nga mungesa e njerëzve që ecin në të"

Herëherë njerëzit përpiqen të provojnë qëndrimin e tyre duke prezantuar "maxhorancën" (shumicën) si provë për ate që ata janë në të vërtetën. Megjithatë në islam maxhoranca nuk është asnjë kriter. Kur Ebu Bekër es-Siddik, radijallahu anhu, deklaroi nisjen e ushtrisë së Usames, maxhoranca e sahabeve nuk ranë dakord me të. Dhe ata të cilët nuk ranë dakord me Ebu Bekër es-Siddik nuk ishin njerëz të zakonshëm, ata ishin Ensarët, për të cilët i Dërguari i Allahut ka thënë: "Nëse njerëzit do të merrnin rrugën e tyre përmes një luginë dhe ensarët do të merrnin një rrugë nëpër shtegun e një mali unë do të merrja shtegun e malit të ensarëve". [Sahih el-Buhari] dhe në një transmetim tjetër ai, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka deklaruar se dashuria ndaj ensarëve është një shenjë e Imanit, ka thënë: "Askush nuk i do ensarët përveçse se të jetë një besimtarë dhe askush nuk i urren ata veçse (është) një munafik (hipokrit). Allahu do ta Dojë atë që do ata dhe do ta Urrejë atë që do t'i urrejnë ata". [Sahih el-Buhari]

Por opinioni i ensarëve, statusi i tyre i lartë dhe maxhoranca e tyre nuk ishin autoritet ngase (ky opinion) ishte kundër urdhërave të Dërguarit të Allahut.

Maxhoranca pra nuk ka rëndësi. Kjo gjithashtu dëshmohet edhe nga koha e vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem; kur maxhoranca e sahabeve, ndërmyjet tyre edhe Omer Ibën Hattab, radijallahu anhu, ishin të mendimit që Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk vdiste dhe pjesa tjetër që besuan se ai kishte vdekur, mes tyre edhe Ebu Bekër es-Siddik.

Omeri, radijallahu anhu, duke dëgjuar lajmet e vdekjes së Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nxori shpatën dhe tha: "... I

Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nuk ka vdekur por ai shkoi tek Zoti i Tij në të njëjtën mënyrë siç Isa ka shkuar... Ai do të kthehet dhe do t'ia presë duart dhe këmbët e atyre të cilët thonë se ai ka vdekur".

Ebu Bekri shkoi direkt tek i Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, zbuloi fytyrën e tij, u përkul dhe e puti atë dhe qau. Pastaj ai tha: "Flijovsha babë e nënë për ty. Allahu me të vërtetë nuk do bëjë të vdesësh dy herë. Ti ke vuajtur vdekjen që Allahu ka urdhëruar". Ai pastaj erdhi jashtë dhe i deklaroi njerëzve: "Ai i cili adhuron Muhammedin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, (ta dijë se) Muhammedi ka vdekur tani. Por ai që adhuron Allahun, Ai është i Përrjetshëm dhe Ai kurrrë nuk vdes". Allahu thotë: "Muhammedi nuk është tjetër vetëm se i dërguar. Edhe përpara tij pati të dërguar (që vdiqën ose u vranë). E nëse ai vdes ose mbytet, a do të ktheheshit ju prapa (nga feja ose lufta)? E kushdo që kthehet prapa, ai nuk i bën dëm All-llahut aspak, All-llahu do t'i shpërblejë mirënjohësit". [Ali Imran: 144]

Omer Ibën Hattab, radijallahu anhu, ka thënë: "Vallahi kur dëgjova Ebu Bekrin që thotë atë (ajet) unë u rrëzova përtokë. Unë ndjeva sikur këmbët e mia nuk mundeshin të më mbanin mua, u rrëzova kur dëgjova atë (Ebu Bekrin) ta thotë atë. Vetëm pastaj unë e kuptova që Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kishte vdekur me të vërtetë".

Kështu Ebu Bekër es-Siddik nuk pati konsideratë për pikëpamjen e maxhorancës (shumicës) por pranoi akiden e Kur'anit dhe Sunnetit.

Hafiz Ibën Haxheri ka shkruar si komentuar për këtë: "Kjo provon që një ixhtihad i minorancës (pakicës) mund të jetë i drejtë dhe që maxhoranca mund të jetë gabim. Gjithmonë nuk i jepet preçedencë". [Fath el-Bari]

Imam Nevevi ka thënë: "Nëse Sunneti është vendosur atëherë nuk duhet të lihet

edhe pse maxhoranca ose të gjithë njerëzit e kanë lënë atë". [Sherh en-Nevevi 8/56]

Ngjajshëm me këtë (pas vdekjes së Pejgamberit) është rasti kur një grup muslimanësh refuzuan të paguajnë zekatin halifes.

Ebu Bekër es-Siddik radijallahu anhu, i shpalli luftë atyre. Në këtë çështje gjithashtu maxhoranca e sahabeve nuk ranë dakord me të përta i përket të luftuarit e tyre dhe ata ishin gabim!

Shauana Abdul Aziz
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
4.6.2004

Obligimet e muslimanit ndaj jomuslimanit

Së pari, ai duhet ta thërrasë atë në rrugën e Allahut. Kjo arrihet duke ia sqaruar dhe duke ia bërë të qartë realitetin e islamit sipas aftësisë së tij dhe nëse ai ka dije për të bërë këtë (thirjen sh.r.). Kjo është vepra më e mirë dhe më e madhe që dikush mund të bëjë për bashkqytetarët dhe për ata me të cilët jetojnë bashkë, nga çifutët, të krishterët dhe jobesimtarët e tjerë.

Për këtë, Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ai i cili udhëzon për të mirë merr të njëjtin shpërblim që merr ai i cili e kryen (atë të mirë)" [Muslimi]

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu i ka treguar Aliut kur ai ishte duke duke e dërguar atë në Hajber për t'u takuar me çifutët, për t'i ftuar çifutët në islam. Ai i tha atij: "Vallahi, nëse Allahu udhëzon një person përmes teje është më e mirë për ty sesa llojet më të mira të deveve". [el-Buhari dhe Muslimi]

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë gjithashtu: "Kushdo që thërret për në udhëzim do të shpërblehet në të njëjtën mënyrë si do të shpërblehet ai i cili e ndjek atë, pa iu pakësuar aspak shpërblimi asnjërit prej tyre". [Muslimi, Ahmed, Ebu Davudi, en-Nesai, et-tirmidhi, Ibën Maxhe]

Thirrja e tyre në islam dhe sqarimi i fesë islame në mënyrë që ata të kuptojnë dhe të përqafojnë është një nga veprat më të rëndësishme dhe një nga mënyrat më të mira për t'iu afruar Allahut.

Së dyti, muslimani nuk duhet të dëmtojë personin tjetër përta i përket jetës së tij, pasurisë së tij dhe nderit të tij, nëse jo-muslimani është një qytetar i shtetit islam ose ka marrë besën e muslimanëve. Ai duhet të përmbush të drejtat e tjetrit. Ai nuk duhet të vjedh diçka nga pasuria e tij, ai nuk duhet të mashtrtojë dhe as të tradhëtojë. Ai nuk mundet të dëmtojë atë në trupin e tij duke e rrahur ose vvarë atë. Mbrojtja e tij nga shteti garanton sigurinë e tij për gjërat e tilla.

Së treti, nuk ka ndonjë ndalesë përta i përket shitblerjes, dhënies me qira ose marrjes me qira ose marrëdhënieve të ngjajshme të biznesit me ta. Është transmetuar me një rrugë autentike që Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka blerë gjëra nga mushrikët (politeistët). Ai gjithashtu ka blerë gjëra nga çifutët. Në fakt kur Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ndërroi jetë, mburoja e tij ishte e mbajtur si kaucion për

huanë që ai kishte marrë nga një çifut, për ushqim për familjen e tij.

Së katërti, nuk duhet që të parët ne ti përshëndetim ata me selam por megjithatë, duhet t'u përgjigjet përshendetjeve të tyre. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mos i jepni selam të parët çifutëve dhe të krishterëve". [Muslimi]

Ai gjithashtu ka thënë: "Nëse Ehli Kitabi (njerëzit e librit, çifutët dhe të krishterët) ju përshëndesin me selam atëhere thuajuni: "ve alejkum (juve gjithashtu)" [el-Buhari]

Pra një musliman nuk e përshëndet një jomusliman i pari me selam. Por kur një çifut, i krishter apo ndonjë jobesimtar tjetër e përshëndet atë ai duhet të përgjigjet: "Ve alejkum" siç Pejgamberi ka urdhëruar. Kjo është nga të drejtat e sjelljes ndërmjet një muslimani dhe një jobesimtari. Ai (muslimani) gjithashtu duhet të jetë i këndshëm më fqinjnin e tij jomusliman. Nëse fqinji i juaj është i mirë ndaj jush, ju nuk duhet ta dëmtoni atë dhe ju bile mund edhe t'i jepni lëmoshë nëse ai është i varfër ose t'i jepni dhuratë nëse ai është i pasur. Ju mundet gjithashtu ta këshilloni atë përse i përket asaj se çfarë është më e mirë për të. Të gjitha këto mund ta shpjen atë të mësojë më shumë për islamin dhe ndoshta edhe të bëhet musliman sepse fqinjët kanë të drejta shumë të mëdha. Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "meleku Xhibril ka vazhduar duke më porositur për fqinun deri sa unë mendova se

ai do ta trashëgonte (fqiu fqinun pas vdekjes, do ta bënte në rang të njëjtë me trashëgimtarët sh.r.)" [el-Buhari dhe Muslim]

Allahu ka thënë në Kur'an: "All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë". [el-Mumtehine 60:7]

Është shënuar në hadith autentik nga Esma bint Ebu Bekër që nëna e saj, e cila ishte një politeiste, e vizitoi atë dhe e pyeti për mbështetjen e saj, kjo ishte gjatë kohës së marrëveshjes së paqes ndërmjet Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, dhe jobesimtarëve kështu ajo shkoi tek Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, për ta pyetur atë rreth asaj dhe ai i ka thënë asaj për t'i mbajtur lidhjet e këndshme me atë dhe të jetë e drejtë ndaj saj.

Së pesti, muslimani nuk duhet të marrë pjesë me ata në festat e tyre. Megjithatë duhet të ngushëllohen kur dikush iu vdes nëse gjen ndonjë dobi të ligjshme në të vepruarit kështu. Ai mund t'i thotë atyre: "E ardhmja të dhëntë të mira" ose diçka të ngjajshme. Ai nuk duhet t'i thotë "Allahu e faltë atë" ose "Mëshira e Allahut qoftë mbi të" nëse personi i cili ka vdekur ishte një jobesimtar (shiko Kur'anin 9:113). Kjo është kështu ngase nuk duhet të bëhet dua ose lutje për një të vdekur jobesimtar por lejohet të kërkohet nga Allahu udhëzim për ata që janë gjallë dhe kështu me rradhë.

Shejh Abdul Aziz Ibën Baz
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
Redaktura: AlblIslam.Com
11.6.2004

Mirësevjen lule trendafili

Mirësevjen

Ti që je: namazlie, agjëruese, e devotshme dhe e pajisura me frikërespekt.

Ti që je: e ndershme, e matur, e mbuluar dhe dinjitoze.

Ti që je: e arsimuar, syhapur, vizionare dhe e udhëzuar.

Ti që je: besnike, e vërtetë, sadakadhënëse dhe mikeshë.

Ti që je: durimtare, që shpreson shpërblimin, penduese dhe që kthehesh te All-llahu,

Ti që je: përmendëse e All-llahut, falënderuese, thirrëse dhe e vetëdishme.

Ti që je: pasuese e Asijës, Merjemes dhe Hadixhes.

Ti që je: edukatore e trimave dhe nënë e burrave.

Ti që je: kultivuese e vlerave dhe kujdestare e idealeve.

Ti që je: xheloze për nëpërkëmbjen e kufinjve dhe larg të gjitha haramëve.

Po

Po ...buzëqeshjes tënde të bukur që nxit dashurinë dhe dërgon afërsi tjerëve.

Po ...fjalëve tuaja të mira që ngrisin shoqëri të ligjshme dhe eliminojnë urrejtjet.

Po ...sadakasë që e bën të lumtur një të ngratë, gëzon një të varfër dhe ngop një të urritur.

Po ...ndejës me Kur'an, duke lexuar, menduar rreth tij, duke zbatuar, përplot pendim dhe istigfar.

Po ...dhikrit dhe istigfarit të shumtë, mvarshmërisë nga dua ja dhe përmirësimit të pendimit.

Po ...edukimit të fëmijëve tuaj në fe, mësimit të sunnetit dhe udhëzimit drejt asaj që u bën dobi atyre.

Po ...nderit dhe mbulesës të cilën e ka urdhëruar All-llahu, që është rruga e mbrojtjes dhe ruajtjes.

Po ...shoqërimit me gra dhe vajza të mira që ia kanë frikë All-llahut, e duan fenë dhe i nderojnë vlerat.

Po ...bamirësisë ndaj prindërve, kujdesit ndaj farefisit, nderimit të komshisë dhe kujdesit për jetimin.

Po ...leximit të dobishëm, shfletimit përfitues, librit të këndshëm dhe udhëzues.

Jo...!

Jo... harxhimit të kohës në gjëra të pavlefshme, sikur që janë dëshira për hakmarje dhe debati i padobishëm.

Jo... dhënie përparësi grumbullimit të pasurisë para shëndetit, lumturisë, gjumit dhe rehatisë tënde.

Jo... përcelljes së gabimeve të të tjerëve, përgojimit të tyre dhe harrimit të të metave të vetes.

Jo... zhytjes në lezetet e epshit dhe dhënia e çdo gjëje që epshi kërkon dhe ia ka ëndja për te.

Jo ... humbjes së kohës me njerëz bosh dhe harxhimit të kohës në lozje.
 Jo ... mosdhënies rëndësi pastërtisë së trupit dhe shtëpisë, aromave të këndshme dhe rendit.
 Jo ... pijeve të ndaluara, duhanit, nargiles dhe çdo të keqeje.
 Jo ... kujtimit të ndonjë fatkeqësie që ka ikur, katastrofe që ka kaluar ose gabimit që ka ndodhur.
 Jo ... haresës së ahiretit dhe punës për te dhe neglizhencës së atyre pamjeve.
 Jo... harxhimit të pasurisë në hareme, israfit (teprimit) në gjëra të lejuara dhe mangësisë në adhurime.

Dhjet trandafila

- Kujto se Zoti yt ia fal atij që falje kërkon, ia pranon pendimin atij që pendohet dhe e pranon ate që te Ai kthehet.
- Mëshiroi të dobtit je e lumtur, jepju nevojtarëve shëndoshesh dhe mos bart mllaf je përplot me shëndet.
- Je optimiste sepse All-llahu është me ty, kurse melaqet kërkojnë falje për ty, e xhenneti të pret.
- Fshiji lotët me mendimin e mirë që ke për All-llahun, largoi brengat duke i kujtuar dhuntitë e All-llahut për ty.
- Mos mendo se dynjaja i është plotësuar dikujt, nuk ka në ruzullin tokësor kujt i është realizuar çdo kërkesë dhe është shpëtuar nga çdo pengesë.
- Bëhu pema e hurmës ambicioze, larg të këqijave, e nëse gjuhet me gurë, i jep frytet e veta.
- A ke dëgjuar ndonjëherë se mërzia i kthen gjërat e kaluara, ose se brenga e përmirëson gabimin, pse pra të mërzitemi dhe të brengosemi?!
- Mos prit sprovë dhe telashe, por siguri, paqë dhe shëndet, me leje të All-llahut.
- Fike zjarrin e urrejtjes nga gjoksi yt me falje të përgjithshme për secilin që ka gabuar ndaj teje.
- Larja, abdesti, parfymi, misvaku dhe rendi janë shërime të sukseshme për çdo të keqe dhe ngushtice.

Dhjet lule

- Ji sikur bleta, shkon në lule me aromë dhe pemë të freskëta.
- Nuk ke kohë për të zbuluar mangësitë e njerëzve dhe grumbullimin e gabimeve të tyre.
- Nëse All-llahu është me ty, nga kush frikohesh, e po qe All-llahu kundër teje, nga cili shpreson?!
- Zjarri i zilisë e han trupin, kurse xhelozia e tepruar është zjarr i rezikshëm.
- Nëse sot nuk je e përgaditur e nesërmeja nuk është pronë e ytja.
- Tërhiq e shëndoshë nga tubimet e lozjes dhe bisedave të kota.
- Me moralin tënd bëhu më e bukur se kopshti.
- Bëj mirë, sepse ti do të jesh njeriu më i lumtur me te.
- Lërja Krijuesit krijesat, ziliqarit vdekjen, armikut haresën.
- Lezetin e haramit e pason keqardhja, pendimi dhe dënimi.

Dr. Aid El-Karni
 Përktheu: Bekir Halimi
 21.5.2004

Për ndjekjen e epsheve

Epsheet, dëshirat e palejuara, zakonisht janë të shoqëruara me pakënaqësi. Ato lëjnë mbrapa një ndjenjë dhimbjeje dhe faji. Pra kurdo që ju ngacmoheni nga ato mendoni si ta lironi veten. Mendo rreth të gjitha atyre brejtjeve të ndërgjegjës që do ju shoqërojnë pas realizimit të asloj dëshirave dhe vendos!

Luftoi ashtu si din, me bindje. Kjo nuk është një detyrë e lehtë por megjithatë ajo është e shoqëruar me mirësi dhe balancim të kënaqësive.

Kushdo nga ju që ka ngarkuar veten (me epshe dhe dëshira të palejuara) le të men-

dojë për ate se sa e këndshme do të ishte sikur të pendohej dhe të lironte vetveten.

Mendo për pasojat që dëshirat e palejuara do të sillnin dhe përpiku të vendosish drejtë.

Dilema do të zvogëlohet duke përkujtuar ëmbëlsinë e kënaqësisë dhe lumturisë finale që bindja juaj do t'ua sjellë.

Gjithashtu mendo duke përfytyruar dënimin që do sjellë mosbindja ndaj Allahut.

Afërmendjes është që mendja juaj të përpiket për më shumë shpërblime dhe t'ju ndihmojë për të duruar dhimbjet e distancimit tuaj nga realizimi i dëshirave të tilla.

Imam Ibën Kajjim el-Xhevziije
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
28.5.2004

Ajo që shpreson shpërblimin prej Zotit...

Shpresa për shpërblimin prej Zotit është çelësi i lumturisë në jetën e muslimanes së dalluar. Ajo muslimane nuk kërkon shpërblimin nga njerëzit, andaj edhe nëse e lavdërojnë edhe nëse e qortojnë, kjo gjë te ajo nuk ndikon aspak...

"Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut dhe prej jush nuk kërkojmë ndonjë shpërblim e as falënderim. Ne i frikësohemi (dënimin të) Zotit tonë në një ditë që fytyrat i bën të zymta dhe është shumë e vështirë. Po All-llahu i ruajti ata prej sherrit të asaj dite dhe u dhuroi shkëlqim në fytyra e gëzim të madh". (El-Insan: 9- 11).

Qëllimi motra ime është nijeti të jetë i vërtetë dhe i sinqertë për hir të Fytyrës së All-

llahut, xhel-le shanuhu, dhe vepra të jetë e saktë në përputhje me sunnetin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Kjo është gjuha e besimtarëve në veprat e tyre, ata nuk kërkojnë asgjë nga kjo botë, mirëpo sërish u vjen dynjaja para tyre:

"Kërkuam punën për dynja, mirëpo All-llahu e bëri patjetër që ajo të jetë për Te".

Ajo që shpreson shpërblimin...nuk mllëfoset nga kritika, nuk ndikon te ajo zilia, nuk ia humb veprën as kurtha, as dinakëria, e as syfaqësia.

Ajo që shpreson shpërblimin...duron në zbatimin e urdhërave të Zotit të saj, kurse sipas veprës është edhe shpërblimi:

"...ndërsa durimtarëve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!". (Ez-Zumer: 10).

Ajo që shpreson shpërblimin... nuk e dëshiron këtë dynja, nuk dëshiron pozitën e këshilldhënësit, as liderllëkun, as pasurinë, as autoritetin, as detyrën, as veturën, por dëshiron xhennetin, gjërësia e të cilit është sa qiejtë dhe toka:

"... dëshirojnë (sinqerisht) Fytyrën e Tij". (El-Enam: 52).

Ajo që shpreson shpërblimin... ka tjetër shije të humanizmit, ka tjetër ngjyrë të njerëzimit, shkrihet për të tjerët, nuk rezervon asgjë në këtë drejtim, sepse ambicja e saj është

shumë më e lartë, më e ëmbël, më e shtrenjtë se sa këto të mira kalimtare të kësaj bote.

Ajo që shpreson shpërblimin... i ka tejkalar shoqet e saja, konkrueset e saja nuk mund t'ia kalojnë, ato që mbeten pas lodhen në këtë.

Lodhja e saj është kënaqësi, djersa e saj është misk, pasuria e saj është vakëf, kurse vetveteja kurban:

"E, cilën të mirë të Zotit tuaj po e mohoni (ju o njerëz dhe ju o xhinë)?" (Er-Rahman: 13).

Pse nuk marrim çelësin e pritjes së shpërblimit nga Zoti e të jetojmë në kënaqësinë e të qenurit i dalluar?

Muhamed Serar El-Jami

Përktheu: B. H.

4.6.2004

Kujtimet e gruas së Halifes

Kur vdiq Omer Ibën Abdul Azizi disa njerëz të ditur shkuan tek gruaja e tij për të shprehur ngushëllimet dhe treguar se sa fatkeqësi e madhe ishte për muslimanët vdekja e tij. Dhe ata i kanë thënë asaj: "Na trego për të sepse ai i cili e njeh më mirë një burrë është gruaja e tij".

Dhe ajo tha: "Me të vërtetë ai nuk falej apo agjëronte më shumë sesa ju, por unë kurrë nuk kam parë një rob të Allahut që ti frikësohej Atij më shumë se Omeri. Ai ishte i devotshëm me trupin e tij dhe me sjelljen e tij ndaj njerëzve. Gjithë ditën ulej e priste njerëz që vinin për problemet e tyre dhe kur nata vinte ai ulej ndërsa vazhdonte të punonte. Një natë kur ai i mbaroi të gjitha që pat, ai kërkoi llampën e tij për të cilën ai bliente vajin nga paratë e tij dhe fali dy re-qatë. Pastaj ai qëndroi me këmbëkryqë,

duke mbajtur mjekrrën me dorën e tij dhe lotët filluan ti rridhnin dhe kjo gjë nuk pushoi deri në agim kur ai u ngrit për të agjëruar.

Unë i thash: "O i pari i muslimanëve a pat ndonjë gjë që të shqetësoj ty gjatë kësaj nate? Dhe ai më tha: "Po, Unë pashë sesi unë isha i zënë ndërsa qeverisja punët e ummetit, të gjitha delet; ato të zeza dhe të bardha, dhe mu kujtuan të huajt, lypësit, nevojtarët, të varfërit dhe të burgosurit dhe të gjithë ata që gjinden në vende të largëta dhe unë kuptova që Allahu, subhanehu ve teala, do të më pyes mua për gjithë ata dhe Muhammedi, alejhis-selam, do të dëshmojë për ta dhe unë u frikësova që unë do ta gjeja veten pa asnjë arsytim kur unë do ta isha para Allahut (në ditën e gjykimit) dhe pa shefaat nga Muhammedi, alejhis-selam."

Dhe bile kur Omeri ishte me mua në shtrat, ku një burrë zakonisht gjen kënaqësi me gruan e tij, nëse ai kujtonte disa halle të njerëzve, ai do shqetësohej si një zog kur bie në ujë. Atëherë të qajturit e tij rritej, sa

që unë ia hidhja çarçafin me këndshmëri drejt tij. Vallahi ai tha "Sa do të kisha dashur që të kishte midis meje dhe kësaj zyre një distancë nga lindje në perëndim!"

Imam Ebu Jusuf

Marrë nga: el-Haraxh Ebu Jusuf (v. 182/798)

Përktheu nga anglishtja: Ammar Ardit Kraja

11.6.2004

Roli i gruas në arkitekturë

Që nga ditët e para të Islamit, gratë muslimane kanë krijuar disajne të mrrekullueshme të brendisë dhe të pamjeve të jashtme që ishin unike për shoqërinë dhe kulturën Islame.

"Siç u janë dhënë meshkujve aftësitë dhe mjeshtëritë natyrore që kanë ndikuar në rolet dhe kontributet e tyre, njëjtë edhe femrave u janë dhënë aftësitë dhe mjeshtëritë përshtatëse", ka thënë zonja Afaf Badran, arkitekte dhe konsultatne e disajnit të brendshëm në Arabinë Saudite, për 19 vjet. Ajo thotë se shumica e femrave janë vëzhguese, të vetëdëshme për detajet, posedojnë imagjinatë dhe shprehin brengë për nevojat, sigurinë dhe shëndetin e familjeve të tyre.

Këto cilësi, përveç origjinalitetit, kreativitetit dhe njohuria për të bukurën dhe ambientin që kënaq shqisat, i bëjnë shumë femra disajnuese të talentuara. Badran ka qenë e inkuadruar në programe arsimore që kanë pasur për qëllim të nxisin dhe promovojnë kreativitetin tek femrat dhe promovojnë talentet dhe aftësitë e tyre në zhvillimin dhe përforsimin e ambientit të tyre.

Përveç ligjeratave rreth arkitekturës së brendshme para studentëve të tyre, Badran ligje-

ron poashtu edhe për artin dhe arkitekturën Islame në forma të ndryshme, duke u fokusuar në shprehjen e të bukurës, vlerave dhe etikës.

Esenca e arkitekturës shtëpiake muslimane është privacia: mbajtja e familjes dhe grave të sigurtë në botën e tyre private, larg dhomave publike të shtëpisë dhe syve publikë.

Fasadat e jashtme të shtëpive ishin të disajnuara tradicionalisht me një numër të vogël të dritareve të vendosura në pjesën e epërme të katit. Dritaret janë vendosur thellë në muret e trasha ose janë mbuluar nga jashtë me mbulesa të ndryshme druri. Përderisa këto mbulesa kanë ndihmuar në mbrojtjen e brendive nga nxehti, funksioni i tyre primar ka qenë mirëmbajtja e privacisë të banorëve ndërsa në të njëjtën kohë lejimi i depërtimit të dritës dhe ajrit natyror.

Burrat dhe gratë tradicionalisht kanë pasur pjesë të ndara për musafirët e tyre, por kuptohet kanë ndarë dhomat e njëjta familjare. Mikpritja dhe zemërgjërësia e muslimanëve është reflektuar në dhomat e mëdha të ditës në të cilat ka pasur poashtu një pjesë për musafirët.

Shtëpitë janë ndërtuara rreth një oborri të brendshëm, të mbrojtur nga rruga me mur solid ose vegjetacion të lartë. Shtëpitë është dashur të duken të thjeshta nga jashtë por të rrespektuara.

As madhështia e as ekstravaganca nuk janë theksuar në pjesët e jashtme ndërsa komfori dhe bukuri kanë mbushur brendinë.

”Arti musliman është shumë i ngjashëm për nga shpirti anë e mbanë botës muslimane, por është edhe i mrrekullueshëm për nga vlera estetike dhe thirrjes sublime për bukuri dhe paqë. Kjo është lloj-llojshmëria brenda unitetit”, ka thënë Badran.

Sot në botën muslimane, ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i arkitekteve dhe disejnueseve.

Badran ka qenë arkitekthe praktikuese për 20 vjet, ndërsa 19 prej tyre në Mbretëri. Gjatë udhëtimeve dhe punës së saj, ajo ka njoftuar arkitekthe nga Maroko, Egjipti, Jemëni, Iraku, Jordani, Siria, Irani, Pakistani, Indonezia dhe Arabia Saudite.

“Paradokohe jam njoftuar me dy disejnuese profesionale saudite të cilat kanë praktikuar 15 vjet e më shumë”.

Kontributet e grave dhe dallimet e tyre nga burrat shihen në qasjen e tyre ndaj hapësirës, ndërtesave dhe mobilie. Sipas Badranit, arkitektet, planifikueset dhe disejnueset mund të jenë më të kuptueshme dhe më të vetëdijshme për nevojat e dizajnit për daljet urgjente – për shembull, shkallët dhe

shërbyeset për gratë shtatëzëna, fëmijët dhe pleqët.

“Shumë arkitektë (meshkuj) kanë tendencë të disejnojnë një ndërtesë si monument dhe pastaj të punojnë për përshtatje të brendisë. Nga ana tjetër, disejnueset (femra) anojnë nga disejnimi prej brenda jashtë”.

Madje edhe në shkretirë, gratë beduine në mënyrë aktive kanë kontribuar në krijimin e arkitekturës së butë dhe të thjeshtë. Sipas Badran, në Jemen dhe Asir në pjesën jugore të Arabisë Saudite, gratë kontribuojnë në ndërtim, në rregullim dhe lyerje të shtëpive të tyre.

Nëpër fshatrat egjiptiane, gratë ndihmojnë në ndërtim dhe aktualisht në formimin, organizimin dhe dekorimin, madje edhe mirëmbajtjen e shtëpive të tyre.

Në vendbanimet përdhese ose zhvillimet joformale që paraqiten pas fatkeqësive natyrore, luftërave ose për shkaqe tjera shoqërore-ekonomike, efektiviteti i këtyre zhvillimeve është i bazuar në rolin thelbësor të gruas.

“Për fat të keq, roli dhe kontributet e gruas shumë rrallë janë dokumentuar”, ka thënë Badran. Madje edhe në shtetet perëndimore, roli i gruas si arkitekt nuk publikohet shumë shpesh, thekson ajo.

Arkitektura dhe dizajni janë profesione që kërkojnë një përcaktim kohë-plotë dhe gratë arkitekthe janë ballafaquar me sfidën e zgjedhjes ndërmjet një profesioni të ngjeshur dhe dedikimit ndaj familjeve të tyre, ose edhe përpjekjeve për t’i balancuar të dyja.

Maha Akeel
Marrë nga: Arab News

Et-Tebrizi

Quket Velijjuddin Ebu Abdil-lah Muhammed ibën Abdil-lah El Hatib El Umeri Et Tebrizi autori i librit Mishkatul Mesabih dhe një nga dijetarët e shekullit të tetë hixhrij.

Sot ne për këtë autor nuk kemi informata të hollësishme për detajet e jetës së tij përpos lavdatave me të cilët përmendet nga bashkëkohorët e tij.

Nuk dihet saktësisht viti në të cilin ka lindur e as viti në të cilin ka ndërruar jetë. Ajo që me siguri dihet është se ka jetuar pas vitit 737 H. sepse në të ka përfunduar përpilimin e librit Mishkatul Mesabih të cilin gjatë jetës së tij e ka komentuar Muhammed Et Tibi.

Muhamme Et Tibi një nga bashkëkohorët e tij kështu e përshkruan: "Nga pakica e evlijave që kanë mbetur ..."

Mul-la Ali El Kari thotë: "Zotëriu ynë, mjeshtri i penës, al-lameja dhe deti i kuptimit. Shfaqës i të vërtetave dhe sqarues i hollësive. Dijetari i devotshëm, zemërbardhë."

Veprat që i ka shkruar janë argument i mjaftueshëm për dijen e gjërë që e posedonte dhe për vendin e lart që e ze në mesin e dijetarëve.

Nga veprimtaria e tij kanë mbetur vetëm dy libra që janë botuar ato janë:

1. Mishkatul Mesabih- në këtë libër ai i tuboi hadithet e librave vijuese:

Sahihul Buhari, Sahih Muslim, Muvet-ta Malik, El Umm e Imam Shafi'iut, Musnedi i Ahmedit, Suneni i Tirmidhiut, Suneni i Ebu Davudit, Suneni i Nesaiut, Suneni i Ibën Maxhes, Suneni i Darimiut, Suneni i Darekutniut, Suneni i Bejha-

kiut dhe Et Texhid li Sihah Es Sitte i Rezinit.

Gjatë përpilimit të këtij libri autori i tij u mbështet në librin "Mesabihu Sunne" të autorit El Begavi të cilin e konsideroi libër më përfshirës në këtë lëmi i cili në një vend i ka tubuar hadithet e shpërndarë nëpër librat e ndryshme. Duke e patur parasysh mangësitë që Begaviu i ka bërë gjatë përmendjes së burimeve të hadithit përkatës Et Tebrizi e përpunoi këtë libër duke i plotësuar mangësitë në gjurmimin e haditheve tek librat e tyre dhe e vendosi çdo hadith në kaptinën përkatëse. Librin e ndau në Libra dhe Kapituj sipas klasifikimit të fukahave, librat i ndau në kapituj dhe kapitujt në shumicën e rasteve i ndau në tre seksione.

Seksioni i parë: në të cilin i tuboi hadithet e transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi ose nga njëri prej tyre. Në shumicën e rasteve nuk ka përmendur hadithet e transmetuar nga imamët e tjerë duke e vurë në konsideratë vendin e lartë të këtyre dy imamëve.

Seksioni i dytë: në të cilin i tuboi hadithet e transmetuar nga imamë tjerë.

Seksioni i tretë: në të cilin i tuboi hadithet shtojcë, të përshtashme për kapitullin në fjalë. Gjatë përmendjes së haditheve tregonte transmetuesin e tij nga as'habët dhe tabi'inët dhe cili prej imamëve e ka përmendur dhe titujt e librave ku është transmetuar hadithi.

2. El Ikmal fi Esmair Rixhal

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjërë.

Talha Kurtishi
21.5.2004

Imam es San'ani

Ai është Emiri, Imami i madh dhe Muxhtehidi, dijetari i Jemenit dhe autori i veprave të dobishme, Muhammed ibën Isma'il ibën Salah ibën Muhammed ibën Ali El Kehlan Es San'ani.

Ka lindur natën e xhumasë me 15 Xhumadel Ahire të vitit 1099 H në fshatin El Kehlan në të cilin kaloi fëmijërinë e hershme. Kur i mbushi tetë vjet me prindërin e tij u shpërngul në qytetin e San'asë ku e filloi udhëtimin e tij në kërkim të diturisë.

Mësuesit e parë prej të cilët përfitoi dije ishin Zejd ibën Muhammed ibën El Hasen, Salah ibën El Husejn El Ahfesh, Abdull-llah ibën Ali El Vezir dhe Muhammed El Ansi.

Duke pasuar traditën e dijetarëve të hershëm udhëtoi në Mekke dhe Medine, përfitoi nga dijetarët e Hixhazit, tregoi shkathtësinë e tij dhe u bë nxënësi më i dalluar. Pas kthimit në San'a bëhet dijetari më njohur i saj i cili thirrte në ixhtihad dhe ndalonte pasimin e verbër duke shpalosur pasojat negative të taklidit. Ky qëndrim i tij i shkaktoi sprova nga ithtarët e taklidit. Me nxitje prej mukal-lidëve disa herë jeta e tij u rrezikua nga turma. Në kohën e Imam El Mensur Bil-lahi u caktua në postin e hatibit në xhaminë e San'asë dhe mbeti në këtë post edhe në kohën e Imam Mehdiut.

Nga ky det i dijës përfituan shumë tjerë. Gjurma më e rëndësishme që Es San'ani e la pas vete ishte rikthimi ixhtihadit dhe hedhja poshtë e taklidit. Në tubimin e tij prezentonin edhe burrashteti siç ishte fekihi dhe ministri Ahmed ibën Ali En Nehmi dhe emiri El-mas El Mehdi. Në tubimet e tij nxënësit lexonin libra të hadithit dhe nuk përkufizoheshin me libër të ndonjë medhhebit.

Nga nxënësit e tij më të dalluar ishin djemtë e tij Ibrahim, Abdull-llahi dhe El Kasimi si dhe El Hasen ibën Is'hak ibën El Mehdi, Isma'il ibën Muhammed ibën Is'hak ibën El Mehdi, Abdull-Kadir ibën Ahmed, Ahmed ibën Muhammed Katin, Ahmed ibën Salih ibën Ebi Rixhal dhe të tjerë.

Veprat e tij:

Librat e tij, All-llahu e mëshiroftë, ishin të dobishme, plot dituri që dëshmon për gjërsinë e saj. Sipas të gjitha kriterëve ai me të drejtë mund të konsiderohet një nga imamët ripërtëries të fesë (muxheddid) siç thotë dhe Imam Esh Sheukani.

Nga librat që i shkroi do t'i përmendim;

- Subulu Selam (komentimi i haditheve të librit Bulugul Meram të autorit Ibën Haxher El Askalani)

- El Udde sherhu El Umde li Ibën Dekik El 'Id
- Et Tenvir fi sherhi El Xhami' Es Sagir (komentimi i haditheve të librit El Xhami' Es Sagir)

- Tevdih El Efkar li me'ani Tenkih El Endhar

- Et Tehbir fi sherhi Tejsiril vusul ila Xhami'il Usul

- Xhem'u Teshtit fi sherhi dhejl Ebjatit Tethbit

- Kasbu Suker fi nedhmi Nuhbetil Fiker

- Isbalul Matar fi sherh Nuhbetil Fiker

- Fet'hul Halik sherh mexhme'il Hakaik ver Rekaik

- Er Reudu EnNedir minel Hutab

- Tet'hirul l'tikad an derenil Ilhad

- Nusretul Me'bud fi Reddi ala Ehli Vahdetil Vuxhud

- Es Sehmu Es Saib fi nehri El Kaulil Kadhib

- Mendhumetu Bulugil Meram min Edil-heti Ahkam

Jeta e tij në këtë botë përfundoi ditën e martë në ditën e tretë të muajit Sha'ban në vitin 1182 dhe u varros në qytetin e San'asë. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Fevvaz ibën Ahmed Ez Zemrli

Përktheu dhe përshtati: Talha Kurtishi

28.5.2004

El-Kadi el-Fadil

Midis atyre të cilët ripërtëritën sunnetin në Sham dhe Egjypt ishte një njeri që kishte rol kryesor në mbështetjen e planeve të Salahudinit për të bashkuar rajonin i cili ishte duke luftuar kryqtarët. Kjo përvojë e tij vinte nga zyra e qeverisë dhe e administratës në Kairo. Ai ishte një imam Palestinez nga qyteti i Askalanit dhe i përkiste një familjeje me dije fetare. Emri i tij ishte Abdur-Rahim el-Beisani, i njohur si El-Kadi el-Fadil ose "Gjykatësi i famshëm".

Abdur-Rahim ka lindur në Askalan në vitin 526 hixhri. Kryqtarët vazhdimisht e kanë sulmuar qytetin e Askalanit, nga toka dhe deti. Në 543 hixhri babai i tij e dërgoi atë në Kairo për të marrë mësim në administrime si dhe studime fetare. Abdur-Rahimi ka punuar në kabinetin e korespondencës dhe ishte shumë i suksesshëm në punën e tij. Egjypti gjatë atyre viteve 558 dhe 564 hixhri ishte i trazuar nga jostabiliteti politik. Kishte komplete gjithandej ndërmjet ministrave dhe qeveritarëve dhe midis vetë ministrave. Ata ndonjëherë mirrin mbështetje edhe nga kryqtarët duke iu frikësuar asaj se shteti mund të merrej nga Nurudini në Damask. Kishte shumë luftime të brendshme. Për shkak se qeveria kërkoi mbështetje nga kryqtarët, Mbreti Ammuri vendosi taksa të larta të cilat e lodhën financiarisht Egjyptin.

Abdur-Rahimi ka jetuar në këtë ambient të korruptuar politik dhe midis këtyre komplotëve kundër fesë dhe Ummetit. Ai u takua me ushtritë e Shamit të udhëhequra nga Asadudin Shirakoa, xhaxhai i Salahudinit. Abdur-Rahimi ishte shumë i kënaqur me pozicionin në Damask, pika kryesore e jetës së tij. Ai më vonë u bë këshilltar politik dhe administrativ i Salahudinit pasi ky i fundit më vonë mori pozicionin e ministrit pas xhaxhait

të tij Asadudin. Hapi i parë i tij në fushën e xhihadit ishte asgjësimi i shtetit Fatimid me ndihmën e el-Kadi el-Fadil. Atëhere Salahudini zyrtarisht lajmëroi besnikërinë e tij ndaj hilafetit Abasid me qendër në Bagdad.

Në një letër dërguar halifes el-Kadi el-Fadil ka shkruar: "Ne do të luftojmë të dy armiqtë, ata të brendshmit dhe të jashtmit. Ne gjithashtu do të durojmë vuajtjet nga të dy të këqijat, hipokritët dhe jobesimtarët. Ne do të veprojmë kështu derisa Allahu të sjelli caktimin e Tij dhe të vendosi fitoren e Tij mbi ne". Armiku i fshehtë (i mbrendshëm) ishin liderët Fatimid në Egjypt dhe armiku i hapët ishin kryqtarët. Në një tjetër letër drejtuar halifes ai shkroi: "Feja u bë një pasi kishte shumë besime. Falja e xhumasë tani është e vendosur". Shqetësimi për bashkimin islam ishte gjithashtu i pranishëm tek el-Kadi el-Fadil. Hapi i dytë pas vdekjes së Nurudin Mahmudit ishte bashkimi i Shamit dhe Egjyptit. El-Kadi el-Fadil dërgoi letra liderëve në Damask duke i thirrur ata që të bashkohen në luftën për bashkim.

El-Kadi nuk ishte vetëm një zyrtarë politik dhe ministër ai e dinte që fuqia e shtetit ishte në drejtësi dhe dituri. Ai e këshilloi Salahudin që të mbante kontakte me popullin dhe që të përpqej për të zgjidhë problemet e njerëzve. Ai i thoshte atij: "Lideri ynë! Heqja e brengave nga njerëzit dhe largimi i padrejtësisë janë veprat më të rëndësishme në bindjen ndaj Allahut". Pasi këta hapa dolën me sukses, doli në shesh nevoja për thirrje në xhihad për të çliruar vendet kyçe, veçanërisht qytetin e Kudsit (Jerusalem). El-Kadi el-Fadil vetë e mbikëqyri përgatitjen e ushtrive (ajo çfarë sot quhet logjistikë) dhe luftimi i armikut u bë i vetmi shqetësim i tij. Ai

këshilloi Salahudinin të mos shqetësohej me marrjen e qytetit të Mosulit por të përqëndrohej në dhënien fund të pushtimit të kryqtarëve. Salahudini u sëmur para se të rrethohej Mosuli. El-Kadi i ka thënë atij: "Ti nuk duhet të luftosh asnjë musliman përderisa Allahu të mos të shërojë. Ti tani duhesh ta drejtosh vëmendjen kah luftimi i kryqtarëve".

Salahudini e dinte rëndësinë e opinionit të el-Kadit. Ai e dinte që El-Kadi kishte njohuri në strategjitë që do të shpënin në fitore. Kështu ai këshillohej me el-Kadin për çdo çështje, të vogël e të madhe. Si rezultat i kësaj miqësie të ngushtë midis udhëheqjes ushtarake, administrative dhe fetare ringjallja sunnite dhe bashkimi i Shamit dhe Egjiptit ishte një nga fitoret më të mëdha të arritura. Këto fitore filluan me luftën e Hitinit në 583 hixhri. Salahudini zbriti nga kali i tij dhe ra në sexhde në shenjë mirënjohje ndaj Allahut.

Ai bërtiti nga gëzimi për fitoren. Kjo fitore u ndoq më pas nga fitoret në Akka dhe Asklan. Së fundi Kudsi iu kthye shtetit islam dhe kjo ishte një nga ditët e Allahut.

el-Kadi el-Fadil vazhdoi të përqëndrohej me xihadin dhe mori leksione nga fitoret fillestare. Kur Salahudini vendosi të shkonte në Mekë dhe të kryente haxhin, el-Kadi i shkroi atij: "Kryqtarët nuk e kanë lënë Shamini e as që kanë harruar Jeruzalemin. Atyre nuk duhet t'i besohet në marrëveshje paqëje". Ai pastaj e këshilloi që ta shtyj udhëtimin e tij për në haxh.

Për kundër të gjitha këtyre fitoreve Salahudini qëndroi i thjeshtë, i mbushur me këndshmëri. Ai ishte i mirënjohur ndaj të gjithë atyre të cilin kishin ndarë fitoret me të. Ai i thoshte shokëve të tij dhe liderëve "mos mendoni se unë i morra këto vende me ushtarë. Unë i morra ato me el-Kadi el-Fadil".

Muhammed el-Abdah
Marrë nga revista: el-Jumua'h
Përktheu: Ammar Ardit Kraja
4.6.2004

Imam Ebu Jusufi

El Imam El Kadi Ebu Jusufi, All-llahu e mëshiroftë, njëri prej nxënësve më të dalluar të Ebu Hanifës, muxhtehidi, fekihi, muhadithi. . .

Jetoi në kohën e artë të dijes në të cilën preokupimi kryesor ishte kërkimi i dijes së trashëguar prej të Dërguarit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Në kohën e Harun Er Rashidit u vendos në postin e kryegjykatësit.

Kontriboi shumë në ndërtimin dhe përhapjen e shkollës juridike hanefite.

Quket Ebu Jusuf Ja'kub ibën Ibrahim ibën Habib ibën Hubejsh ibën S'ad El Ensari El Kufi.

Në vitin 113 H All-llahu e bekoji familjen e Ebu Jusufit dhe në këtë familje të varfër lindi fëmiu me të cilin do të krenohen. Kërkimin e diturisë e filloi duke iu përkushtuar hadithit që më vonë të fillon të merr pjesë në hallkën e fikhut para Imam Ebu Hanifës.

Varfëria e familjës së tij u bë shkak që një kohë të largohet nga hallka për t'ua siguruar kafshatën e bukës për anëtarët e familjës së tij.

Kur për këtë gjë u njoftua Imam Ebu Hanifeja e thirri dhe i dha njëqind dirhem duke i thënë se kjo do të jetë ndihmë mujore për të

dhe familjen e tij. Për dashurinë e imamit ndaj nxënësit të tij dëshmon edhe transmetimi në të cilën thuhet se Imam Ebu Hanifeja për të ka bërë lutje pas çdo namazit

Ishte nxënësi më dalluar i Imam Ebu Hanifës dhe aftësitë e tij u vërtetuan edhe më vonë kur u bë trashëguesi i Imamit në shkollën juridike bazët e të cilës i vendosi Ebu Hanifeja.

Përpos nga Ebu Hanifeja ai përfitoi edhe nga imamët e tjerë siç ishin: Hisham ibën Urveja, Jahja ibën Se'id El Ensariu, El Ata ibën Saibi, Jezid ibën Ebi Zijadi, Sulejman El A'meshi, Muhammedi ibën Is'hak ibën Jesari etj.

Nga dija e tij përfituan shumë nxënës. Imam Ahmedi tek ai i mësoi gjërat e para nga lëmia e hadithit. Imam Muhammedi ishte nxënësi i tij. Nga nxësit e tij si më të dalluar do t'i përmendim; Jahja ibën Me'inin, Amër ibën Muhammed En Nakidin, Ahmed ibën Meni'in dhe Ali ibën Muslim Et Tusin.

Fjalët e dijetarëve për të:

Imam Ebu Hanifeja pasi që e vizitoi gjatë sëmundjes së tij tha: "Nëse vdes ky do të vdes më i dituri mbi tokë."

Imam Ahmedi thoshte: "I pari prej të cilët shënova hadithe ishte Ebu Jusufi. Ai më tepër se Ebu Hanifeja dhe Muhammed anonte kah hadithi."

Ibën Me'in: "Nga ithtarët e gjykimit të lirë (as-habur-re'j) nuk kam parë njëri më të sigurt në transmetimin e haditheve, kishte kujtesë të fortë dhe transmetimet e tij ishin të saktë."

Ai gjithashtu thoshte: "Ebu Jusufi është dijetar i hadithit, pauses i Sunnetit."

Hilalur Re'ji thoshte: "E dinte përmendësh tefsirin, megazi (historinë e luftërave të të Dërguarit), sal-lal-lahu alejhi ve sel-lem, historinë e arabëve. Fikhu ishte vetëm një pjesë e dijës së tij."

En Nesaiu: "Ebu Jusufi i besueshëm (eth-thikah)"

Dhehebiu thotë: "Me dijën e tij arriti postin më të lartë, Harun Er Rashidi e respektonte shumë."

Nga fjalët e tij të paharruara:

"Nuk do të falem pas atij që thotë se Kur'ani është i krijuar dhe nuk do të shpëton njeriu që i pëlqen diç nga apologjetika (e bazuar në filozofinë e grekëve)."

"Ai që me alkimi don të pasurohet do të mbetet i varfur, ai që fenë don ta mëson me filozofi do të bëhet zindik (do del prej fesë) dhe ai që kujdeset të transmeton hadithet e panjohura do të gënjen."

"Mosdija mbi mospajtimet dhe apologjetikës është dije kurse dija mbi mospajtimet dhe apologjetikën është injorancë."

Me këto fjalë ai ka për qëllim të na tregoj se rruga e vërtetë e dijës është dija e cila mbështetet në burimet e pastërta të Kura'nit dhe Sunnetit, ashtu siç e kanë kuptuar të parët tanë, dije që bashkon, dije që nuk njuh armiqësi mes muslimanëve, dije që garanton ngadhënjimin në këtë botë dhe në botën tjetër.

Pasi që ishte kryegjykatësi i shtetit në mënyrë të qartë dhe me edukatë folte për dobësitë e shtetit dhe mënyrën e përmirësimit. Si rezultat të kësaj halifeja kërkoi që ai të shkruan libër në të cilin do t'i paraqet zgjedhjet e përshtashme për ato probleme.

Për dijën e tij dëshmojnë edhe veprat e tij që i la pas vete siç janë:

- Libri "El Haraxh" të cilin e shkroi me kërkesë të Harun Er Rashidit dhe libër i cili konsiderohet bazë për regullimin praktik të çështjeve financiare në shtetin islam. Në hyrjen e librit ai jep këshilla të dobishme për sundimtarin dhe si duhet të kujdeset për shtetin dhe intereset e Ummetit.

- Er Reddu ala Sijer El Evza'i

- Ihtilafu Ebi Hanifete ve Ibën Ebi Lejla

- Kitabu Usulil fikh ala medhhebi Ebi Hanife dhe tjerë.

Me 5 Rebi'ul Evvel të vitit 182 H përfundoi jeta e tij në këtë botë. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Imam En-Nevevi

Dijetari me dije enciklopedike, i dalluari me devotshmëri dhe trimëri të pazakontë. Edhe pse jetoi vetëm dyzet e pesë vjet, pas vete la vepra që janë referenca kryesore në lëmitë e hadithit dhe fikhut.

Emri i plotë:

Quhet Ebu Zekerija, Muhjuddin, Jahja ibën Sheref ibën Murrij ibën Hasan ibën Hizam ibën Muhammed ibën Xhumu'a, El Hizami, El Harani, En Nevevi, Ed Dimeshki, Esh Shafi'i.

Lindi në fshatin Neva, krahina e Haranit brenda kufive të Sirisë së sotme në vitin 631 H/1233 G. Që nga fëmijëria e hershme anoi kah kërkimi i dijes. Prindërit e tij ishin mësuesit e parë prej të cilëve ai mësoi. Që si fëmijë e mësoi përmendsh Kur'anin. Para hoxhallarëve të ndryshëm dëgjonte ligjëratat dhe konsultohet me to. Duke iu përkushtuar tërësisht dijes ai nuk merrte pjesë në lojrat fëmijërore. Dijetari i njohur Jasin ibën Jusuf El Merakeshi tregon se si fëmijët e tjerë nuk shoqëroheshin me të për shkak të largimit prej lojrave të tyre, gjëra këto që Neveviu i konsideronte të padobishme.

Duke e parë këtë përkushtim të tij, prindërit e tij me këshillë të shejh El Marakeshit, e liruan nga obligimet në dyqan dhe ai tërësisht iu përkushtua kërkimit të diturisë.

Në moshën nëntëmbëdhjetë veçare shkoi në Damask ku para tij u hapën horizontet e reja dhe mundësia për të mësuar në një nga 300 shkollat që në atë kohë ekzistonin në Damask. Gjatë ditës merrte pjesë në dymbëdhjetë ligjëratat.

Mësuesit e tij:

Pas arritjes në Damask fillimisht mësoi tek Abdul Kafi ibën Abdul Melik dhe më vonë vazhdoi mësimet tek Abdur Rahman ibën Ibrahim.

Në medresenë Er Revahijje mësoi para shumë dijetarë të kohës së tij siç janë: Ibën Es Salah, Behauddin Es Subki, Velijuddin Es Subki, Kemal Ez Zemlekani, Shemsuddin El Makdisi.

Nga mësuesit e tjerë do të veçojmë: Is'hak ibën Ahmed El Magribiun, Abdur Rahman ibën Ahmed El Makdisiu, Ibrahim ibën Umer El Vasiti, Ebul Abbas El Misri, Isma'il ibën Ibrahim Et Tehuhi, Ebu Shame Ed Dimeshki etj.

Para mësuesit të tij ai lexoi këto vepra: Sahihët e Buhariut, Muslimit dhe Ebu Avanes, Sunenet e Ebu Davudit, Nesaiut, Tirmidhiut dhe Ibën Maxhes, Musnedet e Ahmedit, Shafi'ut, Darimiut dhe Ebu Ja'lasë dhe libra tjerë.

Nxënësit e tij:

Dija e tij dhe mënyra e interpretimit ishin tërheqëse për shumë nxënës që vinin prej vendeve të largëta që të mësojnë para Imam En Neveviut. Nga nxënësit e tij veçojmë: El Hatib Sadruddin Sulejman El Xha'feri, Shihabuddin Ahmed ibën Xh'van, Shihabuddin El Irbidi, Alaudin ibën El Attar etj.

Virtytet e Imam En Neveviut:

Për të arritur këtë sukses në jetën e tij shkencore Imam En Neveviu dallohet me disa vlera dhe virtyte që ia mundësuan këtë gjë.

Këmbëngulja.

Asnjëherë nuk kalonte kohën e tij pa përfutur. Kohën e lirë e shfrytëzonte për përsë-

ritje, shkrim, ligjërata, përgjigje ndaj pyetjeve, vizita...

Aftësitë intelektuale.

Këto aftësi i ndihmuan që të përfiton shumë dije dhe të mëson shumë gjëra përmendësh. Për këtë shkak Edh Dhehebiu e titulloi me titullin Hafidh i Hadithit i cili përpos haditheve njihje mirë terminologjinë e hadithit, transmetuesit e hadithit, mangësitë e fshehta të hadithit. Ishte fekih, i thelluar në shkencat e jurisprudencës islame.

Devotshmëria.

Dallohej me adhurimin e tij. Falej dhe agjëronte. Nuk pranonte dhuratat dhe ushqehet me ushqimin të cilin ia dërgonte i ati prej Nevasë. Nga agjërimi i shumtë u dobësua dhe lëkura e tij morri ngjyrë të gjelbërt.

Nuk hante as nuk pinte shumë duke u frikësuar se ngopja me ushqim do t'i shkakton gjumë dhe dëshirë për të fjetur.

Kur ishte në krye të medresesë El Eshrefijje nuk mirrte pagë për punën që e bënte. Në fund të vitit përdorte parat e kursyera për të blerë tokë dhe libra.

Trimëria.

Nuk frigohej ta thotë të vërtetën. Të njohur janë këshillat e tij para halifës pasi që ai kishte konfiskuar shumë tokë pas luftërave me Tatarët. Sunduesi i Damaskut thoshte: Unë po frigohem prej En Neveviut. Pasi që i këshilloi pushtetmbajtësit, ata kërkuan që të shkarkohet nga të gjitha postet shtetërore dhe t'i ndalet rroga. U befasuan kur e kuptuan se ai nuk ka post shtetërorë e as që merr rrogë për punën që e bën!

Veprat e tij:

Gjatë jetës së tij të shkurtër ai arriti të shkruan libra të shumta që edhe sot konsi-

derohen libra bazë në shumë lëmi. Më të njohurat janë:

1. El Minhaxh- komentimi i Sahih Muslimit, libër pa të cilën nuk mundet të paramendohet biblioteka e një nxënësi të dijes.

2. Rijadus salihin, përmbledhje e haditheve. (Version i shkurtuar i këtij libri është i përkthyer dhe i botuar në gjuhën shqipe)

3. Tehdhibul Esmā vel Lugat

4. Minhaxhut Talibin

5. El Edhkar

6. Revdatu Talibin

7. Et Tibjanu fi adabi hameletil Kur'an

8. El Mexhmu' sherhul Muhedhdheb (libër bazë nga fikhu i shkollës juridike Shafi'ite)

9. El Erbe'in En Nevevijje (ky libër është i përkthyer dhe i botuar në gjuhën shqipe me titull: Dyzet hadithet e Imam Neveviut)

10. El Fetava (libër që përmbledh fetvatë e tij)

11. El Irshad

12. Menakibu Esh Shafi'ij

13. Hulasatul Ahkam

14. Et Tekrib vet Tejsir (nga lëmia e Mustalahut, terminologjia e hadithit)

15. Ed Dekaik

16. El Mekasid

17. El Idah

18. Menarul Huda

19. Bustanul Arifin

20. Tas'hihu t Tenbih

Fundi i jetës:

Para se të ndërroj jetë kthehet në Neva pasi që viziton Kuds. Takon atin e tij dhe përshëndetet me të. Në këtë vend me 24 Rexheb të vitit 676 H/ 1277 G, përfundon jeta e tij në këtë botë. All-llahu e mëshiroftë Imam En Neveviun me mëshirën e tij të gjërë dhe e shpërblen për mundin që e dha në shërbim të Ummetit Islam. Amin.

Përgatiti: Talha Kurtishi

11.6.2004

Tema: Gruaja imam?

Numri: 1181 Data: 16.06.2004

Pyetje: A i lejohet gruas tu del imam grave?

Përgjigje: Po, i lejohet gruas tu del imam grave dhe të lexon me zë gjat namazit, nëse nuk e dëgjojnë burrat e huaj. Është sunnet që të qëndroj mes tyre dhe mos të del para tyre. Temime bin Selemeh ka thënë: "U doli Aisheja, radijall-llahu anha, grave imam në farzin e akshamit dhe qëndroi në mes tyre dhe lexoi me zë".

Jahja ibn Seidi thotë: "Aisheja i printe gratë në namazin vullnetar dhe qëndronte në mes".

Pra, transmetimi i parë flet për farzin, kurse i dyti për sunnetin.

Kurse bija e Husejnit ka thënë: "Na priu Ummu Selemeja në namazin e iqindisë dhe qëndroi mes nesh".

Këto transmetime argumentojnë lejimin e gruas tu prinë grave në namaz, qoftë namazi farz ose nafle, të lexojë me zë dhe të qëndrojë mes tyre.

Gjithashtu i lejohet gruas të thërret ezanin dhe të bëjë ikametin, sepse hadithi:

"Nuk kërkohet ezani për gratë" nuk ka bazë në librat e hadithit.

Kurse rregulli te dijetarët është se edhe gruaja është sikur burri në dedikimet fetare, secili dedikim për burrin vlen edhe për gruan, sepse Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Gratë janë pjesë e burrave".

Kurse dedikimi që u bëhet grave ne sherijat, në atë dedikim nuk hynë burrat përpos me argument shtesë. All-llahu e di më së miri.

Shejh Meshhur Hasen Selman
Përktheu: Bekir Halimi
16.06.2004

Vendimi i fesë për puthjen gjatë takimit, përqaqimin, dhe puthjen e dorës së dijetarit

Enesi radijall-llahu anhu, tregon: erdhi një njeri te Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e i tha: o i Dërguar i All-llahut, kur takohemi me ndokend a ti përkulemi? Tha: jo. A e përqaqim dhe e puthim? Tha: jo. Tha: a e përshëndet për dore? Tha: po, nëse do". (Ahmedi, Tirmidhiu, Ibn Maxhe dhe të tjerë. Hadithi është hasen).

Ajo që është e vërtetë në këtë rast është fakti se ky hadith është citat i qartë se nuk është e ligjshme puthja gjatë takimit, normalisht se këtu nuk hyn puthja e fëmijëve dhe grave, sikurse duket qartë...

Kurse hadithet që flasin se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka puthur disa sahabe të tij në raste të ndryshme, siç është puthja dhe përqaqja e Zejd ibn Harithit, kur ka ardhur në Medinë, ose përqaqja e Ebu Hejthem ibn Tihanit, e raste tjera, përgjigja ndaj tyre është në disa aspekte:

Një: Janë hadithe të dobëta, që nuk mundet të jenë argumente, ndoshta do të flasim për to më gjërësisht dhe do t'ua sqarojmë të metat e tyre, me lejen e All-llahut, subhanehu ve tealá.

Dy: Nëse do të ishin të vërteta, nuk do të lejoheshte ti kundërviheshin këtij hadithi të vërtetë, sepse vepra e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka mundësi të jetë e veçantë për te, ose mund të pranonte komentet e tjera të ndryshme, të cilat mundësi e dobësojnë argumentimin me te, për dallim

nga ky hadith, pasi që është hadith gojor, dedikim i përgjithshëm dhe i drejtuar mbarë ummetit, andaj është argument. Në shkencën e usulit është konfirmuar se thënia ka përparësi para veprës, nëse bien në kundërshtim njëra me tjetrën, dhe ndalesa ka përparësi para lejesës. Ky hadith është edhe thënie edhe ndalesë, andaj ka përparësi para haditheve të përmendura, nëse janë të vërteta.

Kurse sa i përket përqaqimit, pasi që nuk ka ndonjë ndalesë në këtë drejtim, atëherë mbetet në origjinën e sajë, e ajo është lejimi, sidomos pasi që ekzistojnë disa ethere (gjurmë) që e përforcojnë këtë mendim;

Enesi, radijall-llahu anhu, thotë: "Shokët e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur takoheshin përshëndeteshin, e kur vinin nga udhëtimi përqafoheshin". (Taberaniu në "Muxhemul-Evsat" me sened të përbërë nga transmetues të sahihut, siç ka thënë Mundhiri (3/270) dhe Hejthemiu (8/36).

Transmeton Bejhakiu (7/100) me sened të vërtetë nga Shabiu: "Shokët e Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur takoheshin përshëndeteshin për dore, e kur vinte dikush prej tyre nga udhëtimi, e përqafohin njëri tjetrin".

Transmeton Imam Buhariu në "Edebul-Mufred" (970) dhe Ahmedi (3/495) nga Xhabir ibn Abdull-llahi, radijall-llahu anhu: "Më erdhi një hadith, të cilin një njeri e kishite dëgjuar nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alej-

hi ve sel-lem, andaj e bleva një deve dhe u bëra gati për udhëtim. Udhëtova një muaj derisa shkova te ai në Sham. E ai ishte Abdull-llah ibn Unejsi. I thash kujdestarit: thuaj se Xhabiri është te dera. Tha: i biri i Abdull-llahut? I thashë: po. Doli duke veshur robat e më përqafoi dhe e përqafova...". Senedi është hasen siç thotë Hafith ibn Haxheri (1/195), kurse Imam Buhariu e ka sjellur mualek.

Gjithashtu është e vërtetë se Ibn Tihani e ka përqaftuar Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur i ka ardhur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, te kopshti i tij, siç qëndron në "Muhtesarus-Shemal", (133).

Sa i përket puthjes së dorës, në këtë drejtim ka shumë hadithe dhe gjurmë nga të parët që tregojnë në përgjithësi se kjo është e vërtetë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe selefi. Andaj ne mendojmë se lejohet puthja e dorës së dijetarit, nëse plotësohen këto kushte vijuese:

1- Mos të bëhet zakon, saqë të bëhet e natyrshme te dijetari që çdo herë që takohet

me nxënësit e vet ta zgjasë dorën që tia puthin, kurse te ata nxënës të bëhet e natyrshme të kërkojnë bereqetin në këtë formë. Sepse Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, edhe pse ia kanë puthur dorën, kjo ka ndodhur rrallë, andaj ajo që ka qenë rrallë nuk ban të bëhet sunnet i përhershëm, siç dihet në rregullat e fikhut.

2- Kjo mos të bëhet shkak që dijetari të bëhet mendjemadh ndaj të tjerëve dhe ta shikon vehten me tjetër sy, siç ndodh me disa hoxhallarë të sodit.

3- Mos të shkakton kjo eliminimin e ndonjë sunneti të njohur, siç është sunneti i përshëndetjes për dore, sepse kjo është e ligjshme me veprën dhe thënien e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është shkak fetar për rënien e mëkateve të tyre, siç është treguar në shumë hadithe. Andaj nuk lejohet të eliminohet ky sunnet për shkak të një vepre, e cila në rastin më të mirë është, vetëm, i lejuar.

Përktheu: Bekir Halimi

Marrë nga: "Vargu i haditheve të vërteta dhe diçka nga fikhu dhe dobia e tyre". (1/300-302; hadithi nr. 160).

Muhammed Nasirud-din Albani,
4.6.2004

11. Të dëshirosh për vëllain tënd atë që dëshiron për vete

Transmeton Enesi, radijallahu anhu, se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nuk ka besuar askush prej jush përderisa të dëshiron për vëllain e tij atë që dëshiron për vete" (Buhariu dhe Muslimi)

Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe keni frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti). (Huxhurat – 10)

Qëllimi i hadithit është se prej tërësisë së degëve të imanit të obliguara është që njeriu të dëshiron për vëllain e tij atë që dëshiron për vete.

Ky rregull i pjesërishëm islam përkufizohet me rregullin themelor e që nënkupton: të dëshirosh për vëllain tënd të mirën ashtu siç e dëshiron për vete, ashtu siç është përmendur në një transmetim tjetër "... përderisa të dëshiron për vëllain e tij atë të mirë (hajr) që e dëshiron për vete" (Transmeton Nesaiu)

Fjala "hajr" përmbledh të gjitha veprat fetare (taat) dhe veprat e lejuara të kësaj bote (mubahat) dhe Botës tjetër përpos ndalesave, sepse ato nuk janë mirësi (hajr) dhe nuk përfshihen.

Lidhur me hadithin e lartpërmendur dijetari Ebu Amër ibën Salah thotë: "e tërë kjo mund të kuptohet si vepër e rrëndë dhe e porealizuar, mirëpo nuk është ashtu sepse kuptimi i hadithit është: nuk plotësohet imani i asnjërit prej jush përderisa të mos dëshiron për vëllain e tij musliman atë që dëshiron për vete. Ai këtë mund ta realizoj duke dashur për të arritjen e të mirave duke mos iu pakësuar të mirat e tij. E kjo është e lehtë për zemrën e shëndoshë kurse e vështirë për zemrën e sëmurë, Allahu na mbroftë neve dhe të gjithë vëllezërit tanë.

Ahmed Muadh Hakkij

Përktheu: Agim Bekiri

(pjesë nga libri: katërdhjet hadithe mbi moralin)